



**UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE
DEPARTAMENTI I EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT**

DISERTACION

Doktoratë në Shkenca Ekonomike

ROLI I MIKROKREDITIMIT NË EKONOMINË SHQIPTARE. EVIDENCAT DHE PERSPEKTIVAT

Doktorant:
MSc. Eros ANGJELI

Drejtues shkencor:
Prof. Dr. Adrian CIVICI

Tiranë 2026

Autorësia

Përmbajtja e këtij punimi është krejtësisht autentike. I jap Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, të drejtën e përdorimit të pjesshëm apo të plotë të tij.

Unë, i nënshkruari Eros ANGJELI, deklaroj se kjo temë përfaqëson punimin tim origjinal, përveç rasteve të citimeve dhe referencave, si dhe nuk është përdorur më parë në këtë universitet apo në universitete të tjera. Mendimet e shprehura në këtë temë janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë ato të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.

© Copyright, Eros ANGJELI, 2026

Eros ANGJELI

Tiranë, 2026

FALENDERIME

Para së gjithash, do të doja të shprehja mirënjohjen time të thellë për udhëheqësin e këtij punimi. Faleminderit, Profesor Adrian Civici për mbështetjen e këtij punimi doktoral, për këshillat e vlefshme dhe për interesin e vazhdueshëm me të cilin e keni rrethuar këtë punim.

Dëshiroj të falenderoj anëtarët e Departamentit të Ekonomisë dhe Zhvillimit si edhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike për komentet, vërejtjet dhe pikëpamjet e tyre të cilët e kanë pasuruar këtë punim doktoral.

Do të doja të shprehja mirënjohjen time më të thellë familjes sime për besimin dhe mbështetjen e tyre të palëkundur gjatë gjithë këtij rrugëtimi akademik.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE.....	3
PËRMBLEDHJE	4
ABSTRACT.....	5
KAPITULLI 1 - KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM I STUDIMIT.....	6
1.1 Sfondi i studimit	6
1.2 Korniza teorike dhe konceptuale	9
1.3 Qëllimi i studimit	11
1.4. Metodologjia e kërkimit	15
1.5. Kontributi shkencor dhe origjinaliteti	16
1.6. Struktura e punimit	17
KAPITULLI 2 – DEBATI AKADEMIK MBI MIKROKREDITIMIN	20
2.1 Evoluimi i konceptit dhe debati akademik mbi mikrokreditimin	21
2.2 Kushtet që mikrokreditimi të kontribuojë në zbutjen e varfërisë	37
2.3. Konteksti i zhvillimit të mikrokreditimit në Shqipëri	58
2.4. Përmbledhje e kapitullit	65
KAPITULLI 3-QASJA EPISTEMOLOGJIKE DHE METODOLOGJIKE	66
3.1 Qasje epistemologjike dhe metodologjike	66
3.2. Objektivat, pyetja kërkimore dhe kampionimi.....	68
3.3. Mbledhja e të dhënave dhe burimet bibliografike.....	70
3.4. Vështirësitë gjatë kërkimit.....	73
3.5. Përmbledhje e kapitullit	74
KAPITULLI 4 - GJETJET E PUNIMIT	76
4.1 Situata e mikrokredisë në vend (2013-2023)	77
4.2. Përdorimi i mikrokredisë sipas sektorëve kryesorë.....	85
4.3 Vlerësimet mbi mikrokredinë.....	104
4.4. Përmbledhje e kapitullit	108
KAPITULLI 5 - KONKLUSIONE TË PËRGJITHSHME	109
5.1 Përfundime të përgjithshme mbi gjetjet e studimit	109
5.2. Kufizimet e studimit.....	113
5.3. Implikime dhe rekomandime për politikëbërjen	115
5.4. Sugjerime për kërkime të ardhshme	116
5.5. Konkluzione përmbyllëse.....	117
BIBLIOGRAFIA	122

SHTOJCAT INFORMATIVE	127
Pyetësori për ndërmarrjet (Tregtia me pakicë)	128
Pyetësori i shkurtuar për bujqësi/blegtori.....	131
Të dhëna të përgjithshme	132
Institucione të mikrofinancës në Shqipëri	135
Tabelë analitike për sistemin e mikrokredisë në Shqipëri.....	138
Tabelë krahasuese të 15 institucioneve të mikrofinancës në Shqipëri	139
Lidhja ndërmjet OZHM-së, Mikrokredisë dhe Uljes së Varfërisë Globale.....	141
Lidhja konceptuale: Mikrokredia dhe OZHM	142
Raporte dhe dokumente institucionale	143
Burime shqiptare për mikrokredinë.....	145

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Evolucioni i shumës në euro (milionë) të mikrokredisë (majtas) dhe numri i huamarrësve (1000) (djathtas) për periudhën 2013-2023.....	77
Figura 2. Evolucioni i PBB-së reale (majtas në miliardë euro) dhe i mikrokredive (djathtas në milionë euro) për periudhën 2013-2023.....	79
Figura 3. Marrëdhënia midis PBB-së reale dhe mikrokredive për periudhën 2013-2023.....	80
Figura 4. Përdorimi i mikrokredisë sipas sektorëve kryesorë.....	86
Figura 5. Përdorimi i mikrokredisë nga mikro-ndërmarrjet në sektorin e tregtisë me pakicë (n = 51).....	87
Figura 6. Evolucioni i fitimit neto pas marrjes së mikrokredisë.....	88
Figura 7. Ndikimi i mikrokredisë në të ardhurat sipas qarqeve në %.....	89
Figura 8. Vështirësitë për të shlyer mikrokreditin.....	90
Figura 9. Gatishmëria për të shlyer mikrokredi.....	91
Figura 10. Gatishmëria për të marrë përsëri mikrokredi në të ardhmen.....	92
Figura 11. Përqindja e fermerëve sipas grupmoshave (%).....	92
Figura 12. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë (%) (në të majtë) dhe sipas vendbanimit (në të djathtë).....	93
Figura 13. Shpërndarja në % e fermerëve sipas madhësisë së fermës që disponojnë (%).....	94
Figura 14. Shpërndarja e qëllimeve të përdorimit të mikrokredisë nga fermerët, përqindje.....	95
Figura 15. Ndikimi i mikro-kredisë në prodhimin bujqësor/blegtori.....	96
Figura 16. Shpërndarja gjeografike për vlerësimin e ndikimit të mikrokredisë në prodhimin bujqësor dhe blegtoral për qarqet: Dibër, Korçë dhe Fier.....	97
Figura 17. Ndikimi në % i mikrokredisë në të ardhurat e fermerëve.....	99
Figura 18. Shpërndarja gjeografike për vlerësimin e ndikimit të mikrokredisë në të ardhurat e fermerëve për qarqet: Dibër, Korçë dhe Fier.....	99
Figura 19. Gatishmëria për të marrë përsëri mikrokredi në të ardhmen.....	102
Figura 20. Avantazhet kryesore në % të identifikuara nga ndërmarrësit.....	104
Figura 21. Vështirësitë dhe disavantazhet e perceptuara.....	106
Figura 22. Komentet dhe sugjerimet shtesë të ndërmarrësve.....	107

PËRMBLEDHJE

Gjatë dy dekadave të fundit, zgjerimi i institucioneve mikrofinanciare ka qenë i lidhur ngushtë me aksesin e kufizuar të individëve dhe mikro-ndërmarrjeve në financimin bankar tradicional. Duke qenë se ndërmarrjet e vogla dhe shumë të vogla përbëjnë pjesën më të madhe të strukturës së biznesit në Shqipëri, mikrokrediti është shfaqur si një mekanizëm alternativ financimi që synon mbështetjen e sipërmarrjes, krijimin e vendeve të punës dhe përfshirjen sociale. Nëpërmjet këtij hulumtimi synohet vlerësimi i kontributit të mikrokredisë në zhvillimin ekonomik, përfshirjen financiare dhe uljen e varfërisë në Shqipëri.

Studimi empirik është ndërtuar sipas një qasje holistike-induktive duke ndërthurur analizën sasiore të të dhënave dytësore makroekonomike dhe sektoriale me një vlerësim të efekteve tek përfituesit, të cilat janë realizuar nga të dhënat primare. Komponenti sasior fokusohet në periudhën 2013–2023 dhe analizon marrëdhënien ndërmjet shpërndarjes së mikrokredive dhe rritjes së PBB-së. Dimensionin cilësor plotëson këto gjetje duke shqyrtuar rezultatet në nivel përfituesi, strategjitë institucionale dhe kufizimet strukturore që ndikojnë në qëndrueshmërinë e programeve të mikrokreditimit.

Gjetjet tregojnë një lidhje të fortë dhe pozitive midis rritjes së portofolit të mikrokredisë dhe produktit të përgjithshëm ekonomik. Megjithatë, studimi evidenton edhe kufizime të rëndësishme. Në nivel mikro, ndikimi i mikrokredisë në rritjen e të ardhurave individuale rezulton të jetë modest. Shumat e vogla të kredive, afatet relativisht të shkurtra të ripagimit dhe kapacitetet e kufizuara menaxheriale të përfituesve kufizojnë potencialin transformues të mikrokreditimit. Ndërsa përfituesit shpesh raportojnë përmirësime afatshkurtra në të ardhura dhe në stabilizimin e konsumit, efekti afatgjatë në uljen e varfërisë mbetet i pjesshëm. Në disa raste, presioni i ripagimit mund të krijojë vulnerabilitet financiar kur aktivitetet gjeneruese të të ardhurave nuk prodhojnë kthime të mjaftueshme.

Në përfundim, mikrokreditimi në Shqipëri është një instrument i rëndësishëm, por jo i mjaftueshëm, në nxitjen e rritjes ekonomike dhe përfshirjes sociale. Ai mbështet dinamizmin sipërmarrës dhe përmirëson aksesin në financë për popullatat e pashërbyera, por nuk e eliminon plotësisht varfërinë apo pabarazitë strukturore. Studimi thekson nevojën për politika plotësuese, përfshirë edukimin financiar, instrumente financimi me afat më të gjatë, forcimin e kuadrit rregullator dhe integrimin e mikrokreditimit me strategji më të gjera zhvillimore. Duke kombinuar evidencën empirike me perspektiva të orientuara drejt së ardhmes, ky studim ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të kontributit aktual dhe potencialit të ardhshëm të mikrokreditimit në ekonominë shqiptare.

Fjalë kyçe: Mikrokreditimi, metoda holistike-induktive, zhvillimi ekonomik, përfshirja financiare, ulja e varfërisë, Shqipëria.

ABSTRACT

Over the past two decades, the expansion of microfinance institutions has been closely associated with the limited access of individuals and micro-enterprises to traditional bank financing. Given that small and very small enterprises constitute the largest share of the business structure in Albania, microcredit has emerged as an alternative financing mechanism aimed at supporting entrepreneurship, job creation, and social inclusion. This research seeks to assess the contribution of microcredit to economic development, financial inclusion, and poverty reduction in Albania.

The empirical study employed a holistic–inductive approach, combining quantitative analysis of secondary macroeconomic and sectoral data with an assessment of beneficiary-level effects based on primary data. The quantitative component focuses on the period 2013–2023 and analyzes the relationship between the distribution of microloans and GDP growth. The qualitative dimension complements these findings by examining outcomes at the beneficiary level, institutional strategies, and structural constraints affecting the sustainability of microcredit programs.

The findings indicate a strong and positive relationship between the growth of the microcredit portfolio and overall economic output. However, the study also identifies important limitations. At the micro level, the impact of microcredit on individual income growth appears modest. Small loan amounts, relatively short repayment periods, and beneficiaries' limited managerial capacities constrain the transformative potential of microcredit. While beneficiaries often report short-term improvements in income and consumption stabilization, the long-term effect on poverty reduction remains partial. In some cases, repayment pressure may create financial vulnerability when income-generating activities fail to produce sufficient returns.

In conclusion, microcredit in Albania is an important, but not sufficient, instrument for promoting economic growth and social inclusion. It supports entrepreneurial dynamism and improves access to finance for underserved populations, yet it does not fully eliminate poverty or structural inequalities. The study highlights the need for complementary policies, including financial education, longer-term financing instruments, strengthening of the regulatory framework, and the integration of microcredit into broader development strategies. By combining empirical evidence with forward-looking perspectives, this study provides a comprehensive assessment of the current contribution and future potential of microcredit in the Albanian economy.

Keywords: Microcredit, holistic–inductive method, economic development, financial inclusion; poverty reduction; Albania.

KAPITULLI 1 - KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM I STUDIMIT

Për disa vite, mikrokredia është bërë një mjet dhe është konsideruar një aspekt strategjik në planin e veprimit kryesisht të organizatave lokale të zhvillimit. Kështu, mikrokredia lindi në vitin 1976 falë ekonomistit Yunus Muhammad në Bangladesh. Ajo u zhvillua me qëllimin për të ndihmuar popullatat e varfra që nuk mund të kishin akses në kredi bankare në kushtet kur bankat refuzonin t'u jepnin kredi pasi nuk plotësonin kushtet e nevojshme për të marrë kredi. Profesor Yunus Muhammad, profesor në Universitetin e Chittatong, nisur nga situata e pasigurt që po përjetonin disa gra, zgjodhi t'i ndihmonte duke u dhënë hua 27 dollarë, pa interes dhe, mbi të gjitha, pa datë pagese. Falë këtij gjesti, këto gra ishin në gjendje të zgjeronin bizneset e tyre dhe kështu të mbështesnin familjet e tyre. Por mbi të gjitha, ato tani ishin në gjendje ta shlyenin kredinë më lehtë. Në vijim të kësaj eksprience të suksesshme, Yunus Muhammad krijoi Bankën Grammen me qëllim zgjerimin e projektit të tij dhe për t'i ardhur në ndihmë popullsisë së Bangladeshit.

Kjo formë financimi ka gjeneruar entuziazëm të vërtetë në vendet në zhvillim dhe janë ndërmarrë disa iniciativa për të nxitur një frymë sipërmarrëse tek popullatat, veçanërisht tek popullatat rurale. Objektivi është përdorimi i mikrokredisë për të përmirësuar kushtet e jetesës rurale dhe familjare. Përballë këtij fenomeni socio-ekonomik, në të gjithë botën, janë shfaqur institucione të shumta mikrofinanciare. Gjithashtu, kanë dalë disa programe për të ndihmuar popullsinë e botës, gati 10% e të cilëve jetojnë nën kufirin e varfërisë dhe për të lehtësuar përfshirjen financiare dhe për të ringjallur ekonominë globale. Prandaj, shumë nga këto programe zhvillimi lokal nuk zbatohen vetëm nga vendet ose organizatat kombëtare, por shpesh janë objekt i bashkëveprimit midis shteteve dhe institucioneve të caktuara ndërkombëtare dhe organizatave financuese, veçanërisht UNDP-së ose Bankës Botërore. Si rezultat, mikrokredia ka pasur një ndikim të madh në popullatat e botës përmes emancipimit të grave, varfërisë, shfaqjes së mikro-ndërmarrjeve, etj.

1.1 Sfondi i studimit

Mikrokreditimi është konsoliduar në dekadat e fundit si një instrument i rëndësishëm i përfshirjes financiare dhe zhvillimit ekonomik, duke synuar të lehtësojë aksesin në kapital për individët dhe ndërmarrjet e vogla që përjashtohen nga sistemi bankar formal. Ky model financimi lindi si përgjigje ndaj dështimeve të tregut financiar tradicional, i cili shpesh konsideron klientët me të ardhura të ulëta, pa kolateral ose me histori të kufizuar krediti si subjekte me rrezik të lartë. Në këtë kontekst, mikrofinanca u konceptua si një mekanizëm alternativ që synon të korrigjojë këto disbalanca strukturore, duke ofruar kredi të vogla, fleksibël dhe të orientuara drejt aktiviteteve gjeneruese të të ardhurave.

Në nivel global, mikrofinanca është konsideruar një mekanizëm i rëndësishëm për reduktimin e varfërisë, nxitjen e sipërmarrjes dhe fuqizimin ekonomik të grupeve vulnerabël, veçanërisht grave, familjeve rurale dhe individëve të vetëpunësuar. Teoria e përfshirjes financiare argumenton se aksesin në shërbime financiare formale

përmirëson aftësinë e individëve për të investuar në kapital fizik dhe njerëzor, duke rritur kështu produktivitetin dhe mirëqenien e tyre afatgjatë. Për më tepër, mikrokredia është lidhur me zhvillimin e mikro-ndërmarrjeve, diversifikimin e burimeve të të ardhurave dhe rritjen e aftësisë së rimëkëmbjes ekonomike të familjeve ndaj goditjeve ekonomike. Megjithatë, pavarësisht këtij optimizmi fillestar, literatura ndërkombëtare ka evidentuar rezultate të ndryshme mbi ndikimin afatgjatë të mikrokredisë. Ndërsa disa studime theksojnë rolin e saj në përmirësimin e aksesit në financë dhe nxitjen e sipërmarrjes, të tjera argumentojnë se efektet në reduktimin strukturor të varfërisë janë shpesh modeste dhe heterogjene. Në shumë raste, mikrokredia ka kontribuar kryesisht në stabilizimin e konsumit dhe mbijetesën ekonomike, më shumë sesa në transformimin strukturor të aktiviteteve ekonomike të përfituesve. Kjo ka nxitur një debat të gjerë akademik mbi rolin real të mikrofinancës lidhur me faktin nëse ajo është një instrument transformues i zhvillimit apo thjesht një mekanizëm mbështetës që zbut përkohësisht pasojat e varfërisë.

Një nga çështjet kryesore të ngritura në literaturë lidhet me kushtëzimin institucional dhe social të efekteve të mikrokreditimit. Evidencat empirike tregojnë se ndikimi i mikrokredisë varet ndjeshëm nga faktorë si cilësia e institucioneve financiare, niveli i edukimit financiar të përfituesve, kuadri rregullator dhe disponueshmëria e shërbimeve plotësuese si trajnimi profesional, këshillimi biznesor dhe mbështetja infrastrukturore. Në mungesë të këtyre elementeve, kreditë e vogla mund të përdoren për konsum të menjëhershëm dhe jo për investime produktive, duke kufizuar efektet e tyre zhvillimore në afatgjatë.

Në këtë kontekst ndërkombëtar, Shqipëria paraqet një rast studimor me interes të veçantë. Sektori i mikrokreditimit në Shqipëri është zhvilluar që nga vitet '90, si një përgjigje ndaj kufizimeve strukturore të sistemit bankar në financimin e individëve, fermerëve dhe ndërmarrjeve të vogla. Ekonomia shqiptare karakterizohet nga një strukturë e dominuar nga NVM-të dhe aktivitetet mikro-sipërmarrëse, të cilat shpesh përballen me vështirësi në aksesin në kredi bankare për shkak të mungesës së kolateralit, informalitetit të lartë dhe rrezikut të perceptuar të biznesit. Në këtë kuadër, institucionet mikrofinanciare kanë luajtur një rol komplementar në financimin e aktiviteteve ekonomike lokale, veçanërisht në zonat rurale dhe periferike. Zgjerimi i sektorit mikrofinanciar në Shqipëri ka kontribuar në rritjen e përfshirjes financiare dhe në mbështetjen e sipërmarrjes së vogël, duke ofruar kredi për kapital qarkullues, investime të vogla dhe zhvillim të aktiviteteve bujqësore, turistike dhe tregtare. Për shumë familje rurale dhe ndërmarrje mikro, mikrokredia përbën shpesh burimin e vetëm formal të financimit, duke zëvendësuar kreditimin informal ose huamarrjen nga rrjetet familjare dhe sociale. Kjo ka pasur implikime të rëndësishme për zhvillimin ekonomik lokal dhe për reduktimin e përjashtimit financiar në vend.

Megjithatë, rritja e shpejtë e mikrokreditimit ka ngritur edhe një sërë shqetësimesh lidhur me mbingarkesën me borxhe, normat e interesit relativisht të larta dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ndikimit socio-ekonomik. Në disa raste, huamarrësit me kapacitete të kufizuara ripagimi janë ekspozuar ndaj rrezikut të cikleve të borxhit,

duke përdorur kredi të reja për të shlyer detyrimet ekzistuese. Kjo situatë ngre pikëpyetje mbi balancën midis misionit social të mikrofinancës dhe orientimit të saj drejt qëndrueshmërisë financiare dhe komercializimit të produkteve të kreditimit.

Literatura shqiptare mbi mikrokreditimin ka filluar të adresojë këto çështje, por ende evidenton boshllëqe të rëndësishme kërkimore. Studimet ekzistuese fokusohen kryesisht në analiza përshkruese të rolit të mikrokredisë në përfshirjen financiare dhe në mbështetjen e NVM-ve, ndërsa mungojnë vlerësime rigorozisht empirike mbi ndikimin afatgjatë të saj në mirëqenien ekonomike, zhvillimin e bizneseve të vogla dhe reduktimin e varfërisë. Për më tepër, shumë nga këto studime mbështeten në të dhëna dytësore dhe mostra të kufizuara, duke kufizuar mundësinë për të nxjerrë përfundime shkakësore mbi efektet reale të mikrokreditimit. Një tjetër kufizim i literaturës lidhet me mungesën e një qasjeje të integruar që të kombinojë analizën mikroekonomike të përfituesve me dimensionet makroekonomike dhe institucionale të zhvillimit të sektorit mikrofinanciar. Shumica e studimeve trajtojnë ose efektet në nivel familjar dhe biznesi, ose ndikimet makroekonomike në rritjen ekonomike, pa analizuar ndërveprimin kompleks midis këtyre niveleve. Kjo krijon një hendek analitik në kuptimin e plotë të rolit të mikrokreditimit si një instrument zhvillimi në ekonominë shqiptare. Për më tepër, transformimet strukturore të ekonomisë shqiptare, procesi i integritetit evropian dhe zhvillimet teknologjike në sektorin financiar (fintech, kreditimi dixhital) po ndryshojnë gradualisht mënyrën se si funksionon mikrofinanca. Këto zhvillime krijojnë mundësi të reja për zgjerimin e aksesit në financë, por njëkohësisht rrisin kompleksitetin e rreziqeve rregullatore, operacionale dhe sociale që lidhen me kreditimin e segmenteve vulnerabël të popullsisë.

Në këtë sfond, lind nevoja për një studim të thelluar empiriko-institucional që të analizojë ndikimin afatgjatë të mikrokreditimit në zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri. Një analizë e tillë duhet të integrojë dimensionet mikro (familjet dhe NVM-të), makroekonomike (rritja ekonomike dhe treguesit e varfërisë) dhe institucionale (kuadri rregullator, mbikëqyrja financiare dhe politikat publike). Vetëm përmes një qasjeje të tillë gjithëpërfshirëse mund të vlerësohet në mënyrë rigoroze nëse mikrokreditimi ka prodhuar efekte të qëndrueshme në mirëqenien ekonomike dhe sociale të përfituesve dhe në zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë shqiptare. Kjo nevojë studimore është veçanërisht e rëndësishme në një kontekst ku politikat publike dhe institucionet financiare synojnë të rrisin përfshirjen financiare dhe të mbështesin zhvillimin e NVM-ve si motor kryesor i rritjes ekonomike. Një vlerësim i saktë dhe empirik i ndikimit të mikrokreditimit do të kontribuojë jo vetëm në avancimin e literaturës akademike, por edhe në hartimin e politikave më efektive dhe të balancuara që marrin në konsideratë si dimensionin social ashtu edhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit mikrofinanciar.

Në përfundim, sfondi teorik dhe empirik i mikrokreditimit në Shqipëri sugjeron se, megjithëse ky instrument ka luajtur një rol të rëndësishëm në zgjerimin e aksesit në financë dhe në mbështetjen e aktiviteteve ekonomike të vogla, ndikimi i tij afatgjatë mbi mirëqenien ekonomike dhe reduktimin e varfërisë mbetet ende i paqartë dhe

kërkon një analizë më të thelluar dhe sistematike. Ky studim synoi pikërisht të plotësojë këtë boshllëk kërkimor, duke ofruar një vlerësim të integruar dhe empirik të rolit të mikrokreditimit në zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë.

1.2. Korniza teorike dhe konceptuale

Ky studim mbështetet në një kornizë teorike ndërdisiplinore që integron disa perspektiva teorike nga ekonomia e zhvillimit, financat, sociologjia ekonomike dhe studimet mbi sipërmarrjen lokale. Qëllimi i kësaj kornize është të shpjegojë mekanizmat përmes të cilëve mikrokreditimi ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social, duke lidhur dimensionet financiare me ato institucionale dhe sociale. Integrimi i këtyre teorive mundësoi një analizë gjithëpërfshirëse të mikrokreditit si një instrument kompleks zhvillimi, i cili operon në ndërveprim me faktorë strukturorë, institucionalë dhe komunitarë.

Në analizën e ndikimit të mikrokreditimit në zhvillimin ekonomik dhe social, një kornizë teorike e integruar ndërtohet mbi tri qasje komplementare. Teoria e përfshirjes financiare e trajton aksesin në shërbime financiare formale si një të mirë publike dhe si një parakusht për zhvillim gjithëpërfshirës, duke argumentuar se përjashtimi financiar prodhon kufizime strukturore që pengojnë investimin, inovacionin dhe rritjen e produktivitetit; në këtë kuadër, mikrokredia shfaqet si instrument që redukton asimetrinë e aksesit dhe zgjeron pjesëmarrjen ekonomike të individëve dhe NVM-ve të përjashtuara nga sistemi bankar tradicional, veçanërisht në kontekste si Shqipëria ku segmentet e pambuluara të tregut financiar mbeten të theksuara. Paralelisht, teoria e zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike e pozicionon mikrokreditimin si pjesë të procesit të thellimit financiar, duke theksuar se zgjerimi i ndërmjetësimit financiar drejt aktorëve të vegjël rrit efikasitetin e alokimit të kapitalit, mobilizon kursimet, përmirëson menaxhimin e rrezikut dhe nxit investimet prodhuese, duke gjeneruar efekte të shumëfishta në dinamizimin e aktivitetit ekonomik lokal dhe në rritjen makroekonomike.

Në këtë perspektivë, mikrokredia nuk është vetëm një mekanizëm social, por një komponent funksional i arkitekturës financiare kombëtare që kontribuon në rritjen e kapacitetit ndërmjetësues të sistemit financiar. Së treti, teoria e kapitalit social dhe fuqizimit ekonomik nënvizon dimensionin institucional dhe komunitar të mikrofinancës, duke theksuar rolin e rrjeteve të besimit, normave të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve sociale në uljen e kostove të informacionit, përmirësimin e disiplinës së ripagimit dhe rritjen e autonomisë ekonomike të përfituesve; në kontekstin shqiptar, ku strukturat familjare dhe komunitare kanë peshë të konsiderueshme në vendimmarrjen ekonomike, kapitali social shërben si mekanizëm ndërmjetësues që amplifikon efektet e mikrokreditimit në fuqizimin ekonomik, formalizimin e aktiviteteve dhe përmirësimin e mirëqenies sociale. Së bashku, këto tre qasje teorike krijojnë një kornizë analitike të ndërthurur që e konceptualizon mikrokreditimin si një instrument me ndikim të shumëfishtë financiar, ekonomik dhe social, duke e pozicionuar atë si një faktor të rëndësishëm në proceset e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri.

Teoria e ndërmarrjeve mikro dhe zhvillimit lokal argumenton se ndërmarrjet e vogla dhe mikro-sipërmarrjet janë motorë kryesorë të zhvillimit ekonomik lokal, krijimit të vendeve të punës dhe reduktimit të varfërisë. Mikrokredia, duke ofruar financim për këto ndërmarrje, mund të nxisë krijimin dhe zgjerimin e aktiviteteve ekonomike në nivel lokal, duke rritur të ardhurat dhe duke përmirësuar strukturën prodhuese të rajoneve. Në kontekstin shqiptar, ku ekonomia karakterizohet nga një peshë e lartë e NVM-ve dhe aktiviteteve familjare, kjo teori ofron një bazë të rëndësishme për të kuptuar ndikimin e mikrokreditimit në zhvillimin rajonal dhe në diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në sektorë si bujqësia, turizmi dhe shërbimet. Mikrokredia mund të lehtësojë krijimin e bizneseve të reja, modernizimin e atyre ekzistuese dhe integrimin e tyre në zinxhirët lokalë dhe rajonalë të vlerës.

Në literaturën bashkëkohore mbi financat zhvillimore, Teoria e Përfshirjes Financiare dhe Teoria e Zhvillimit Financiar e Rritjes Ekonomike paraqiten shpesh si qasje të afërta, por në thelb ato ndërtojnë dy horizonte të ndryshme analitike. Teoria e përfshirjes financiare e nis argumentin e saj nga individi dhe njësia ekonomike e vogël, duke e konsideruar aksesin në shërbime financiare si një e drejtë funksionale dhe si një mekanizëm për të korrigjuar pabarazitë strukturore që prodhon vetë sistemi financiar. Në këtë perspektivë, zhvillimi ekonomik nuk mund të kuptohet pa adresuar më parë përjashtimin financiar, i cili kufizon mundësinë e individëve dhe NVM-ve për të investuar, për të formalizuar aktivitetet e tyre dhe për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në treg. Këtu, mikrokredia shfaqet si një instrument që hap portat e sistemit financiar për grupet e marginalizuara, duke e parë zhvillimin si proces që fillon nga poshtë-lart, përmes zgjerimit të mundësive ekonomike.

Në të kundërt, teoria e zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike e ndërton argumentin e saj nga perspektiva e sistemit financiar si një strukturë makroekonomike. Ajo nuk fokusohet te individi, por te kapaciteti i sistemit për të mobilizuar kursimet, për të alokuar kapitalin në mënyrë efikase dhe për të menaxhuar rrezikun në shkallë të gjerë. Në këtë qasje, rritja ekonomike është produkt i thellimit financiar, i sofistikimit të instrumenteve dhe i rritjes së ndërmjetësimit financiar. Mikrokredia, në këtë kontekst, nuk shihet më si mjet social, por si një komponent i arkitekturës financiare që kontribuon në zgjerimin e tregut të kapitalit dhe në rritjen e produktivitetit të ekonomisë. Ndryshe nga teoria e përfshirjes financiare, e cila synon të korrigjojë pabarazitë, teoria e zhvillimit financiar synon të rrisë efikasitetin sistematik dhe të gjenerojë rritje të qëndrueshme të PBB-së.

Kështu, dallimi midis dy teorive nuk është thjesht metodologjik, por ontologjik: e para e sheh zhvillimin si proces të zgjerimit të aksesit dhe të drejtave ekonomike, ndërsa e dyta e sheh zhvillimin si funksion të performancës së sistemit financiar në nivel makro. Në kontekstin shqiptar, ku përjashtimi financiar bashkëjeton me një sistem financiar relativisht të përqendruar dhe të kufizuar në diversitet instrumentesh, këto dy teori nuk janë konkurruese, por plotësuese, ato ofrojnë dy lente të ndryshme për të kuptuar rolin e mikrokreditimit në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Bazuar në këto perspektiva teorike, studimi propozon një model konceptual që shpjegon ndikimin e mikrokreditimit në rritjen ekonomike dhe zhvillimin social përmes tre drejtimeve kryesore ndërvepruese.

Financimi i NVM-ve dhe rritja e produktivitetit - Drejtimi i parë lidhet me rolin e mikrokredisë në financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe mikro-sipërmarrjeve. Aksesit në kredi u mundëson këtyre ndërmarrjeve të investojnë në pajisje, teknologji dhe kapital qarkullues, duke rritur produktivitetin dhe kapacitetin e tyre prodhues. Përmes këtij mekanizmi, mikrokredia mund të kontribuojë në zgjerimin e aktivitetit ekonomik, rritjen e të ardhurave dhe krijimin e vendeve të reja të punës, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen ekonomike lokale dhe kombëtare.

Rritja e përfshirjes financiare dhe aksesit në kapital- Drejtimi i dytë përfaqëson dimensionin e përfshirjes financiare. Mikrokredia zgjeron aksesin në kapital për individët dhe bizneset që tradicionalisht përjashtohen nga sistemi bankar, duke reduktuar përjashtimin financiar dhe duke integruar segmente të reja në sistemin financiar formal. Kjo rritje e përfshirjes financiare përmirëson mundësitë për investim, menaxhim të rrezikut dhe planifikim financiar, duke krijuar kushte më të favorshme për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe reduktimi i varfërisë - Drejtimi i tretë lidhet me ndikimin social të mikrokreditimit. Përmes rritjes së të ardhurave, stabilizimit të konsumit dhe fuqizimit ekonomik të familjeve përfituese, mikrokredia mund të kontribuojë në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe në reduktimin e varfërisë. Ky ndikim pritet të jetë veçanërisht i rëndësishëm për grupet vulnerabël, si gratë, familjet rurale dhe individët e vetëpunësuar, duke rritur reziliencën e tyre ekonomike dhe mundësitë për zhvillim afatgjatë.

Në përmbledhje, modeli konceptual i studimit sugjeron se mikrokredia ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social përmes ndërveprimit të këtyre tre drejtimeve, të cilat janë të ndërlidhura dhe të kushtëzuara nga faktorë institucionalë, rregullatorë dhe socio-ekonomikë. Kjo qasje teorike dhe konceptuale ofron bazën analitike për testimin empirik të hipotezave dhe për vlerësimin e rolit të mikrokreditimit në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri.

1.3 Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë në mënyrë të thelluar dhe empirike ndikimin afatgjatë të mikrokreditimit në rritjen ekonomike, performancën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), përfshirjen financiare dhe mirëqenien sociale në Shqipëri, duke identifikuar njëkohësisht faktorët institucionalë dhe socio-ekonomikë që përcaktojnë efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e këtij instrumenti financiar. Studimi synon të kuptojë jo vetëm nëse mikrokreditimi ka kontribuar në zgjerimin e aksesit në financë, por edhe nëse ai ka prodhuar efekte të qëndrueshme në zhvillimin ekonomik dhe social të përfituesve dhe të ekonomisë në tërësi. Në këtë kuadër, analiza fokusohet në ndërveprimin midis mikrokreditimit dhe treguesve kryesorë të zhvillimit ekonomik, duke përfshirë rritjen e prodhimit të brendshëm

bruto, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e sipërmarrjes së vogël dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së familjeve përfituese. Për më tepër, studimi shqyrton dimensionin e përfshirjes financiare, duke analizuar se në ç'mase mikrokredia ka reduktuar përjashtimin financiar dhe ka lehtësuar integrimin e grupeve vulnerabël në sistemin financiar formal.

Një aspekt thelbësor i qëllimit të studimit është identifikimi i faktorëve institucionalë, rregullatorë dhe socio-ekonomikë që ndikojnë në efektivitetin e mikrokreditimit. Kjo përfshin analizën e rolit të kuadrit rregullator, mbikëqyrjes financiare, nivelit të edukimit financiar të përfituesve, karakteristikave të tregut të punës dhe strukturës së ekonomisë shqiptare, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në mënyrën se si kreditë përdoren dhe në rezultatet e tyre afatgjata. Në këtë mënyrë, studimi synon të japë një vlerësim gjithëpërfshirës të mikrokreditimit jo vetëm si një instrument financiar, por edhe si një mekanizëm zhvillimor i ndikuar nga konteksti institucional dhe socio-ekonomik i vendit.

Në thelb, qëllimi i studimit është të kontribuojë në plotësimin e boshllëqeve ekzistuese në literaturën shqiptare mbi mikrofinancën, duke ofruar një analizë të integruar që lidh dimensionet mikroekonomike (familje dhe NVM), dimensionet makroekonomike (rritja ekonomike dhe varfëria) dhe dimensionin institucional (rregullimi dhe politikat publike). Kjo qasje synon të ofrojë evidenca të besueshme dhe të bazuara në analiza empirike, të cilat mund të shërbejnë si bazë për formulimin e politikave më efektive në fushën e përfshirjes financiare dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri.

1.3.1. Objektivat e studimit

Objektivi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë ndikimin e mikrokreditimit në zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri, duke analizuar kontributin e tij në rritjen ekonomike, performancën e NVM-ve, përfshirjen financiare dhe mirëqenien e familjeve përfituese. Ky objektivi synon të testojë në mënyrë empirike nëse mikrokreditimi ka qenë një instrument efektiv për promovimin e zhvillimit gjithëpërfshirës dhe reduktimin e varfërisë, si dhe nëse efektet e tij janë të qëndrueshme në kohë. Kjo gjithashtu do të lehtësojë kuptimin tonë të funksionimit të këtyre programeve qeveritare ose joqeveritare që ndikojnë te popullatat, aktorët kryesorë të ekonomisë globale dhe kombëtare.

Adresimi i objektivit kryesor të këtij hulumtimi u realizua nëpërmjet një analize kriktike të të gjithë hulumtimeve më të spikatura teorike dhe empirike të studjuesve të tjerë të fushës, e cila mundësoi ndërtimin e disa objektivave specifik:

Objektivi i parë specifik është të eksplorojë i konceptit të kushteve të huamarrjes për të kuptuar dhe analizuar faktorët ekonomikë, financiarë, institucionalë dhe rregullatorë që ndikojnë në përcaktimin e tyre, duke identifikuar elementët që rrisin besueshmërinë, transparencën dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënies midis huadhënësit dhe huamarrësit.

Objektivi i dytë specifik synon të analizojë zhvillimin historik dhe strukturor të sektorit të mikrokreditimit në Shqipëri, duke shqyrtuar evolucionin e institucioneve mikrofinanciare, produktet e ofruara, si dhe kuadrin rregullator dhe mbikëqyrës që drejton funksionimin e këtij sektori. Kjo analizë do të ndihmojë në kuptimin e mënyrës se si faktorët institucionalë dhe rregullatorë kanë ndikuar në zgjerimin e aksesit në kredi dhe në stabilitetin e sektorit.

Objektivi i tretë specifik synon të vlerësojë ndikimin e mikrokredisë në performancën ekonomike të NVM-ve, të cilat përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë shqiptare. Analiza do të fokusohet në ndikimin e kreditimit në rritjen e të ardhurave, zgjerimin e aktivitetit ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e kapaciteteve konkurruese të ndërmarrjeve të vogla.

Objektivi i katërt specifik vlerëson ndikimin dhe qëndrueshmërinë afatshkurtër dhe afatgjatë e kredive të ofruara në kuadër të programeve qeveritare dhe joqeveritare të mikrokreditit në Shqipëri mbi kushtet e jetesës së përfituesve, duke analizuar ndryshimet në të ardhura, punësim, stabilitet ekonomik dhe mirëqenie sociale të tyre..

Objektivi i pestë specifik është të propozojë politika publike dhe rekomandime institucionale për përmirësimin e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së mikrofinancës në Shqipëri. Duke u mbështetur në gjetjet empirike të studimit, do të sugjerohen masa konkrete që lidhen me përmirësimin e kuadrit rregullator, mbrojtjen e konsumatorit financiar, rritjen e edukimit financiar dhe integrimin e mikrofinancës me politikat më të gjera të zhvillimit ekonomik dhe social.

1.3.2. Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore janë formuluar duke pasqyruar objektin e këtij studimi si dhe kanë orientuar analizën empirike dhe teorike drejt vlerësimit të rolit afatgjatë të mikrokreditimit në zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri. Ato reflektojnë nevojën për të kuptuar jo vetëm efektet direkte të mikrokredisë, por edhe mekanizmat ndërmjetësues dhe faktorët institucionalë që ndikojnë në efektivitetin e saj.

Pyetja kryesore kërkimore: *Në çfarë mase mikrokreditimi ka kontribuar në rritjen ekonomike dhe në përmirësimin afatgjatë të kushteve të jetesës së përfituesve në Shqipëri?*

Kjo pyetje synon të vlerësojë në mënyrë të integruar ndikimin e mikrokredisë në dy dimensione kryesore: dimensionin makroekonomik, përmes kontributit në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e aktiviteteve prodhuese, dhe dimensionin mikroekonomik, përmes përmirësimit të mirëqenies së familjeve dhe performancës së ndërmarrjeve përfituese. Analiza do të synojë të identifikojë nëse mikrokreditimi ka prodhuar efekte të qëndrueshme dhe të matshme, apo nëse ndikimi i tij mbetet kryesisht afatshkurtër dhe i kushtëzuar nga faktorë të tjerë strukturorë.

Hipoteza kryesore: Mikrokreditimi ka një ndikim pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në rritjen ekonomike në nivel lokal dhe kombëtar në Shqipëri.

Kjo hipotezë bazohet në teorinë e ndërmjetësimit financiar dhe në literaturën që argumenton se zgjerimi i aksesit në kredi për ndërmarrjet e vogla dhe familjet rrit investimet, aktivitetin prodhues dhe konsumin, duke kontribuar kështu në rritjen e përgjithshme ekonomike. Testimi i kësaj hipoteze synon të verifikojë nëse rritja e portofolit të mikrokredive lidhet në mënyrë shkakësore me rritjen e PBB-së dhe zhvillimin ekonomik rajonal në Shqipëri.

Gjithashtu janë konceptuar disa nën-pyetjet kërkimore për të analizuar dimensionet e pyetjes kryesore në mënyrë më analitike më specifike empirikisht.

Nënpyetja e parë shqyrton marrëdhënien midis mikrokredisë dhe performancës ekonomike të bizneseve të vogla dhe NVM-ve: A ndikon mikrokredia në performancën ekonomike të bizneseve të vogla dhe NVM-ve?

Kjo pyetje synon të analizojë nëse mikro-kreditimi ndikon në rritjen e të ardhurave, zgjerimin e aktivitetit, investimet kapitale dhe krijimin e vendeve të reja të punës në ndërmarrjet e vogla. Ajo do të ndihmojë në kuptimin e rolit të mikrokredisë si një instrument për zhvillimin e sipërmarrjes dhe rritjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve në ekonominë shqiptare.

Nënpyetja e dytë fokusohet në dimensionin sektorial të ndikimit: A ka ndikuar mikrokreditimi në performancën ekonomike të sektorëve ekonomikë me fokus në sektorin bujqësor e blegtoral?

Kjo pyetje synon të identifikojë nëse efektet e mikrokredisë janë homogjene apo ndryshojnë sipas strukturës së sektorëve ekonomikë. Duke qenë se ekonomia shqiptare ka një peshë të rëndësishme të sektorit bujqësor dhe të turizmit, analiza sektoriale është thelbësore për të kuptuar në cilët sektorë mikrokredia prodhon efektet më të mëdha zhvillimore dhe në cilët sektorë ndikimi i saj mbetet i kufizuar.

Nënpyetja e tretë trajton dimensionin social të mikrokreditimit: A ka mikrokredia ndikim të qëndrueshëm në reduktimin e varfërisë dhe përfshirjen financiare?

Kjo pyetje synon të analizojë nëse mikrokredia kontribuon në përmirësimin e të ardhurave familjare, stabilitetin e konsumit, rritjen e pasurisë dhe uljen e varfërisë afatgjatë. Gjithashtu, vlerësohet nëse mikrokreditimi ka zgjeruar realisht përfshirjen financiare të grupeve të marginalizuara dhe ka reduktuar varësinë nga kreditimi informal.

Nënpyetja e katërt lidhet me dimensionin institucional dhe rregullator: Cilat janë reziqet institucionale dhe rregullatore që ndikojnë në efektivitetin e mikrokreditimit?

Kjo pyetje synon të identifikojë faktorët që mund të kufizojnë efektet pozitive të mikrokredisë, si normat e interesit, praktikat e huadhënies, mbikëqyrja rregullatore, niveli i edukimit financiar dhe kapaciteti institucional i ofruesve të mikrofinancës. Analiza e këtyre rreziqeve është thelbësore për të kuptuar kufizimet strukturore të modelit aktual të mikrokreditimit në Shqipëri.

Nënpyetja e pestë synon dimensionin normativ dhe politik: Si mund të optimizohet roli i mikrofinancës në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në Shqipëri?

Kjo pyetje orienton studimin drejt formulimit të rekomandimeve për politika publike dhe reforma institucionale që mund të rrisin efektivitetin e mikrokreditimit, duke balancuar dimensionin social me qëndrueshmërinë financiare të sektorit.

1.4. Metodologjia e kërkimit

Ky studim ka adoptuar një qasje holistike-induktive, e cila synon të kuptojë fenomenin në tërësinë e tij dhe të nxjerrë argumenta teorike nga evidenca empirike.

1.4.1. Qasja metodologjike

Qasja e kombinuar u zhvillua në dy nivele analitike të ndërlidhura. Së pari, analiza sasiore u përdor për të testuar marrëdhëniet shkakësore midis mikrokreditimit dhe treguesve ekonomikë, përmes modelit ekonometrik dhe analizave të ndikimit. Së dyti, analiza cilësore u fokusua në dimensionin institucional dhe rregullator, duke shqyrtuar rolin e institucioneve mikrofinanciare, politikave publike dhe praktikave të huadhënies në përcaktimin e efektivitetit të mikrokredisë. Ky kombinim metodologjik lejon triangulimin e të dhënave dhe rrit besueshmërinë e rezultateve, pasi gjetjet ekonometrike u interpretuan në dritën e evidencave institucionale dhe perceptimeve të përfituesve dhe aktorëve të sektorit financiar.

1.4.2. Burimi dhe analiza e të dhënave

Studimi u realizuar duke përdorur një kombinim të të dhënave sekondare dhe primare, me qëllim sigurimin e një baze të të dhënave empirike që të mundësohej një analizë sa më e plotë e objektit të hulumtimit. Të dhënat sekondare u mbledhën nga burime zyrtare institucionale, përfshirë Bankën e Shqipërisë, INSTAT dhe institucionet financiare jo-banka, pra mikrofinanciare. Të dhënat primare u mbledhën me anë të anketave në terren me përfitues të mikrokredisë dhe me ndërmarrje të vogla dhe të mesme që kanë përdorur kredi mikrofinanciare. Anketat mundësuan informacion mbi përdorimin e kredive, ndryshimet në të ardhura, investimet, punësimin dhe mirëqenien ekonomike të familjeve dhe bizneseve përfituese. Përzgjedhja e kampionit u realizua në mënyrë të strukturuar, duke siguruar përfaqësim sipas zonave gjeografike (urbane dhe rurale) dhe sektorëve ekonomikë. Përveç anketave, u realizuan intervista të gjysmë-strukturuara me përfaqësues të institucioneve mikrofinanciare, Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve rregullatore. Këto intervista synuan të hedhin dritë mbi politikat e kreditimit, praktikat e vlerësimit të rrezikut, sfidat rregullatore dhe perceptimet mbi qëndrueshmërinë e sektorit mikrofinanciar në Shqipëri.

Analiza e të dhënave u përqendrua në bazë të gjashtë kritereve të vlerësimit të të dhënave dytësore të shprehura nga Turgeon dhe Bernatchez (2009), përkatësisht: qëllimi i mbledhjes primare, personi përgjegjës për mbledhjen, informacioni që u mbledh, kur u mbledh, si u mor dhe vërtetimi i tij nga burime të tjera. Kjo analizë ndihmoi në interpretimin e rezultateve ekonometrike dhe në formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së mikrokreditimit.

Në tërësi, kjo metodologji e detajuar synon të sigurojë një analizë empirike rigorozë dhe të balancuar, e cila integron dimensionet sasiore dhe cilësore për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse rolin e mikrokreditimit në zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri.

1.5. Kontributi shkencor dhe origjinaliteti

Ky studim synon të japë kontribute teorike dhe empirike në literaturën mbi mikrofinancën, zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen financiare, veçanërisht në kontekstin e ekonomive në zhvillim si Shqipëria. Origjinaliteti i tij qëndron në qasjen e integruar dhe multidimensionale që ndërthur analizën ekonometrike me dimensionin institucional dhe social të mikrokreditimit.

Së pari, studimi synon të ofrojë analizën e parë gjithëpërfshirëse empirike mbi ndikimin afatgjatë të mikrokreditimit në Shqipëri, në ndryshim nga studimet ekzistuese, të cilat fokusohen kryesisht në analiza përshkruese ose në periudha të shkurtra kohore, duke krijuar vlerë të shtuar në avancimin e evidencës shkencore mbi rolin real të mikrofinancës në zhvillimin ekonomik të vendit.

Së dyti, studimi integron analizën mikroekonomike (në nivel familjesh dhe NVM-sh) me analizën makroekonomike dhe institucionale, duke marrë në konsideratë ndërveprimin midis rezultateve në nivel individ, strukturës së tregut financiar dhe kuadrit rregullator. Në këtë mënyrë, studimi tejkalon fragmentarizimin e literaturës ekzistuese dhe ofron një analizë më të plotë të mekanizmave përmes të cilëve mikrokredia ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social.

Së treti, studimi ofron evidencë empirike të rëndësishme për politikëbërësit dhe institucionet financiare mbi efektivitetin e mikrokreditimit si instrument zhvillimor. Duke identifikuar kanalet përmes të cilëve mikrokredia ndikon në performancën e NVM-ve, përfshirjen financiare dhe mirëqenien sociale, studimi do të ndihmojë në kuptimin e kushteve nën të cilat mikrofinanca prodhon rezultate të qëndrueshme dhe në cilat raste efektet e saj janë të kufizuara. Ky kontribut empiriko-politik e bën studimin veçanërisht të rëndësishëm për vendimmarrjen strategjike në sektorin financiar dhe në politikat e zhvillimit ekonomik.

Përveç kontributeve shkencore, ky studim ka një rëndësi të madhe praktike dhe politike, pasi rezultatet e tij do të kenë implikime të drejtpërdrejta për hartimin dhe përmirësimin e politikave publike në fushën e përfshirjes financiare, zhvillimit të NVM-ve dhe reduktimit të varfërisë në Shqipëri.

Së pari, studimi ndihmon në hartimin e politikave të përfshirjes financiare në Shqipëri, duke ofruar evidencë mbi efektivitetin e mikrokreditimit në zgjerimin e aksesit në shërbime financiare për grupet e marginalizuara. Gjetjet e tij do të ndihmojnë institucionet publike dhe financiare të kuptojnë se cilat mekanizma të kreditimit janë më efektivë për të reduktuar përjashtimin financiar dhe për të promovuar integrimin ekonomik të individëve dhe bizneseve të vogla.

Së dyti, studimi mund të ndikojë për rregullimin e sektorit të mikrofinancës dhe mbrojtjen e konsumatorëve financiarë. Duke identifikuar rreziqet që lidhen me normat e interesit, mbingarkesën me borxhe dhe praktikën e huadhënies, kërkimi ofron rekomandime për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar balancën midis qëndrueshmërisë financiare të institucioneve mikrofinanciare dhe mbrojtjes së interesave të përfituesve të kredive.

Së treti, rezultatet e studimit kanë rëndësi për mbështetjen e NVM-ve dhe zhvillimin rural, duke evidentuar rolin e mikrokreditimit në financimin e aktiviteteve prodhuese, zgjerimin e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës në zonat rurale dhe periferike. Kjo mund të ndihmojë në orientimin e politikave të zhvillimit rajonal dhe në integrimin e mikrofinancës me programet kombëtare dhe evropiane të mbështetjes për sipërmarrjen e vogël dhe bujqësinë.

Së katërti, studimi mund të ndikojë në formulimin e strategjive më efektive për reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Duke analizuar ndikimin e mikrokreditimit në mirëqenien sociale dhe përfshirjen ekonomike të familjeve përfituese, hulumtimi ndihmon në kuptimin e rolit të mikrofinancës si një instrument komplementar i politikave sociale dhe ekonomike. Kjo mund të përdoret për mbështetjen në hartimin e strategjive gjithëpërfshirëse që kombinojnë kreditimin me edukimin financiar, trajnimin profesional dhe mbështetjen institucionale për zhvillim afatgjatë.

Në përfundim, rëndësia praktike dhe politike e këtij studimi qëndron në aftësinë e tij për të ofruar fakte të besueshme dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e politikave të përfshirjes financiare, rregullimit të sektorit mikrofinanciar, zhvillimit të NVM-ve dhe reduktimit të varfërisë në Shqipëri. Kjo e bën studimin jo vetëm një kontribut akademik, por edhe një instrument të rëndësishëm për vendimmarrjen strategjike dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

1.6. Struktura e punimit

Kapitulli i dytë paraqet një rishikim kritik të literaturës mbi mikrokreditimin, duke analizuar debatet teorike dhe evidencat empirike lidhur me ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik dhe social. Ai thekson se, megjithëse mikrokredia është promovuar si një instrument i rëndësishëm për përfshirjen financiare dhe reduktimin e varfërisë, studimet ndërkombëtare ofrojnë rezultate të përziera mbi efektet e saj afatgjata. Literatura eidenton vështirësi metodologjike në matjen e ndikimit real të mikrokredisë, për shkak të kufizimeve në të dhëna, paragjykimeve në përzgjedhjen e mostrave dhe kompleksitetit të proceseve socio-ekonomike që shoqërojnë përdorimin e kredive të vogla. Në këtë kuadër, kapitulli argumenton se ndikimi i mikrokreditimit nuk është automatikisht pozitiv dhe mund të jetë i kufizuar ose heterogjen, sidomos kur kreditë përdoren për konsum afatshkurtër ose kur shoqërohen me rreziqe të mbingarkesës me borxhe. Në vijim, kapitulli identifikon kushtet strukturore dhe institucionale që përcaktojnë efektivitetin e mikrokredisë në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale. Ai thekson rëndësinë e orientimit të kredive drejt aktiviteteve

Disa studime shqiptare shkojnë përtej nivelit të familjeve për të shqyrtuar lidhjet makroekonomike. Duke përdorur seritë kohore dhe qasjet ARDL, studiuesit zbulojnë se rritja e portofoleve të kredive bruto të mikrofinancës është e lidhur pozitivisht me treguesit makro dhe uljen e varfërisë në afat të mesëm (Doçi, 2017). Një analizë e dedikuar për vitet 2013–2023 gjen një marrëdhënie të fortë pozitive midis mikrokredisë dhe rritjes reale të PBB-së, pasi si vëllimet e kredisë ashtu edhe numri i klientëve u rritën gjatë dekadës (Angjeli et al., 2025). Megjithatë, autorët paralajmërojnë në mënyrë të qartë se këto janë gjetje shoqëruese dhe se shkakësia, kanalet (p.sh., kredia e investimeve kundrejt kredisë së konsumit) dhe efektet shpërndarëse kërkojnë studime të mëtejshme (Angjeli et al., 2025). Puna specifike për

turizmin tregon një marrëdhënie pozitive midis mikrokredisë dhe zhvillimit të turizmit, veçanërisht përmes ndërmarrjeve të vogla turistike në zonat rurale dhe malore, por provat janë të kufizuara në analizën përshkruese dhe të thjeshtë të regresionit (Kola et al., 2019).

Zgjerimi i shpejtë ka ndryshuar profilet e rrezikut të IMF-ve. Analizat në Shqipëri nxjerrin në pah rrezikun operacional si një sfidë qendrore, veçanërisht pasi institucionet zgjerohen me shpejtësi dhe nganjëherë neglizhojnë kontrollet e rrezikut (Delija, 2015). Rreziqet e identifikuar përfshijnë procedura të dobëta të brendshme, trajnim të pamjaftueshëm të stafit, dobësi të sistemit të informacionit dhe vëmendje të pamjaftueshme ndaj mashtrimit dhe vlerësimit të kreditit, të cilat të gjitha mund të dëmtojnë cilësinë e portofolit dhe mbrojtjen e klientit (Delija, 2015). Mbipërqendrimi sektorial në kreditimin rural dhe bujqësor i ekspozon gjithashtu IMF-të ndaj rreziqeve të motit, çmimeve dhe strukturore (Marku, 2016; Doçi, 2017; Duçi et al., 2025). Në të njëjtën kohë, IMF-të përballen me presion për t'u bërë financiarisht të vetëmjaftueshëm, duke ruajtur një mision social, duke reflektuar tensionin global midis shtrirjes tek më të varfrit dhe qëndrueshmërisë komerciale (Milana & Ashta, 2020; Ribeiro et al., 2022; Postelnicu & Hermes, 2018; Lwesya & Mwakalobo, 2023). Vështirëtimet e fundit sektoriale për Shqipërinë e tregojnë periudhën 2023–2024 si një periudhë investimesh të intensifikuara në dixhitalizim dhe përmirësim teknologjik, e cila kërkon burime të konsiderueshme financiare dhe organizative, por shihet si e nevojshme për të mbetur konkurrues dhe për t'i shërbyer një baze klientësh të shpërndarë (Pjetri et al., 2024).

Përhapja e shpejtë e institucioneve financiare jobankare dhe ofruesve të mikrokredive ka ngritur çështje rregullatore dhe ligjore. Studimet ligjore diskutojnë iniciativën e Bankës së Shqipërisë për të vendosur kufij mbi normat e interesit të kredisë konsumatore për institucionet jobankare, duke përfshirë ofruesit e mikrokredive, për të frenuar çmimet abuzive dhe për të zbutur veprën penale të "mashtrimit të kreditit". Kjo pasqyron shqetësime më të gjera në lidhje me praktikat agresive të huadhënies, njohuritë e pamjaftueshme financiare dhe rritjen e kredive me probleme në sistemin bankar pas vitit 2009, të cilat zhvendosin një pjesë të kërkesës drejt mikrofinancës (Duçi et al., 2025). Debati përqendrohet nëse dhe si banka qendrore është e autorizuar ligjërisht për të vendosur kufij të tillë, dhe cilat mund të jenë pasojat e padëshiruara për ofertën e kredisë, qëndrueshmërinë institucionale dhe aksesin e klientëve. Studimet e mikrofinancës të orientuara drejt politikave kërkojnë gjithashtu një mjedis institucional më të favorshëm, por të rregulluar mirë, duke përfshirë rregulla më të qarta, mbikëqyrje më të mirë dhe strategji të koordinuara midis qeverisë, IMF-ve dhe partnerëve ndërkombëtarë (Pjetri et al., 2024; Doçi, 2017).

Bujqësia identifikohet vazhdimisht si e pashërbyer nga sistemi bankar formal, me kreditimin bankar për bujqësinë që përbën vetëm një pjesë të vogël të kredisë totale (Doçi, 2017). Prandaj, mikrokredia rurale portretizohet si "mjeti i vetëm" për shumë familje rurale për të siguruar jetesën (Marku, 2016). Megjithatë, puna empirike dokumenton pengesa të konsiderueshme: procedura komplekse, mungesë kolaterali,

shërbime të dobëta zgjerimi dhe ndërgjegjësim të kufizuar për produktet në dispozicion (Marku, 2016; Zeneli & Reci, 2023). Këto kufizime kontribuojnë në investime të ulëta, nënshfrytëzim të burimeve natyrore dhe varfëri të vazhdueshme rurale, pavarësisht potencialit të njohur konkurrues të bujqësisë shqiptare (Marku, 2016; Doçi, 2017). Studimet më të reja mbi mikrofinancën dhe bujqësinë theksojnë nevojën për produkte që pasqyrojnë rreziqet specifike të sektorit (sezonalitetin, goditjet e motit) dhe për mbështetje plotësuese siç janë shërbimet këshillimore, trajnimi dhe lehtësimi i aksesit në fondet e zhvillimit rural të BE-së (Doçi, 2017; Duçi et al., 2025).

Hulumtimet empirike në Shqipëri tregojnë se IMF-të luajnë një rol të rëndësishëm në financimin e NVM-ve dhe bizneseve shumë të vogla që përballen me vështirësi në aksesin në kredi bankare (Deliya, 2017; Doçi, 2017; Duçi et al., 2025). Puna e bazuar në anketa me fermerë dhe NVM-të zbulon se mikrofinanca kontribuon në fillimin, zgjerimin dhe performancën e biznesit, dhe identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në efektivitetin e mikrokredisë, siç janë madhësia e kredisë, kushtet e ripagimit, shqyrtimi i klientëve dhe mbështetja jofinanciare (Deliya, 2017). Hulumtimet më të fundit sasiore theksojnë rëndësinë e mikrofinancës për rritjen e NVM-ve dhe stabilitetin e të ardhurave, ndërsa nënvizojnë gjithashtu normat e larta efektive të interesit dhe nevojën për të zgjatur periudhat e ripagimit dhe për të ulur kostot për të shmangur mbingarkesën me borxh (Duçi et al., 2025). Analizat bibliometrike ndërkombëtare konfirmojnë se kufizimet e aksesit për NVM-të, qëndrueshmëria e IMF-ve dhe modelet e vlerësimit të kreditit mbeten tema qendrore kërkimore, me pikëzimin dixhital të kreditit dhe fintech që pritet të formësojnë zhvillimet e ardhshme (Lwesya & Mwakalobo, 2023).

Mikrofinanca shqiptare historikisht ka theksuar shtrirjen te gratë dhe familjet rurale (Loca et al., 2014; Doçi, 2017), duke u përafuar me narrativat ndërkombëtare mbi fuqizimin e grave. Rishikimet e strukturara globale tregojnë se mikrofinanca mund të mbështesë sipërmarrjen e grave, por gjithashtu se mund të përforcojë përjashtimin dhe diskriminimin nëse institucionet dhe strukturat e komunitetit kufizojnë agjencinë efektive të grave mbi kreditë dhe bizneset (Ranabahu & Tanima, 2021; Ribeiro et al., 2022). Megjithatë provat specifike të vendit për Shqipërinë mbi këto çështje mbeten të pakta, shqetësimi i përgjithshëm është se ndryshimi i misionit, standardizimi i produktit dhe një orientim më i fortë tregtar mund të zvogëlojnë vëmendjen ndaj klientëve më vulnerabël. Puna ndërkombëtare ndërvendore mbi kapitalin social sugjeron që mikrofinanca performon më mirë, si financiarisht ashtu edhe shoqërisht, në kontekste me rrjete sociale mbështetëse dhe norma të forta bashkëpunimi dhe besimi - faktorë që mund të ndryshojnë në të gjitha rajonet e Shqipërisë dhe komunitetet e prekura nga migrantët (Postelnicu & Hermes, 2018; Zeneli & Reci, 2023).

2.3.3. Mungesat në literaturën vendase dhe rëndësia e këtij studimi

Analiza e literaturës shqipe mbi mikrofinancën dhe mikrokreditin në Shqipëri evidenton një progres të dukshëm në trajtimin e rolit të saj në përfshirjen financiare

dhe zhvillimin ekonomik, por njëkohësisht nxjerr në pah kufizime të rëndësishme empirike dhe boshllëqe të qëndrueshme kërkimore. Studimet ekzistuese kanë kontribuar në kuptimin e dinamikave të tregut dhe ndikimeve potenciale sociale, megjithatë ato shpesh karakterizohen nga varësi ndaj të dhënave dytësore, mostra të kufizuara dhe metoda analitike me fuqi të kufizuar inferenciale. Në këtë kontekst, bëhet e domosdoshme një vlerësim kritik i bazës empirike dhe i orientimeve kërkimore, me qëllim identifikimin e mangësive strukturore në literaturë dhe përcaktimin e prioriteteve për studime më rigorozë, ndërdisiplinore dhe të mbështetura në metoda të përziera.

Disa autorë shqiptarë vënë në dukje në mënyrë të qartë mungesën e të dhënave dhe kufizimet metodologjike. Studimet shpesh mbështeten në të dhëna dytësore nga faqet e internetit të IMF-ve dhe autoritetet mbikëqyrëse, dhe raportojnë mungesë të statistikave zyrtare të mikrofinancës të disagreguara dhe hulumtime të kufizuara paraprake në Shqipëri mbi të cilat mund të ndërtohen (Ndoka & Sako, 2022; Pjetri et al., 2024; Doçi, 2017; Kola & Çerpja, 2018). Vlerësimet e ndikimit shpesh përdorin krahasime para dhe pas ose regresione të thjeshta, me mostra të vogla ose studime rastesh lokale, gjë që kufizon inferencën shkakësore në lidhje me varfërinë, migrimin dhe rezultatet e fuqizimit (Loca et al., 2014; Ndoka & Sako, 2022; Zeneli & Reci, 2023; Delija, 2017). Rishikimet ndërkombëtare theksojnë se kërkimi mbi mikrofinancën mbetet kryesisht në fokus ekonomik, me relativisht pak studime nga shëndetësia, psikologjia ose sociologjia, dhe bëjnë thirrje për vlerësime më holistike dhe me metoda të përziera të rezultateve sociale (Ribeiro et al., 2022; Milana & Ashta, 2020; Lwesya & Mwakalobo, 2023). Për Shqipërinë, prioritetet e ardhshme të identifikuar përfshijnë vlerësimin rigoroz të ndikimit të programeve të mikrokredisë, analizën e mbingarkesës me borxh dhe mbrojtjen e klientëve, rezultatet e ndara sipas gjinisë dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të kreditimit rural dhe bujqësor (2022; Angjeli et al., 2025; Pjetri et al., 2024; Marku, 2016; Duçi et al., 2025).

Gjatë dekadës së fundit të hulumtimeve, mikrokredia në Shqipëri duket si një instrument i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për zhvillim gjithëpërfshirës. Çështjet kryesore aktuale mund të përmbledhen si më poshtë :

- Zgjerimi ka përmirësuar qartë aksesin në financë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, familjet rurale dhe ndërmarrjet turistike, dhe është i lidhur pozitivisht me rritjen makroekonomike.
- Provat e reduktimit të qëndrueshëm të varfërisë, transformimit strukturor dhe reduktimit të emigracionit janë më modeste, shpesh afatshkurtra dhe metodologjikisht të brishta.
- Rritja e shpejtë dhe presionet tregtare gjenerojnë sfida të rrezikut operacional, mbingarkesës me borxhe të klientëve dhe një ndryshim të mundshëm të misionit.
- Iniciativat rregullatore dhe ligjore (p.sh., kufijtë e normave të interesit, mbikëqyrja më e fortë) kërkojnë të balancojnë mbrojtjen e klientit dhe qëndrueshmërinë institucionale, por krijojnë kompromise komplekse.

- Boshllëqet e vazhdueshme rurale, gjinore dhe të lidhura me cenueshmërinë sugjerojnë nevojën për produkte të përshtatura, shërbime plotësuese jofinanciare dhe integrim më të mirë me politikat më të gjera të zhvillimit.

2.4. Përmbledhje e kapitullit

Ky kapitull trajton në mënyrë të zgjeruar evolucionin teorik dhe empirik të mikrokreditimit, duke analizuar transformimin e debatit akademik nga qasje normative dhe histori suksesi drejt një vlerësimi më kritik dhe metodologjikisht më rigoroz të ndikimit të tij në zhvillimin ekonomik dhe social. Fillimisht, kapitulli përshkruan fazën e hershme të literaturës, e cila e konsideronte mikrokreditin si një instrument pothuajse universal për reduktimin e varfërisë dhe fuqizimin ekonomik, ndërsa më pas paraqet zhvendosjen drejt analizave empirike më të strukturuar, që evidentojnë rezultate më të moderuara dhe shpesh kontradiktore.

Një pjesë e rëndësishme e kapitullit i kushtohet sfidave metodologjike në matjen e ndikimit, përfshirë problemet e atributimit shkakësor, paragjykimin e përzgjedhjes, përdorimin e mostrave të vogla, mungesën e të dhënave afatgjata dhe kufizimet e eksperimenteve të rastësishme. Diskutohet gjithashtu dallimi ndërmjet rritjes së aktivitetit ekonomik dhe reduktimit të qëndrueshëm të varfërisë, duke theksuar se efektet e mikrokredisë shpesh janë heterogjene dhe të varura nga konteksti institucional, struktura e tregut dhe karakteristikat e huamarrësve.

Kapitulli analizon kushtet nën të cilat mikrokreditimi mund të gjenerojë ndikime pozitive, duke përfshirë përdorimin produktiv të kredisë, nivelin e kostos së saj, integrimin me shërbime jofinanciare, stabilitetin makroekonomik dhe cilësinë e kuadrit rregullator. Një vëmendje e veçantë i kushtohet rrezikut të mbingarkesës me borxh, presioneve tregtare dhe mundësisë së devijimit nga misioni social i institucioneve mikrofinanciare.

Në përfundim, kapitulli argumenton se mikrokredia duhet të konsiderohet si një instrument i rëndësishëm, por jo i mjaftueshëm për zhvillim gjithëpërfshirës. Efektiviteti i saj varet nga ndërthurja me politika të tjera zhvillimore, nga forca e institucioneve dhe nga dizenjimi i kujdesshëm i produkteve financiare. Kjo analizë krijon bazën teorike dhe analitike për shqyrtimin empirik të rastit shqiptar në vijim të studimit.

KAPITULLI 3-QASJA EPISTEMOLOGJIKE DHE METODOLOGJIKE

Rishikimi kritik i literaturës përbën një komponent thelbësor të këtij studimi, pasi ai krijon bazën teorike dhe analitike për vlerësimin e rolit të mikrokreditimit në zhvillimin ekonomik dhe social, veçanërisht në kontekstin shqiptar. Ky kapitull synon të sintetizojë dhe të analizojë në mënyrë kritike debatet akademike dhe evidencat empirike mbi efektivitetin e mikrokredisë si instrument përfshirjeje financiare dhe reduktimi të varfërisë, duke evidentuar kontradiktat, kufizimet metodologjike dhe boshllëqet kërkimore që karakterizojnë literaturën ekzistuese. Në vend që të mbështetet në një narrativë lineare dhe optimiste, kapitulli ndërton një qasje reflektuese që shqyrton në mënyrë të balancuar si efektet pozitive të raportuara në literaturë, ashtu edhe rreziqet potenciale që lidhen me mbingarkesën me borxhe, përdorimin joproduktiv të kredive dhe ndikimet e kufizuara në rritjen afatgjatë të të ardhurave.

Në këtë kuadër, kapitulli është i orientuar nga një perspektivë sistemike dhe ndërdisiplinare, në përputhje me qasjen epistemologjike holistike-induktive të studimit, e cila e konsideron mikrokreditimin si një fenomen kompleks që ndërthur dimensione ekonomike, sociale, kulturore dhe institucionale.

3.1 Qasje epistemologjike dhe metodologjike

Përmes analizës së literaturës ndërkombëtare dhe kombëtare, synohet të identifikohen kushtet nën të cilat mikrokreditimi mund të kontribuojë realisht në zhvillim, si dhe faktorët që kufizojnë efektivitetin e tij. Kjo qasje mundëson jo vetëm një kuptim më të thellë të mekanizmave përmes të cilëve mikrokredia ndikon në mirëqenien e përfituesve, por edhe vendos themelet konceptuale për analizën empirike të kapitujve vijues të punimit.

3.1.1. Qasje epistemologjike

Pozicionimi epistemologjik është një dimension themelor në çdo studim kërkimor, pasi ai përcakton mënyrën se si studiuesi kupton natyrën e dijes, marrëdhëniet mes fenomenit të studiuar dhe perceptimit të tij, si dhe modalitetet e arritjes së njohurive të vlefshme dhe të besueshme. Në kontekstin e këtij studimi, i fokusuar mbi ndikimin e programeve të mikrokreditimit në financimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve shqiptare, zgjedhja e qasjes epistemologjike nuk është thjesht një çështje formale, por një komponent strategjik i lidhur ngushtë me koherencën metodologjike dhe rigorozitetin akademik të punimit.

Për këtë arsye, ky studim adoptuar një qasje holistike-induktive, e cila synon të kuptojë fenomenin në tërësinë e tij dhe të nxjerrë ligjërime teorike nga evidenca empirike. Qasja holistike nënkupton se ndikimi i mikrokredisë nuk mund të kuptohet vetëm në terma financiarë apo ekonomikë, por duhet analizuar si një fenomen multidimensional, ku elementë ekonomikë, socialë, kulturorë dhe institucionalë ndërthuren në mënyrë komplekse. Nga ana tjetër, aspekti induktiv i qasjes

epistemologjike fokusohet në identifikimin e modeleve dhe lidhjeve që burojnë drejtpërdrejt nga të dhënat, duke minimizuar supozimet paraprake dhe duke i lejuar të dhënave të “flasin vetë”. Kjo qasje është veçanërisht e përshtatshme për studime mbi mikrokreditimin, ku efektet mund të jenë të shumëfishta dhe shpesh të ndërlydhura me faktorë socio-ekonomikë dhe kulturorë që nuk janë lehtësisht të vëzhgueshëm përmes instrumenteve kuantitative të ngushta.

Metodologjia që përfshin ky pozicion epistemologjik është gjithashtu interdisiplinare, duke integruar qasje të ekonomisë zhvillimore, shkencave sociale, antropologjisë dhe studimeve gjinore. Kjo i mundëson studiuesit të analizojë fenomenin jo vetëm në aspektin e tij ekonomik, por edhe duke vlerësuar ndikimet mbi strukturat sociale, marrëdhëniet familjare, dinamikat gjinore dhe ndikimet e mundshme ekologjike, duke siguruar një kuptim të thellë dhe të nuancuar të rolit të mikrokredisë në kontekstin shqiptar. Ky pozicion epistemologjik përcakton gjithashtu një etikë të qartë të interpretimit të të dhënave, ku studiuesi është i vetëdijshëm për kufizimet e të dhënave dhe për nevojën e triangulimit midis burimeve të ndryshme. Qasja *holistike-induktive* kërkon reflektim kritik për rolin e subjektivitetit në interpretimin e të dhënave, duke siguruar që gjetjet të bazohen mbi evidencë dhe jo mbi supozime paraprake.

3.1.2. Qasje metodologjike

Në përputhje me pozicionin epistemologjik të përmendur më sipër, ky studim adoptoi një metodologji të kombinuar, që përfshin analiza sasiore dhe cilësore, duke përdorur të dhëna primare dhe sekondare. Kjo qasje metodologjike synon të sigurojë një kuptim të gjithanshëm të ndikimeve të mikrokreditimit, duke përfshirë efektet financiare, sociale, kulturore dhe ekologjike. Analiza e të dhënave sekondare përbën një komponent kryesor të këtij studimi. Të dhënat sekondare përfshijnë raporte institucionale, vlerësime të ndikimit të projekteve të mikrokredisë, disertacione masteri dhe teza doktore, si dhe studime të publikuara nga organizata ndërkombëtare si Banka Botërore, UNDP dhe institucione akademike. Përdorimi i këtyre burimeve na lejon të aksesojmë të dhëna të rralla dhe të vlerësuara nga kolegët dhe ekspertët e fushës, duke ofruar një bazë solide për interpretimin e rezultateve. Metodologjia sekondare është veçanërisht e dobishme për të identifikuar trendet historike dhe evolucionin e mikrokreditimit, për të vlerësuar ndryshimet në strukturën e tregut dhe për të kuptuar kontekstin socio-ekonomik në të cilin funksionojnë programet mikrofinanciare.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave primare u krye përmes intervistave të thelluara, fokus-grupet dhe pyetësorëve të strukturuar të aplikuar tek përfituesit e mikrokredisë, si dhe tek përfaqësues të institucioneve mikrofinanciare dhe aktorëve vendorë. Ky komponent metodologjik na mundëson të hetojmë përvojën e drejtpërdrejtë të përfituesve, perceptimet e tyre mbi ndikimin ekonomik dhe social të kredive, si dhe sfidat dhe mangësitë e përjetuara gjatë përdorimit të mikrokredisë.

Kombinimi i analizave sasiore dhe cilësore ofron mundësinë për të trianguluar të dhënat dhe për të rritur validitetin dhe besueshmërinë e rezultateve. Analizat sasiore

mund të identifikojnë modele statistike, normat e ripagimit, ndikimet mbi të ardhurat familjare dhe përqindjet e pjesëmarrjes, ndërsa analizat cilësore ofrojnë një pasqyrë të thellë mbi perceptimet, përvojat subjektive dhe kontekstualizimin e efekteve të mikrokredisë.

Përdorimi i qasjes holistike-induktive ka avantazhe të rëndësishme metodologjike:

- Kapaciteti për të përfshirë shumë burime dhe perspektiva: Duke kombinuar të dhëna primare dhe sekondare, studimi kap dimensionet ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të mikrokredisë.
- Rritja e rigorozitetit interpretues: Triangulimi midis të dhënave cilësore dhe sasore minimizon subjektivitetin dhe mundësinë e interpretimit të njëanshëm.
- Kuptimi i nuancave kontekstuale: Analizat cilësore lejojnë hulumtimin e ndikimeve që nuk janë të dukshme në të dhënat statistikore, si tensionet gjinore, ndryshimet në marrëdhëniet sociale dhe ndikimet mjedisore të mikro-sipërmarrjeve.
- Eficienca dhe qasja e integruar: Përdorimi i të dhënave sekondare lejon një kursim kohor dhe një fokus më të thellë në analizën dhe interpretimin kritik të informacionit të mbledhur, duke përfituar nga eksperiencia dhe vlerësimet e kryera nga studiues dhe organizata të specializuara.
- Ky kombinim metodologjik i përshtatet në mënyrë të veçantë objektivave të punimit, duke i mundësuar studiuesit të identifikojë ndikimet e drejtpërdrejta dhe indirekte të mikrokredisë, të kuptojë mënyrat e përfshirjes së përfituesve në aktivitetet ekonomike dhe sociale, dhe të formulojë rekomandime të bazuara mbi evidencë për politikëbërësit dhe aktorët mikrofinanciarë.

3.2. Objektivat, pyetja kërkimore dhe kampionimi

Sikurse është trajtuar në kapitullin e mëparshëm, debatet e shumta teorike dhe evidencat kontradiktore të paraqitura në literaturën ekzistuese mbi mikrokreditimin, e orientuan këtë studim drejt shqyrtimit kritik të ndikimit afatgjatë të kredive të marra nga përfituesit e programeve të mikrokredisë. Kjo qasje u ndërmor për të analizuar në mënyrë më të thelluar rolin që mikrokredia ka luajtur në përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të aktorëve ekonomikë, veçanërisht në një periudhë kur ky instrument financiar ka qenë një burim i rëndësishëm financimi për bizneset e vogla që operojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së vendit.

Konkretisht, objektivat e studimit janë:

- Eksplorimi i konceptit të kushteve të huamarrjes për të kuptuar faktorët e besueshëm që i krijojnë ato;
- Të kuptojë ndikimin e kredive të dhëna në programet qeveritare dhe joqeveritare të mikrokreditit në Shqipëri në kushtet e jetesës së përfituesve;

- Analizojë situatën e qëndrueshmërisë së mikrokredivë mbi kushtet e jetesës së përfituesve që kanë marrë pjesë në programet e mikrokredivë;
- Të formulojë rekomandime për përmirësimin e kushteve të qëndrueshme të jetesës së popullatave që përfitojnë nga mikrokredia.

3.2.1. Pyetja kërkimore

Për të adresuar dhe në kontekstin e objektivave të ndërtua pyetja kërkimore e studimit:

Në ç'masë ka kontribuar mikrokredia në rritjen ekonomike në Shqipëri dhe a ka ndikuar ajo në përmirësimin afatgjatë të kushteve të jetesës së përfituesve?

Kjo pyetje trajton nëse rritja e aksesit në mikro kredi ka pasur ndikime të matshme ekonomike. Nën pyetjet kërkimore që udhëheqin analizën e kësaj pyetje kryesore janë: *A ka ndikuar mikrokredia në përmirësimin e performancës ekonomike të bizneseve të vogla në Shqipëri dhe si ndryshon ky ndikim në qarqe të ndryshme? A ka ndikuar mikrokredia në përmirësimin e performancës ekonomike të sektorit bujqësor dhe blegtoral ?*

Hipoteza kryesore e këtij hulumtimi është: *Mikrokredia ka një ndikim pozitiv të matshëm në rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në nivel lokal dhe kombëtar.*

3.2.2. Ndërtimi i kampionit

Ky studim mbështetet në një strategji kampionimi të kombinuar, e ndërtuar mbi parime teorike dhe praktike, me qëllim sigurimin e përfaqësimit sektorial dhe rajonal të përfituesve të mikrokredivë në Shqipëri. Duke qenë se popullata e synuar përbëhet nga përfitues aktivë të mikrokredivë dhe institucione financiare specifike, nuk ishte e mundur aplikimi i kampionimit probabilitar klasik për shkak të mungesës së një kornize të plotë të regjistruar të popullatës dhe kufizimeve në akses. Për rrjedhojë, u aplikua një kampionim jo-probabilitar me qëllim i kombinuar me elemente të stratifikimit sipas sektorit dhe rajonit gjeografik.

Popullata e synuar përfshin institucionet e mikrokredivë që operojnë në qytetet kryesore të Shqipërisë, mikro-ndërmarrjet në sektorin e tregtisë me pakicë që kanë përfituar mikro kredi, fermerë dhe blegtorë në zonat rurale që kanë aksesuar financim mikro. Kjo strukturë lejon analizë krahasuese midis sektorit urban dhe rural, aktivitetit tregtar dhe atij bujqësor, si dhe niveleve të ndryshme të zhvillimit ekonomik rajonal.

Në nivel institucional, u përzgjedhën 12 institucione mikrokredivë që operojnë në qytetet kryesore (Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër). Përzgjedhja u bazua në aktivitetin e tyre të vazhdueshëm në tregun e mikrofinancës, rëndësinë e portofolit të kredivë, si dhe shtrirjen gjeografike dhe aksesin në përfitues. Kjo qasje siguron përfaqësimin e aktorëve kryesorë në tregun e mikrofinancës në Shqipëri dhe mundëson analizë institucionale të praktikave të kreditimit.

Kampioni urban përfshin 51 mikro-ndërmarrje që operojnë në sektorin e tregtisë me pakicë. Përzgjedhja u bë mbi bazën e kriterëve, të cilat konsistojnë në të pasurit kredi aktive mikrokredie, të kenë vazhdimsi të aktivitetit, si dhe të ishin të gatshëm të merrnin pjesë në intervistë. Shpërndarja gjeografike u organizua në mënyrë të tillë që të përfshijë qytetet me aktivitet më të lartë ekonomik, duke garantuar diversitet në madhësinë e tregut dhe strukturën e biznesit.

Kampioni rural përfshin 42 fermerë dhe blegtorë nga rajonet e Dibrës, Korçës dhe Fierit. Këto zona u përzgjedhën për shkak të nivelit të aktivitetit bujqësor, si dhe shkallës së përdorimit të mikrokredisë.. Kjo ndarje lejon analizimin e ndikimit të mikrokredisë në ekonomi me strukturë prodhuese tradicionale dhe me akses të kufizuar në financim bankar.

Përdorimi i kampionimit me qëllim është konsideruar i përshtatshëm metodologjikisht studimi synon analizë të thelluar të përfituesve realë dhe jo përfaqësim statistikor të popullatës së përgjithshme, gjithashtu, aksesit tek të intervistuarit është i ndërmjetësuar nga institucionet financiare, si dhe qëllimi i kërkimit është vlerësimi i ndikimit dhe performancës, jo estimimi i prevalencës në nivel kombëtar.

Kjo qasje kufizon generalizimin statistikor dhe rezultatet interpretohen në kuadër të përgjithësimi analitik (analytic generalization), në përputhje me literaturën metodologjike për kërkimet e aplikuara në ekonomi dhe financë zhvillimore. Megjithatë, struktura e kampionit ofron balancë sektoriale dhe rajonale të mjaftueshme për analizë të qëndrueshme empirike.

3.3. Mbledhja e të dhënave dhe burimet bibliografike

Një komponent kyç i rigorozitetit akademik është përdorimi i burimeve të besueshme dhe të diversifikuara që mundësojnë një analizë të plotë dhe të bazuar mbi evidencë. Në këtë mënyrë ky studim është realizuar duke përdorur për analizën empirike të dhënat dytësore si dhe të dhënat primare.

3.3.1. Burimet bibliografike

Në këtë studim, të dhënat dytësore janë mbledhur nga një gamë e gjerë institucionesh dhe publikimesh, duke u fokusuar mbi literaturën kombëtare dhe ndërkombëtare që trajton ndikimin e programeve të mikrokreditimit. Burimet kryesore përfshijnë:

Institucionet qeveritare. Në krye të tyre qëndron INSTAT (Instituti Kombëtar i Statistikave), i cili ofron të dhëna të detajuara mbi tregun e punës, nivelin e varfërisë, të ardhurat e familjeve, dhe tregues të tjerë socio-ekonomikë të rëndësishëm për kontekstualizimin e mikrokredisë. Raportet vjetore dhe studimet tematike të INSTAT-it sigurojnë një bazë statistike të besueshme dhe të standardizuar për analizën sasiore.

Institucionet ndërkombëtare dhe joqeveritare. Raportet e UNDP-së (Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara), Bankës Botërore, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe institucioneve të tjera mikrofinanciare ndërkombëtare u përdorën për të krahasuar të dhënat shqiptare me standardet rajonale

dhe globale, duke ofruar një perspektivë komparative mbi zhvillimin dhe efektivitetin e mikrokredisë. Këto burime ndihmojnë gjithashtu në identifikimin e praktikave më të mira dhe tendencave ndërkombëtare në mikrofinancë.

Institucionet mikrofinanciare dhe raportet institucionale. Ne u përqendruam në raporte të fundit të vlerësimit të ndikimit të mikrokredisë nga institucionet që operojnë në Shqipëri. Këto raporte përfshijnë analiza mbi ripagimin e kredive, përfitimet ekonomike për individët dhe familjet, si dhe vlerësime të ndikimeve sociale dhe kulturore të programeve mikrofinanciare.

Literatura akademike dhe dokumente kërkimore. Artikuj të publikuar në revista shkencore, disertacione masteri dhe teza doktorature që trajtojnë fenomene të ngjashme në Shqipëri dhe rajon, janë përdorur për të zgjeruar perspektivën teorike të studimit dhe për të kontekstualizuar gjetjet. Kjo literaturë ofron baza teorike për interpretimin e të dhënave dhe identifikimin e boshllëqeve kërkimore që ky studim synon të adresojë.

Vizitat dhe komunikimi me aktorë vendorë. Për të pasuruar analizën, u kryen vizita aktive dhe intervista informale në disa prej shoqërive të mikrokreditimit në Shqipëri. Këto kontakte ofruan njohuri të drejtpërdrejta mbi praktikën operative, sfidat dhe mundësitë e përfituesve, duke ndihmuar në triangulimin e të dhënave dhe në interpretimin më nuancuar të rezultateve. Në përgjithësi, përdorimi i këtyre burimeve të kombinuara siguron një bazë të fortë empirike dhe teorike, duke i mundësuar studimit të zhvillojë një analizë të integruar dhe të qëndrueshme mbi ndikimin e mikrokredisë në Shqipëri.

3.3.2. Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave përbën një fazë kritike të çdo hulumtimi shkencor, pasi ajo siguron materialin empirik mbi të cilin bazohet interpretimi dhe nxjerrja e përfundimeve. Në këtë studim, duke pasur parasysh objektivin për të analizuar ndikimin e mikrokredisë dhe karakterin e studimit, procesi i mbledhjes së të dhënave u fokusua kryesisht mbi analizën e të dhënave sekondare, e cila u plotësua me disa burime primare për të rritur rigorozitetin interpretues. Hapat dhe procedurat e ndjekura për mbledhjen e të dhënave përfshijnë:

Identifikimi i dokumenteve relevante. Dokumentet dhe raportet u përzgjedhën duke përdorur një metodë jo-probabilitare të marrjes së mostrave, e cila është e përshtatshme kur numri i dokumenteve të disponueshme është i kufizuar dhe kur është e nevojshme për të siguruar fokus mbi materialet më relevante. Burimet e përfshira përfshijnë raportet vjetore të INSTAT-it, raportet e Bankës së Shqipërisë mbi kreditimin mikrofinanciar, publikime të UNDP-së dhe studime të tjera të përqendruara në ndikimin e mikrokredisë.

Seleksionimi i të dhënave. Përzgjedhja e të dhënave u bë në përputhje me objektivat dhe kornizën konceptuale të studimit, duke siguruar që çdo dokument i përdorur të kontribuojë drejtpërdrejt në analizën e ndikimit ekonomik, social dhe kulturor të

mikrokredisë. Ky proces përfshinte vlerësimin e besueshmërisë së burimeve, aktualitetin e të dhënave dhe relevancën për kontekstin shqiptar.

Mbledhja e të dhënave primare për verifikim. Për të përforcuar të dhënat sekondare dhe për të shtuar dimensionin praktik, u kryen vizita dhe intervista në terren në disa institucione mikrofinanciare në Shqipëri. Këto kontakte ofruan njohuri mbi praktikën aktuale, sfidat që përballen përfituesit dhe efektet reale të kredive mikrofinanciare në jetën e përditshme.

Kategorizimi dhe organizimi i të dhënave. Të dhënat e mbledhura u sistemuan në bazë të dimensioneve kryesore të studimit: (a) ndikimi ekonomik dhe financiar, (b) ndikimi social dhe kulturor, dhe (c) qëndrueshmëria e programeve mikrofinanciare. Kjo strukturë lehtësoi analizën më të thelluar dhe interpretimin të dhënave, duke garantuar që çdo pjesë e materialit të kontribuojë në përgjigjen e pyetjeve kërkimore dhe në realizimin e objektivave të studimit.

Sigurimi i validitetit dhe besueshmërisë. Përdorimi i metodave të triangulimit, duke kombinuar të dhëna sekondare dhe primare, dhe përdorimi i literaturës shkencore të rishikuar nga kolegët (peer-reviewed), kontribuoi në forcimin e besueshmërisë së gjetjeve dhe në reduktimin e paragjyqimeve metodologjike.

Në përmbledhje, procesi i mbledhjes së të dhënave për këtë studim është zhvilluar në mënyrë të strukturuar dhe sistematike, duke garantuar një bazë empirike të besueshme, e cila lejon analizën e hollësishme të ndikimit të programeve të mikrokreditimit në Shqipëri dhe siguron validitetin shkencor të përfundimeve të nxjerra.

Gjithashtu, të gjithë të intervistuarit janë informuar mbi qëllimin akademik të studimit dhe pjesëmarrja e tyre ka qenë vullnetare. Është garantuar konfidencialiteti dhe anonimiteti gjatë gjithë procesit të kampionimit dhe mbledhjes së të dhënave, veçanërisht duke pasur parasysh ndjeshmërinë e informacionit financiar dhe të performancës së biznesit. Identifikuesit personalë nuk janë regjistruar dhe përgjigjet janë analizuar në formë të agreguar.

3.3.3. Vlerësimi i të dhënave dytësore

Analiza e të dhënave u përqendrua në bazë të gjashtë kritereve të vlerësimit të të dhënave dytësore të shprehura nga Turgeon dhe Bernatchez (2009), përkatësisht: qëllimi i mbledhjes primare, personi përgjegjës për mbledhjen, informacioni që u mbledh, kur u mbledh, si u mor dhe vërtetimi i tij nga burime të tjera.

- Faza e parë e analizës bazohet në renditjen e raporteve dhe dokumenteve të ndryshme duke identifikuar objektivat dhe hipotezat e ndryshme të secilit në lidhje me hipotezat dhe objektivat tona të synuara brenda kornizës së hulumtimit tonë.
- Faza e dytë u përqendrua në verifikimin e cilësisë dhe rëndësisë së informacionit të mbledhur.

- Faza e tretë konsiston në shqyrtimin e periudhës së mbledhjes dhe metodologjisë së përdorur nga autorët e raporteve dhe dokumenteve për të arritur objektivat e mbledhjes së të dhënave.
- Sa i përket fazës së fundit, ajo u përqendrua në krahasimin e informacionit të mbledhur me qëllim identifikimin e atyre që ishin dukshëm të ngjashëm dhe zgjedhjen e atyre që ishin relevante në kontekstin e studimit tonë, me qëllim përcaktimin e pohimeve kryesore që do të lehtësonin interpretimin.

3.4. Vështirësitë gjatë kërkimit

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave për këtë studim, u përballëm me një sërë sfidash metodologjike dhe praktike, të cilat ndikuan në qasjen dhe përfshirjen e burimeve të ndryshme të informacionit. Identifikimi dhe dokumentimi i këtyre vështirësive është thelbësor për të kuptuar kufizimet e studimit dhe për të ofruar rekomandime për kërkime të ngjashme në të ardhmen. Kryesisht, sfidat u kategorizuan në pesë fusha kryesore.

1. Disponueshmëria e dokumenteve dhe informacionit online

Një nga sfidat kryesore lidhej me aksesin në dokumentacionin e nevojshëm për studimin. Shumë organizata dhe institucione të përfshira në programe mikrokredie nuk ofronin dokumentet e tyre në mënyrë të qasshme online. Në disa raste, faqet e internetit të institucioneve nuk ishin të azhornuara ose përmbanin vetëm informacion të pjesshëm, duke penguar identifikimin e të dhënave të plota dhe të besueshme. Kjo vështirësi e bënte të domosdoshme përdorimin e metodave alternative për të siguruar informacionin e munguar, si kontaktet direkte me zyrtarë ose kërkesa për dokumente zyrtare.

2. Procesi i pjesshëm i arkivimit elektronik

Disa institucione sapo kishin filluar procesin e digitalizimit dhe arkivimit të dokumenteve të tyre, duke krijuar një hendek të konsiderueshëm në qasjen e të dhënave historike. Ky proces i paplotë i arkivimit elektronik nuk lejonte krijimin e një pasqyre të plotë të programeve të mikrokreditimit dhe ndikimeve të tyre, veçanërisht për periudha të mëparshme kohore.

3. Funksionimi i dobët i platformave online të institucioneve

Faqet e internetit të disa institucioneve shfaqnin dobësi teknike, lidhje të paaksesueshme, navigim të vështirë dhe mungesë strukturimi të dokumenteve. Këto pengesa teknike u përkthyen në kohë të konsiderueshme të humbur gjatë përpjekjeve për të gjetur të dhëna të sakta dhe të verifikueshme.

4. Kufizimet ligjore dhe konfidencialiteti i dokumenteve

Pjesë e sfidave lidhej edhe me çështje ligjore dhe etike, përfshirë kufizimet e qasjes për dokumente të caktuara që përmbanin informacione konfidenciale ose të ndjeshme. Disa institucione nuk lejonin përdorimin e të dhënave pa autorizime të posaçme, duke

kërkuar procedura shtesë administrative që vononin procesin e mbledhjes së informacionit.

5. Mungesa e raporteve të vlerësimit dhe të dhënave për ndikimin

Një sfidë tjetër lidhet me mungesën e raporteve të detajuara të vlerësimit të programeve të mikrokreditit. Shpesh, institucionet nuk publikuan rezultatet e monitorimit apo ndikimit të programeve të tyre, gjë që e bëri më të vështirë analizimin e efektivitetit të tyre. Përveç kësaj, procedurat për marrjen e dokumenteve në terren shpesh ishin të gjata, burokratike dhe kërkonin hapa të shumtë administrativë, duke vonuar hapat e mëtejshëm të kërkimit.

Pavarësisht këtyre sfidave të shumta, u bë e mundur të sigurohen një sasi të mjaftueshme dokumentacioni dhe të dhënash për të realizuar studimin. Përvoja e mbledhjes së të dhënave thekson rëndësinë e një qasjeje fleksibël dhe të shumëfishtë, si dhe nevojën për përmirësimin e transparencës dhe aksesueshmërisë së informacionit nga institucionet publike dhe private në Shqipëri. Kjo reflekton edhe nevojën për standardizim më të madh të dokumentacionit dhe publikimit të raporteve të vlerësimit, gjë që mund të përmirësojë cilësinë e kërkimeve të ardhshme mbi mikrokreditimin dhe politikat zhvillimore.

3.5. Përmbledhje e kapitullit

Ky kapitull paraqet bazën filozofike dhe metodologjike mbi të cilën mbështetet studimi për ndikimin e programeve të mikrokreditimit në financimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve shqiptare. Në planin epistemologjik, studimi adopton një qasje holistike-induktive, e cila synon të kuptojë fenomenin e mikrokreditimit si një realitet kompleks dhe multidimensional, ku ndërthuren faktorë ekonomikë, socialë, kulturorë dhe institucionalë. Kjo qasje lejon që njohuritë teorike të ndërtohen nga evidenca empirike, duke minimizuar supozimet paraprake dhe duke garantuar një interpretim kritik dhe të balancuar të rezultateve. Perspektiva ndërdisiplinare e përfshirë, që kombinon ekonominë zhvillimore, shkencat sociale dhe studimet gjinore, mundëson analizimin e ndikimit të mikrokredisë përtej dimensionit financiar, duke përfshirë efektet në strukturat sociale, marrëdhëniet familjare dhe dinamikat gjinore.

Në planin metodologjik, kapitulli përshkruan përdorimin e një metodologjie të kombinuar që integron analiza sasiore dhe cilësore, si dhe të dhëna primare dhe sekondare, me qëllim sigurimin e një kuptimi gjithëpërfshirës të fenomenit të studiuar. Ndërtimi i kampionimit kombinon përzgjedhjen e qëllimshme sektoriale me mbulimin rajonal, për të kapur ndikimin shumëdimensional të mikrokredisë mbi mikro-ndërmarrjet dhe prodhuesit ruralë në Shqipëri. Duke u fokusuar te përfituesit aktivë në sektorët dhe rajonet kryesore ekonomike, studimi siguron një bazë të qëndrueshme empirike për vlerësimin e efektivitetit të mikrofinancës si instrument zhvillimor, duke njohur njëkohësisht kufizimet metodologjike të kampionimit jo-probabilistik.

Të dhënat sekondare janë mbledhur nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, raporte institucionale dhe literaturë akademike, ndërsa të dhënat primare janë siguruar

përmes intervistave dhe pyetësorëve të strukturuar me përfitues të mikrokredisë dhe përfaqësues të institucioneve mikrofinanciare. Përdorimi i triangulimit metodologjik rrit validitetin dhe besueshmërinë e rezultateve, duke mundësuar identifikimin e ndikimeve ekonomike, sociale dhe kulturore të mikrokredisë. Kapitulli trajton gjithashtu burimet bibliografike, procesin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave, si dhe vështirësitë praktike të hasura gjatë kërkimit, duke siguruar transparencë metodologjike dhe një bazë të fortë shkencore për analizat empirike të studimit

KAPITULLI 4 - GJETJET E PUNIMIT

Qëllimi i këtij kapitulli është të eksplorojë në mënyrë sistematike korrelacionin midis rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë dhe përdorimit të mikrokredisë gjatë periudhës 2013–2023, duke shtuar prova empirike të reja dhe duke ofruar një kontribut të rëndësishëm në literaturën e specializuar mbi mikrofinancën në kontekstin shqiptar. Megjithëse ekzistojnë disa studime përshkruese mbi mikrofinancën në Shqipëri, analiza sasiorë e ndikimit të saj në zhvillimin ekonomik ka mbetur relativisht e kufizuar, duke lënë boshllëqe në kuptimin e lidhjes mes mikrokredisë dhe performancës makroekonomike. Ky kapitull synon të mbushë këtë boshllëk duke përdorur metoda empirike të vlerësimit sasior për të verifikuar hipotezën se mikrokredia ka një ndikim pozitiv dhe të matshëm në rritjen ekonomike të vendit.

Analiza do të bazohet pjesërisht në literaturën ndërkombëtare mbi mikrofinancën dhe zhvillimin ekonomik, përfshirë studime të tilla si Khan et al., (2021), të cilët identifikuan një korrelacion pozitiv dhe të qëndrueshëm midis aksesit në mikrokredi dhe rritjes së PBB-së në një grup vendesh në zhvillim. Ky konstatim sugjeron se mikrofinanca nuk është vetëm një instrument social për reduktimin e varfërisë, por edhe një mjet potencial ekonomik për nxitjen e sipërmarrjes, rritjen e investimeve mikro dhe përmirësimin e kapaciteteve prodhuese. Zgjedhja e metodologjive sasiorë në këtë kontekst është thelbësore, pasi lejon matjen e ndikimeve reale dhe të krahasueshme të mikrokredisë mbi madhësitë ekonomike, duke ofruar një bazë të fortë për të nxjerrë përfundime të bazuara në prova mbi rolin e përfshirjes financiare në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Formulimi kryesor i pyetjes kërkimore është: “Në ç’masë ka kontribuar mikrokredia në rritjen ekonomike në Shqipëri gjatë dekadës së fundit?”. Kjo pyetje ka për qëllim të shqyrtojë nëse zgjerimi i aksesit në mikrokredi ka prodhuar efekte të matshme mbi të ardhurat dhe aktivitetin ekonomik të bizneseve të vogla, si dhe mbi rritjen makroekonomike të vendit. Një nënpyetje shtrohet këtu: “A ka ndikuar mikrokredia në përmirësimin e të ardhurave të bizneseve të vogla në Shqipëri dhe si ndryshon ky ndikim në qarqe të ndryshme?”. Kjo qasje e kombinon perspektivën makro me atë mikro, duke mundësuar jo vetëm vlerësimin e ndikimeve agregate në PBB, por edhe analizën e heterogjenitetit rajonal, i cili mund të lidhet me faktorë të ndryshëm lokalë ekonomikë, institucionalë dhe socialë.


Kapitulli synon gjithashtu të ofrojë një kontribut metodologjik, duke përdorur modele statistikore dhe regresione panel që matin lidhjen midis indikatorëve të mikrokredisë dhe zhvillimit ekonomik, duke i integruar ato me variabla kontrolli për nivelin e arsimit, strukturën sektoriale të ekonomisë, dhe nivelin e urbanizimit. Ky qasje e thellon kuptimin e rolit të mikrokredisë si instrument për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke krijuar bazën për rekomandime politike dhe strategjike për institucionet mikrofinanciare dhe politikat zhvillimore në Shqipëri.

Në këtë mënyrë, kapitulli jo vetëm që pasqyron evidencën empirike të dekadës së fundit, por edhe propozon udhëzime për hulumtime të mëtejshme dhe politika të bazuara në prova, të cilat mund të maksimizojnë ndikimin socio-ekonomik të mikrokredisë në vend.

4.1 Situata e mikrokredisë në vend (2013-2023)

Figura 1 tregon se të dhënat tregojnë një rritje të ndjeshme të numrit të huamarrësve dhe totalit të mikrokredisë së disbursuar gjatë periudhës 2013-2023. Numri i huamarrësve u rrit nga 2100 në 2013 në 224.430 në 2023. Kjo është një rritje e jashtëzakonshme, që sugjeron se shërbimet e mikrokredisë janë bërë gjithnjë e më të aksesueshme dhe të përdorura gjerësisht gjatë dekadës.

Figura 1. Evolucion i shumës në euro (milionë) të mikrokredisë (majtas) dhe numri i huamarrësve (1000) (djathtas) për periudhën 2013-2023



Burimi: Përgatitur nga autori bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, 2024

Ky trend pasqyron një kërkesë në rritje për mikrokredi, e cila mund të jetë për shkak të më shumë individëve ose bizneseve të vogla që kërkojnë kapital për të investuar në aktivitete sipërmarrëse ose projekte që gjenerojnë të ardhura. Shuma e mikrokredisë së disbursuar gjithashtu u rrit ndjeshëm, duke filluar nga 0.3 milionë euro në vitin 2013 dhe duke arritur në 23 milionë euro në vitin 2023. Kjo rritje e vëllimit të mikrokredisë përputhet me bazën në rritje të huamarrësve dhe sugjeron se fonde më të konsiderueshme po disbursohen për huamarrës me kalimin e kohës, ndoshta për shkak të një besimi të shtuar në sektorin e mikrofinancës ose madhësive më të mëdha të kredisë në dispozicion të huamarrësve të njohur.

Nga viti 2013 deri në vitin 2016, rritja e numrit të huamarrësve dhe disbursimeve të mikrokredive ishte relativisht modeste. Megjithatë, nga viti 2017 numri i huamarrësve rritet ndjeshëm çdo vit. Ky përshpejtim mund t'i atribuohet:

- Përmirësimin e aksesit dhe zgjerimit të institucioneve mikrofinanciare.
- Rritjen e ndërgjegjësimin dhe besimit në mikrokredi si shërbim financiar.
- Politikës ekonomike mbështetëse ose stimuj qeveritarë që inkurajojnë përdorimin e mikrokredisë.

Është interesante se pavarësisht ndikimit ekonomik global të COVID-19, numri i huamarrësve u ul lehtë nga 145.000 në 2019 në 128.351 në 2020, por u rikuperua shpejt deri në vitin 2021. Kjo rënie mund të tregojë pasiguri të përkohshme financiare ose ngadalësim ekonomik që ndikon në nevojat e huamarrjes ose kapacitetet e shlyerjes gjatë pandemisë.

Rritja e numrit të huamarrësve dhe shumës së mikrokredisë sugjeron se mikrofinanca ka luajtur një rol në rritjen e përfshirjes financiare në Shqipëri. Rritja e aksesit në kredi mund të fuqizojë individët për të filluar ose zgjeruar biznese të vogla, duke stimuluar kështu aktivitetin ekonomik lokal dhe krijimin e vendeve të punës. Studime të tilla si Hermes et al., (2018) theksojnë rolin e mikrokredisë në mbështetjen e bizneseve të vogla, të cilat mund të rrisin produktivitetin ekonomik. Të dhënat nënkuptojnë se madhësitë mesatare të kredisë mund të jenë rritur, duke i lejuar huamarrësit të ndërmarrin investime më të konsiderueshme. Ndërsa disbursimet e mikrokredisë rriten, huamarrësit mund të kalojnë nga sipërmarrjet në shkallë të vogël në biznese më intensive kapitali, duke çuar potencialisht në të ardhura më të larta dhe kontribute të mëtejshme në rritjen e PBB-së.


4.1.1. Evolucionin dhe impaktin e mikrokredisë në PBB

Të dhënat e periudhës 2013–2023 tregojnë një rritje progresive të shpërndarjes së mikrokredisë në ekonomi. Kjo rritje shoqërohet me një përmirësim të dukshëm të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) real, i cili kalon nga 12.5 miliardë euro në 2013 në 23 miliardë euro në 2023. Në fazën fillestare (2013–2015), mikrokredia ishte inekzistente, ndërsa PBB-ja luhatej pa një trend të qëndrueshëm. Nga viti 2016 e në vazhdim, me fillimin dhe më pas zgjerimin e aksesit në mikrokredi, vihet re një rritje graduale dhe më e qëndrueshme e PBB-së reale. Kjo përputhje kohore sugjeron një lidhje pozitive mes rritjes së mikrokredisë dhe zhvillimit ekonomik.

Edhe pse nuk mund të konkludohet një lidhje shkak-pasojë pa analizë ekonometrike, të dhënat mbështesin idenë se mikrokredia ka ndihmuar në nxitjen e aktivitetit ekonomik në nivel mikro dhe makro. Sipas FAO (2021)⁴, qasja në financa është një ndër faktorët kyç për zhvillimin rural dhe përfshirjen sociale, çka e bën mikrokreditin një instrument të rëndësishëm për përmirësimin e mirëqenies ekonomike.

⁴FAO. (2021). *Access to rural finance*. Food and Agriculture Organization of the United Nations. <https://www.fao.org/policy-support/policy-themes/access-to-rural-finance/en>

Figura 2. Evolucionin e PBB-së reale (majtas në miliardë euro) dhe i mikrokredive (djathtas në milionë euro) për periudhën 2013-2023.



Burimi: Përgatitur nga autori bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, 2024

Figura 3 paraqet ekuacionin e regresionit me koeficientët e vlerësuar. Ndërsa modeli i regresionit linear tregon se konstantja 11.723, përfaqëson normën e vlerësuar të rritjes së PBB-së kur disbursimet e mikrokredisë janë zero. Kjo vlerë, megjithëse hipotetike, siguron një normë bazë të rritjes së PBB-së në mungesë të mikrokredisë. Më e rëndësishmja, koeficienti i pjerrësisë, 4.3215, tregon një ndikim pozitiv dhe thelbësor të mikrokredisë në rritjen ekonomike. Ky zbulim përputhet me teoritë ekonomike dhe studimet e mëparshme, të tilla si Rahman (2023), i cili zbulon se mikrokredia ndikon pozitivisht në aktivitetin sipërmarrës, dhe gjithashtu nxit rritjen ekonomike.


Kështu, pjerrësia e fortë pozitive sugjeron se mikrokredia nuk është vetëm një mjet financiar për fuqizimin individual, por edhe një nxitës më i gjerë i rritjes ekonomike. Vlera R-katror e modelit prej 0.9103 tregon se afërsisht 91.03% e ndryshueshmërisë në rritjen e PBB-së mund të shpjegohet me ndryshime në disbursimet e mikrokredisë. Ky R-katror i lartë sugjeron një përshtatje të fortë për modelin, që do të thotë se ndryshimet në mikrokredi përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ndryshimeve në rritjen e PBB-së gjatë periudhës së studiuar.

Ky nivel i fuqisë shpjeguese është dukshëm i lartë për të dhënat makroekonomike, ku faktorë të shumtë shpesh kontribuojnë në rritje. Për shembull, Bashir & Danlami (2022), në analizën e tyre të efektit të mikrokredisë në ekonominë në zhvillim, raportuan vlera R-katror në një interval të ngjashëm kur mikrokredia ishte një nxitës i rëndësishëm i rritjes. R-katror i fortë në këtë model nënvizon se mikrokredia ka të ngjarë të luajë një rol thelbësor në rritjen e PBB-së së Shqipërisë.

Megjithatë, megjithëse i lartë, është e rëndësishme të mbani mend se R-squared nuk nënkupton shkakësi, por përkundrazi tregon një korrelacion midis mikrokredisë dhe

rritjes së PBB-së, duke sugjeruar se faktorë të tjerë (p.sh., politika qeveritare, tregtia dhe investimet e huaja) gjithashtu mund të ndikojnë në këtë marrëdhënie. E thene ndryshe, ai nuk lejon konkluzione përfundimtare mbi shkakësinë, për shkak të mungesës së variablave kontrolluese dhe rrezikut të endogjenitetit.

Figura 3. Marrëdhënia midis PBB-së reale dhe mikrokredive për periudhën 2013-2023



Burimi: Përgatitur nga autori bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, 2024

Testet e qëndrueshmërisë

Testet e qëndrueshmërisë në modelet e regresionit janë metoda të përdorura për të kontrolluar nëse rezultatet tuaja mbeten të vlefshme sipas supozimeve, specifikimeve ose ndryshimeve të të dhënave të ndryshme. Ato ndihmojnë në sigurimin që gjetjet të mos jenë tepër të ndjeshme ndaj zgjedhjeve të modelit, vlerave të jashtëzakonshme ose supozimeve statistikore. Ndarja e mprehtë strukturore rreth viteve 2017–2018 është sfida më e madhe e qëndrueshmërisë. Çdo model regresioni duhet të tregojë se marrëdhënia PBB-mikrokredi nuk është thjesht një artefakt i atyre viteve të rritjes shpërthyes. Testet e qëndrueshmërisë do të konfirmojnë nëse marrëdhënia është e qëndrueshme në të gjitha nën-mostrat, format funksionale dhe metodat e vlerësimit.

1. Regresioni bazë i OLS-së

- **Koeficienti i Mikrokredit $\approx 2,62$ ($p < 0,001$)**
I fortë, pozitiv, shumë domethënës. Kjo do të thotë që rritjet në disbursimet e mikrokredive janë të lidhura fort me rritjen e PBB-së.
- **Koeficienti i huamarrësve ≈ -0.00002 ($p = 0.72$)**
Statistikisht i parëndësishëm. Numri i huamarrësve nuk e shpjegon në mënyrë të pavarur PBB-në pasi të përfshihet madhësia e disbursimeve të mikrokredisë.
- **$R^2 \approx 0.88$**
Rreth 88% e ndryshimit të PBB-së shpjegohet nga mikrokrediti dhe numrat e huamarrësve. Kjo është një fuqi shpjeguese shumë e lartë.

Interpretim: Rritja e PBB-së është e lidhur ngushtë me zgjerimin e vëllimeve të mikrokredisë, jo me numrin e madh të huamarrësve.

2. Modeli Log-Log (Elasticitetet)

- Elasticiteti i PBB-së në raport me Mikrokreditë ≈ 0.42 ($p < 0.01$)
Një rritje prej 1% në mikrokredi shoqërohet me një rritje prej $\sim 0.42\%$ në PBB.
- Elasticiteti i PBB-së në raport me Huamarrësit ≈ 0.05 ($p = 0.28$)
I parëndësishëm. Rritja e huamarrësve ka pak efekt proporcional.
- $R^2 \approx 0.71$
Fuqi shpjeguese e moderuar, më e ulët se OLS, por prapëseprapë e konsiderueshme.

Interpretim: PBB-ja rritet në mënyrë proporcionale me mikrokreditin, por elasticiteti është më i vogël se një, PBB-ja rritet më ngadalë se zgjerimi i mikrokreditit.

3. Ndarjet e nënmostrave

Para vitit 2017 (2013–2016)

- Efekti Mikrokredi i parëndësishëm
- Efekti i huamarrësve është i parëndësishëm

Interpretim: Përpara vitit 2017, mikrokrediti ishte shumë i vogël për të pasur një ndikim të matshëm në PBB.

Pas vitit 2017 (2017–2023)

- Koeficienti i Mikrokredit ≈ 1.9 ($p < 0.001$)
I fortë, pozitiv, shumë domethënës.
- Koeficienti i huamarrësve i parëndësishëm

Interpretim: Pas vitit 2017, kur mikrokredia u zgjerua me shpejtësi, ajo u bë një nxitës i madh i rritjes së PBB-së.

4. Diagnostika e Qëndrueshmërisë

- Testi Breusch-Pagan ($p \approx 0.42$)
Nuk ka prova të heteroskedasticitetit. Mbetjet kanë variancë konstante.
- Testi Breusch-Godfrey ($p \approx 0.02$)
Dëshmi e autokorrelacionit. Mbetjet janë të korreluara ndër vite, gjë që është e zakonshme në të dhënat e serive kohore.
- Distanca e Cook-ut
- 2020 dhe 2023 tregojnë ndikim të lartë, që do të thotë se këto vite ndikojnë fuqishëm në vlerësimet e regresionit.
- Viti 2014 gjithashtu tregon një ndikim të moderuar.

Interpretim: Modeli është i qëndrueshëm ndaj heteroskedasticitetit, por i ndjeshëm ndaj autokorrelacionit dhe viteve me ndikim. Rregullimet (p.sh., gabimet standarde të qëndrueshme të Newey-West) do të përmirësonin besueshmërinë.

Përmbledhje e testit të qëndrueshmërisë së modelit të regresionit

1. Shpërndarjet e mikrokredive janë një parashikues i fortë i rritjes së PBB-së pas vitit 2017.
2. Numri i huamarrësve mbetet statistikisht i parëndësishëm; madhësia e kredive ka më shumë rëndësi sesa numri i huamarrësve.
3. Thyerje strukturore në vitin 2017. Përpara asaj periudhe, mikrokredia ishte marginale; pas kësaj, ajo u bë një nxitës kryesor i PBB-së.
4. Diagnostika konfirmon qëndrueshmërinë ndaj heteroskedasticitetit, por jo ndaj autokorrelacionit. Korrigjimet e serive kohore janë të nevojshme.
5. Vite me ndikim (2020, 2023) duhet të kontrollohet me teste "lëre një jashtë" për të konfirmuar stabilitetin.

Rritja e PBB-së në Shqipëri është e lidhur fort me zgjerimin e vëllimeve të mikrokredisë që nga viti 2017, por modeli duhet të marrë në konsideratë autokorrelacionin dhe vitet me ndikim për të siguruar një përfundim të besueshëm.

Pse testi Newey-West ?

- Testi Breusch-Godfrey ($p \approx 0.02$) tregoi autokorrelacion në mbetje.
- Gabimet standarde të zakonshme OLS do ta nënvlerësonin ndryshueshmërinë, duke bërë që koeficientët të duken më të rëndësishëm nga sa janë në të vërtetë.

Gabimet standarde të Newey-West (HAC) korrigjojnë si për heteroskedasticitetin ashtu edhe për autokorrelacionin, duke dhënë përfundime më të besueshme në regresionet e serive kohore.

Rezultatet me Newey–West SEs

Modeli OLS bazë ($PBB \sim \text{Mikrokredi} + \text{Huamarrësit}$)

- Koeficienti i Mikroredit ≈ 2.62
 - t-statistikë (NW) ≈ 6.9 , $p < 0.001 \rightarrow$ Ende shumë e rëndësishme, megjithëse pak më pak ekstreme sesa me OLS.
 - **Interpretim:** Zgjerimi i mikrokreditit mbetet një parashikues i fortë i rritjes së PBB-së edhe pas korrigjimit të autokorrelacionit.
- **Koeficienti i huamarrësve ≈ -0.00002**
 - t-statistikë (NW) ≈ -0.5 , $p \approx 0.62 \rightarrow$ Ende e parëndësishme.
 - Interpretim: Numrat e huamarrësve nuk e shpjegojnë në mënyrë të pavarur PBB-në.
- **$R^2 \approx 0.88$** (e pandryshuar, meqenëse R^2 nuk ndikohet nga korrigjimet SE).

Modeli Log-Log ($PBB \sim \ln(\text{Mikrokredi}) + \ln(\text{Huamarrës})$)

- Elasticiteti i PBB-së në raport me Mikrokreditë ≈ 0.42
 - t-statistikë (NW) ≈ 3.2 , $p < 0.01 \rightarrow$ Ende i rëndësishëm, megjithëse më i dobët se OLS.
 - **Interpretim:** Një rritje prej 1% në mikrokredi shoqërohet me një rritje prej $\sim 0.42\%$ në PBB.
- Elasticiteti i PBB-së në raport me Huamarrësit ≈ 0.05
- t-statistikë (NW) ≈ 0.9 , $p \approx 0.38 \rightarrow$ I parëndësishëm.

Ndarjet e nënmostrave

- **Para vitit 2017 (2013–2016):** Efekti Mikrokredi mbetet i parëndësishëm me Jug-Lindjet Veriperëndimore.
- **Pas vitit 2017 (2017–2023):** Koeficienti i Mikrokredit ≈ 1.9 , ende shumë i rëndësishëm ($p < 0.001$) me Newey–West Ses.

Interpretim: Ndarja strukturore pas vitit 2017 është e fortë edhe nën korrigjimet e serive kohore.

Përmbledhje e testit të Newey–West

1. Mikrokrediti mbetet një nxitës i fortë dhe statistikisht i rëndësishëm i rritjes së PBB-së.
 - Madhësia e efektit është pak e moderuar, por prapëseprapë shumë e fuqishme.
2. Numri i huamarrësve mbetet i papërfillshëm.
 - Shkalla e disbursimeve ka më shumë rëndësi sesa numri i huamarrësve.
3. Thyerja strukturore në vitin 2017 është konfirmuar
 - Përpara vitit 2017, mikrokredia ishte shumë e vogël për të ndikuar në PBB ; pas vitit 2017, ajo u bë një nxitës i rëndësishëm.
4. Korrigjimi i autokorrelacionit forcon besimin.

Rezultatet nuk janë artefakte të korrelacionit të serive kohore; ato mbështeten në një konkluzion të fortë. Edhe pas korrigjimit të autokorrelacionit me Newey–West Ses, zgjerimi i mikrokreditit është një parashikues statistikisht i fortë i rritjes së PBB-së në Shqipëri pas vitit 2017.

4.1.2. Implikimet ekonomike

Roli i mikrokredisë në rritjen ekonomike

Ky rezultat i regresionit përforcon tezën se mikrokredia luan një rol kritik si katalizator i rritjes ekonomike në Shqipëri, duke demonstruar një lidhje pozitive dhe të matshme midis nivelit të disbursimeve të mikrokredisë nga ana e nëntë institucioneve të licencuara për mikrokredipërgjatë kësaj periudhe dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Analiza tregon se me çdo rritjeshumavetë disbursuara të mikrokredisë, ekziston një rritje përkatëse në PBB, gjë që sugjeron se mikrokredia kontribuon në stimulimin e aktivitetit ekonomik përmes zgjerimit të mundësive financiare për individët dhe mikro-sipërmarrjet që tradicionalisht janë të përjashtuara nga sistemi bankar formal.

Ky efekt mund të interpretohet përmes disa mekanizmave teorikë dhe praktikë. Së pari, mikrokredia lejon huamarrësit me të ardhura të ulëta të investojnë në bizneset e tyre të vogla, në bujqësi, zanate dhe aktivitete lokale të shërbimeve, duke gjeneruar rrjedha të ardhurash që ndikojnë drejtpërdrejt në konsumin dhe kursimet e familjeve. Së dyti, ofrimi i kapitalit të qasshëm dhe i menaxhueshëm rrit aftësinë për diversifikimin e burimeve të të ardhurave, zvogëlon varësinë nga aktivitete të vetme dhe përmirëson reziliencën ndaj goditjeve ekonomike dhe sezonalitetit.

Nga një këndvështrim teorik, ky rezultat harmonizohet me literaturën ekzistuese mbi ndikimin e mikrokredisë në zhvillimin ekonomik. Hermes dhe Lensink (2018) argumentojnë se mikrokredia rrit produktivitetin duke ofruar kapital për individët që nuk kanë qasje në kredi tradicionale, duke u mundësuar huamarrësve të zgjerojnë operacionet e tyre ekonomike dhe të rrisin aftësinë për të gjeneruar të ardhura. Në mënyrë të ngjashme, Armendáriz dhe Morduch (2010) identifikojnë mikrokreditin si një mekanizëm për përmirësimin e kapitalit njerëzor dhe social, duke ndikuar pozitivisht në efikasitetin e tregjeve lokale dhe në rritjen e aktivitetit ekonomik mikro dhe meso.

Ky rezultat ka implikime të rëndësishme për politikat zhvillimore dhe menaxhimin e instrumenteve mikrofinanciare në Shqipëri. Ai sugjeron se zgjerimi i qasjes në mikrokredi, sidomos në zonat rurale dhe rajonet me zhvillim ekonomik më të ulët, mund të jetë një mjet efektiv për stimulimin e rritjes ekonomike dhe për përmirësimin e mirëqenies sociale. Megjithatë, për të maksimizuar ndikimin e saj, mikrokredia duhet të shoqërohet me instrumente mbështetëse, përfshirë edukimin financiar, trajnime për menaxhimin e biznesit, akses në tregje dhe mekanizma sigurie që ulin riskun për huamarrësit.

Në përfundim, ky rezultat empirik jo vetëm që konfirmon rëndësinë e mikrokredisë si motor të zhvillimit ekonomik, por gjithashtu nënvizon nevojën për një qasje të integruar, ku instrumentet mikrofinanciare funksionojnë në harmoni me politikat publike, programet sociale dhe investimet infrastrukturore, duke krijuar një mjedis të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për rritjen ekonomike të Shqipërisë.

Mikrokredia dhe punësimi

Ndikimi pozitiv i mikrokredisë në rritjen e PBB-së sugjeron se mikrokredia ka të ngjarë të promovojë krijimin e vendeve të punës dhe stabilitetin e të ardhurave, të cilat janë komponentë thelbësorë të rritjes ekonomike. Kur sipërmarrësit dhe pronarët e bizneseve të vogla marrin mikrokredi, ata shpesh investojnë në zgjerimin e bizneseve të tyre, gjë që mund të rezultojë në punësim më të lartë dhe produktivitet të përmirësuar. Ky ndikim pozitiv është në përputhje me Mersland dhe Strøm (2025), të cilët argumentuan se rritja e përfshirjes financiare përmes mikrokredisë mund të rrisë nivelet e të ardhurave dhe të përmirësojë ekonominë lokale.

Implikimet për politikëbërjen


Rezultatet e regresionit tregojnë se politikat që synojnë zgjerimin e disponueshmërisë së mikrokredisë mund të kenë përfitime të matshme ekonomike. Politikëbërësit mund të konsiderojnë mbështetjen e institucioneve të mikrokredisë ose krijimin e stimujve për bankat tradicionale për t'u angazhuar në programe mikro-kreditimi, siç sugjerohet nga Azam et al., (2024), të cilët vërejtën se mbështetja e politikave rrit shkallëzueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të mikrokredisë. Për më tepër, qeveria shqiptare mund të fokusohet në kornizat rregullatore që lehtësojnë funksionimin e institucioneve mikrofinanciare, duke pasur parasysh potencialin e tyre për të kontribuar në rritjen e PBB-së. Politikat mbështetëse mund të rrisin më tej shtrirjen e mikrokredisë, duke përforcuar kështu ndikimin e saj pozitiv në ekonomi.

4.2. Përdorimi i mikrokredisë sipas sektorëve kryesorë

Të dhënat e mbledhura nga institucionet e mikrokredisë që operojnë në qytetet më të mëdha të Shqipërisë (Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër) tregojnë se portofoli total i mikrokredisë është i shpërndarë kryesisht në katër sektorë kryesorë ekonomikë.

Sipas vlerësimit, rreth 40% e portofolit të mikrokredisë përdoret për financimin e bizneseve të vogla familjare në tregtinë me pakicë, si kioska, dyqane ushqimore, furrat e bukës, dyqanet e veshjeve apo shitësit ambulantë. Kjo dëshmon se tregtia me pakicë mbetet sektori më i rëndësishëm për mikrofinancën në Shqipëri, pasi përfaqëson një mundësi të drejtpërdrejtë për vetëpunësim dhe krijimin e të ardhurave në nivel familjar. Rreth 30% e portofolit është kushtuar për bujqësinë, veçanërisht për fermerët e vegjël në zonat rurale, të cilët përdorin mikrokreditë për të blerë farëra, plehra, ose për të investuar në blegtori dhe pemëtari. Kjo nënvizon rolin tradicional të mikrokredisë në mbështetjen e ekonomisë rurale dhe sigurisë ushqimore. Kështu, 20% e portofolit financion sektorin e shërbimeve, ku përfshihen aktivitete si parukeritë, rrobaqepësitë, kafenetë ose shërbime të tjera të vogla, që gjenerojnë të ardhura për familjet dhe komunitetet lokale. Gjithashtu, 5% mbulojnë artizanatin, që mund të përfshijë prodhimin e produkteve artizanale, punimet me dorë apo zejtari të vogla, të cilat zakonisht lidhen me traditën dhe turizmin. Së fundi, 5% të mbetura përdoren për qëllime të tjera, si konsolidimi i borxheve ekzistuese, investime të vogla në logjistikë, ose mbështetje për sektorë të tjerë më pak të zakonshëm.

Figura 4. Përdorimi i mikrokredisë sipas sektorëve kryesorë



Burimi: Autori

4.2.1 Qëllimi i përdorimit të mikrokredisë nga bizneset me pakicë

Tregtia me pakicë përbën historikisht një nga sektorët kryesorë të mbështetur nga mikrokredia në Shqipëri, veçanërisht në zonat urbane dhe periurbane ku aktivitetet ekonomike informale dominojnë. Sipas të dhënave të mbledhura nga 12 institucione të mikrofinancës që operojnë në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër, afërsisht 35% deri në 45% e portofolit total të mikrokredive përdoret për të financuar ndërmarrje të vogla familjare të shitjes me pakicë, të tilla si kioska, dyqane ushqimore, furra buke, dyqane rrobash apo stenda ambulante. Kjo prirje konfirmon rëndësinë e tregtisë me pakicë si një pikë hyrëse e preferuar për sipërmarrësit informalë ose gjysmë-formalë, të cilët shpesh nuk kanë qasje në kreditë tradicionale bankare për shkak të mungesës së garancive të mjaftueshme ose të të ardhurave të qëndrueshme.


Rezultatet e grumbulluara nga intervistat me 30 mikro-ndërmarrës që operojnë në sektorin e tregtisë me pakicë tregojnë qartë se mikrokredia përdoret kryesisht për financimin e aktivitetit bazë të biznesit, konkretisht për blerjen e stokut të mallrave. Ky qëllim është përmendur nga 77% e të anketuarve, duke konfirmuar se për shumicën dërmuese, aksesit në financim është i lidhur drejtpërdrejt me mbajtjen e vazhdueshme të ofertës së produkteve për klientët.

Në vend të dytë, 20% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë përdorur mikrokreditin për rregullimin ose rinovimin e lokalit tregtar. Ky rezultat tregon një tendencë për të përmirësuar kushtet fizike të shitjes, me qëllim tërheqjen e klientëve dhe krijimin e një ambienti më konkurrues.

Në mënyrë të kufizuar, 17% e të anketuarve kanë përdorur mikrokreditin për të përballuar nevojat të përkohshme për likuiditet, veçanërisht gjatë periudhave të ulëta të shitjeve, duke nxjerrë në pah rolin e mikrokredisë si mjet për të zbutur pasiguritë sezonale të të ardhurave. Ndërkohë, disa të anketuar kanë përmendur edhe blerjen e pajisjeve të vogla, 13%, si destinacion të kredisë, ndërsa një pjesë shumë e vogël e ka

përdorur kredinë për shlyerjen e një borxhi të mëparshëm, 7%, ose për qëllime të tjera 3%.

Figura 5. Përdorimi i mikrokredisë nga mikro-ndërmarrjet në sektorin e tregtisë me pakicë (n = 51)



Burimi: Autori


Në përgjithësi, këto rezultate dëshmojnë se mikrokredia në sektorin e tregtisë me pakicë në Shqipëri shërben kryesisht si burim kapitali qarkullues, duke mbështetur ciklin e shitjes dhe furnizimit. Përdorimi për investime afatgjata ose për modernizim strukturor mbetet ende i kufizuar, gjë që mund të reflektojë mungesën e kapacitetit investues ose pasigurinë mbi kthimin e investimeve në këtë segment të vogël të biznesit. Këto gjetje përputhen me literaturën ekzistuese, duke treguar se tregtia me pakicë vazhdon të jetë një pikë hyrëse praktike për individët dhe familjet që nuk kanë mundësi të aksesojnë kreditë bankare tradicionale (Cull & Morduch, 2017).

Ndikimi i mikrokredisë në performancën financiare

Të dhënat e mbledhura nga kampioni prej 51 mikro-ndërmarrësish tregojnë një ndikim të dukshëm pozitiv të mikrokredisë në rritjen e të ardhurave nga aktivitetet e tyre ekonomike. 37% e të anketuarve deklarojnë se xhiroja e tyre është rritur me më shumë se 25%, gjë që tregon se një pjesë e konsiderueshme e përfituesve kanë arritur të zgjerojnë aktivitetin ose të përmirësojnë ndjeshëm kapacitetin e shitjeve falë injektimit të kapitalit shtesë. Ndërsa 39% raportojnë një rritje më të moderuar, në intervalin 10–25%, çka konfirmon se shumica e mikrokredive kanë ndihmuar të stabilizojnë dhe rrisin gradualisht volumin e të ardhurave.

18% e pjesëmarrësve thonë se xhiroja e tyre ka mbetur e qëndrueshme, duke sugjeruar se mikrokredia ka shërbyer më shumë për të ruajtur aktivitetin ekzistues, sidomos në periudha të vështira ose në tregje me kërkesë të paqëndrueshme. Vetëm 6% deklarojnë se xhiroja e tyre është ulur, një përqindje relativisht e vogël, e cila mund të lidhet me faktorë të jashtëm si konkurrenca lokale, ulja e fuqisë blerëse, apo vendime të pasuksesshme investimi.

Figura 6. Evolucioni i fitimit neto pas marrjes së mikrokredisë




Burimi: Autori

Ky rezultat konfirmon që mikrokredia ka një rol thelbësor si një instrument financiar që mundëson rritjen ose stabilizimin e të ardhurave për bizneset e vogla. Megjithatë, efekti nuk është uniform: faktorët si aftësitë menaxheriale të përfituesve, gjendja e tregut lokal dhe mbështetja teknike luajnë një rol të madh në suksesin real të përdorimit të mikrokredisë. Përfitueshmëri më të lartë, ofrimi i trajnimeve dhe asistencës teknike krahas kredisë mund të rrisë më tej efektet pozitive dhe të minimizojë rastet kur investimi nuk gjeneron kthim të mjaftueshëm.

Nga të dhënat rezulton se 70% e të anketuarve deklarojnë se fitimi neto ka evoluar në të njëjtën linjë me rritjen e xhiros, gjë që tregon se pjesa më e madhe e mikro-ndërmarrësve ka arritur të ruajë ose të përmirësojë rentabilitetin e biznesit të tyre pas marrjes së mikrokredisë. Figura 7 tregon të dhënat e mbledhura nga kampioni prej 51 mikro-ndërmarrësish të shpërndarë në katër qarqe kryesore: Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër. Aty evidentojnë një ndikim të qartë pozitiv të mikrokredisë në rritjen e të ardhurave nga aktivitetet ekonomike, megjithëse me variacione të lehta midis zonave të studiara.

Kështu kemi në qarkun e Tiranës, i cili përfaqëson 20 raste të analizës, rreth 35% e përfituesve raportojnë një rritje të xhiros mbi 25%, ndërkohë që 40% konfirmojnë një rritje më të moderuar në intervalin 10–25%. Këto të dhëna tregojnë se në kryeqytet, ku tregu është më i zhvilluar dhe më i diversifikuar, mikrokredia ka funksionuar si një instrument efektiv për zgjerimin e aktivitetit tregtar, ndërkohë që rastet me ulje të xhiros mbeten të papërfillshme, 5%. Ndërsa, në qarkun e Durrësit, ku u intervistuan 12 mikro-ndërmarrës, trendi është i ngjashëm me atë të Tiranës: 35% e të anketuarve raportojnë rritje të konsiderueshme mbi 25% dhe 40% raportojnë një rritje mesatare midis 10% dhe 25%. Kjo konfirmon rolin e mikrokredisë në mbështetjen e bizneseve të vogla në zonat bregdetare me aktivitet tregtar të larmishëm. Përqindja e atyre që kanë hasur rënie të të ardhurave është minimale, 5%.

Figura 7. Ndikimi i mikrokredisë në të ardhurat sipas qarqeve në %.



Burimi: Autori


Në Elbasan, nga 10 të anketuar, 40% kanë evidentuar rritje të xhiros mbi 25%, ndërkohë që një përqindje e ngjashme, 40%, raportojnë rritje mesatare. Këto të dhëna nënvizojnë faktin se mikrokredia ka pasur një efekt të drejtpërdrejtë në forcimin e mikro-bizneseve në zonat më pak të urbanizuara, ku alternativat e financimit formal janë më të kufizuara. Asnjë nga të intervistuarit në Elbasan nuk ka raportuar ulje të xhiros.

Në qarkun e Shkodrës, ku janë intervistuar 9 mikro-ndërmarrës, rezultatet janë më heterogjene: 33% kanë përfituar rritje mbi 25% të të ardhurave, ndërsa 44% raportojnë një rritje mesatare. Megjithatë, 11% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se aktiviteti i tyre ka pësuar ulje të xhiros, gjë që mund të lidhet me faktorë lokalë si konkurrenca informale, kufizimet e infrastrukturës ose pamjaftueshmëria e kërkesës lokale.

Në terma të përgjithshëm, shpërndarja gjeografike e rezultateve konfirmon se mikrokredia ka funksionuar si një mekanizëm i rëndësishëm për përmirësimin e kapacitetit prodhues dhe tregtar të mikro-ndërmarrjeve, veçanërisht në sektorët ku aktiviteti informal është ende i pranishëm dhe qasja në kreditim tradicional është e kufizuar. Diferencat midis qarqeve sugjerojnë nevojën për politika më të synuara rajonale që të adresojnë pengesat strukturore lokale dhe të maksimizojnë potencialin zhvillimor të instrumenteve të mikrofinancës.

Megjithatë, 30% e të intervistuarve janë përgjigjur negativisht, duke lënë të kuptohet se, pavarësisht rritjes së qarkullimit, disa biznese përballen me kosto shtesë ose me marzhe fitimi më të ulëta, ndoshta për shkak të shpenzimeve të paparashikuara, konkurrencës ose planifikimit jo optimal të investimeve.

Figura 8. Vështirësitë për të shlyer mikrokreditin



Burimi: Autori


Si përfundim: mund të themi se mikrokredia ka ndihmuar shumicën të gjenerojnë jo vetëm xhiro më të lartë, por edhe fitim real, megjithatë një pjesë mbetet e ekspozuar ndaj faktorëve që kufizojnë përfitimin maksimal.

Kapaciteti i shlyerjes së mikrokredisë

Përsa i përket kapacitetit të shlyerjes së mikrokredisë, Figura 9, 60% e mikro-ndërmarrësve deklarojnë se nuk kanë vështirësi për të shlyer mikrokreditin, çka tregon një nivel të kënaqshëm të kapacitetit të kthimit të borxhit. Nga ana tjetër, 30% pohuan se ndonjëherë kanë vështirësi, ndërsa 10% e pranojnë se përballen rregullisht me probleme në shlyerje. Kjo nënvizon nevojën për të monitoruar nga afër situatat e mbingarkesës me borxh dhe për të forcuar mekanizmat e këshillimit financiar, në mënyrë që kreditë të mos kthehen në barrë të papërballueshme.

Si përfundim: mund të themi se pavarësisht ndikimit pozitiv, ekziston një segment që ka nevojë për më shumë mbështetje financiare dhe këshillimore për të garantuar kthimin në kohë të borxhit.

Figura 9. Gatishmëria për të shlyer mikrokredi



Burimi: Autori

Perspektiva për përdorimin e mikrokredisë në të ardhmen

Sips 65% e të intervistuarve shprehen të gatshëm të marrin përsëri një mikrokredi në të ardhmen, duke konfirmuar besimin e tyre në këtë instrument financiar si mjet për të zgjeruar ose mbështetur më tej aktivitetin e biznesit. Kështu, 25% janë të mendimit që nuk do ta përdorin më këtë burim, gjë që mund të lidhet me mbylljen e nevojave financiare, përvojat jo pozitive ose vështirësitë në shlyerjen e kredive të mëparshme.

10% mbeten të pavendosur, çka tregon se vendimi për të marrë borxh varet shpesh nga faktorë të jashtëm si kushtet e tregut, normat e interesit dhe siguria ekonomike.

Si përfundim: mund të themi se mikrokredia shihet ende si një mundësi reale për të përmirësuar aktivitetet ekonomike, por për të garantuar qëndrueshmërinë duhet të adresohen faktorët që ndikojnë negativisht tek përfituesit potencialë.

Këto rezultate tregojnë se, në tërësi, mikrokredia ka një ndikim pozitiv në rritjen e të ardhurave dhe të fitimit neto, si dhe gëzon një nivel të lartë besimi tek mikro-ndërmarrësit në Shqipëri.

Megjithatë, sfida si vështirësitë e shlyerjes dhe fitimet jo gjithmonë proporcionale me qarkullimin tregojnë se potenciali i mikrokredisë mund të forcohet më tej përmes trajnimeve, këshillimeve financiare dhe kushteve më të favorshme të kreditimit.


4.2.2. Mikrokredia në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë

Gjatë tre dekadave të fundit, bujqësia dhe blegtoria kanë qenë ndër përfituesit kryesorë të mikrokredisë në Shqipëri, veçanërisht në zonat rurale si Dibra, Korça dhe Fieri. Të dhënat e mbledhura nga intervistat me 42 përfitues individualë në këto rajone tregojnë se rreth 60% e mikrokredive janë përdorur për blerjen e farërave, plehrave dhe kafshëve blegtorale.

Përfitimi më i madh i raportuar ka qenë rritja e prodhimit sezonal dhe mundësia për të shitur produktet në tregjet lokale, duke siguruar një burim të ri të ardhurash. Një pjesë

e fermerëve raportuan gjithashtu rritje të kapaciteteve të magazinimit dhe mundësi për të punësuar punëtorë sezonalë.

Figura 10. Gatishmëria për të marrë përsëri mikrokredi në të ardhmen




Burimi: Autori

Megjithatë, sfidat nuk mungojnë. Mungesa e infrastrukturës rrugore dhe e tregjeve të organizuara e kufizon efektin pozitiv të mikrokredisë. Në disa raste, fermerët kishin vështirësi në përmbushjen e afateve të shlyerjes për shkak të motit të keq apo mungesës së tregut.

Profili demografik dhe strukturor i fermerëve përfitues të mikrokredisë

Siç shihet, pjesa më e madhe e fermerëve që kanë përfituar nga mikro-kredia janë të moshës 31–50 vjeç duke përfaqësuar rreth 52% të të anketuarve. Kjo tregon se mikrokredia përdoret kryesisht nga persona që janë ekonomikisht aktivë, shpesh me familje për të mbajtur, dhe që zakonisht kanë një përvojë të caktuar në sektorin bujqësor apo blegtoral.

Figura 11. Përqindja e fermerëve sipas grupmoshave (%)




Burimi: Autori

Grupmosha mbi 50 vjeç zë një përqindje të moderuar rreth 25%, që mund të lidhet me faktin që fermerët më të vjetër shpesh mbështeten te resurset ekzistuese ose e kanë të vështirë të angazhohen në rritje apo zgjerim të aktivitetit. Ndërkohë, grupmosha më e re, 18–30 vjeç, përbën një pjesë më të vogël të përfituesve rreth 20%, gjë që mund të tregojë një interes më të ulët ose vështirësi të të rinjve për të aksesuar financimin, ndoshta për shkak të mungesës së garancive apo përvojës.

Kjo shpërndarje përforcon idenë se mikrokredia, në sektorin bujqësor, shihet si një mjet për forcimin e kapaciteteve të punës në moshë aktive, ku motivimi për të investuar dhe për të përmirësuar të ardhurat është më i madh.

Nga të dhënat rezulton se 71.4% e përfituesve janë burra, ndërsa vetëm 29% janë gra. Kjo shpërndarje reflekton një realitet tipik të sektorit bujqësor në Shqipëri: bujqësia dhe blegtoia, sidomos fermat individuale ose familjare, janë shpesh të drejtuara dhe të menaxhuara nga burrat, të cilët zakonisht mbajnë rolin formal të pronarit të tokës dhe marrin përgjegjësinë për të nënshkruar kontratat e kredisë. Megjithatë, pjesëmarrja e grave është një tregues i rëndësishëm për rolin joformal të grave në ekonomi.

Figura 12. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë (%) (në të majtë) dhe sipas vendbanimit (në të djathtë)



Burimi: Autori


Shpesh, gratë luajnë rol të madh në prodhimin bujqësor, përpunimin dhe menaxhimin e të ardhurave familjare, edhe pse nuk janë gjithmonë përfituese direkte të kredive. Kjo hap mundësi që politikat e mikrokredisë të fokusohen më tej në përfshirjen e grave, duke ofruar produkte të dedikuara, trajnime dhe kushte më të përshtatshme për sipërmarrësit femra rurale.

Zona rurale dominohet dukshëm me 83.3% të të anketuarve, duke reflektuar fokusin e mikrofinancës në mbështetjen e fermave të vogla rurale. Sipas Figurës 12, pjesa djathtas, 83.3% e fermerëve të anketuar jetojnë dhe punojnë në zonat rurale, ndërsa 17% në zonat periferike urbane ose gjysmë-urbane. Kjo është plotësisht në përputhje me qëllimin kryesor të mikrokredisë në sektorin bujqësor: të mbështesë fermerët dhe familjet rurale që shpesh kanë akses të kufizuar në kredi bankare tradicionale.

Përqindja relativisht e ulët e përfituesve nga zonat gjysmë-urbane mund të tregojë se fermerët në këto zona kanë mundësi më të larmishme financimi ose janë më të integruar në rrjete tregtare ku qasja në kapital bëhet më e lehtë. Megjithatë, shumica e kërkesave për mikrokredi vijnë nga zonat rurale, ku nevoja për investime bazike si farëra, plehra, kafshë, ose pajisje bujqësore mbetet e lartë.

Kjo shpërndarje e forcon bindjen se mikrokredia luan rol kritik për zbutjen e varfërisë rurale, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe rritjen e vetëpunësimit në komunitete që zakonisht janë të marginalizuara financiarisht. Këto të dhëna përputhen me përfundimet e studimeve ndërkombëtare mbi mikrokredinë (p.sh. Armendáriz & Morduch, 2010; Bateman, 2011) ku mikrokredia përdoret kryesisht në zonat rurale për të mbështetur grupet me akses të kufizuar në financa formale dhe ku ekzistojnë dallime gjinore që duhet adresuar me politika më gjithëpërfshirëse.

Figura 13. Shpërndarja në % e fermerëve sipas madhësisë së fermës që disponojnë (%)



Burimi: Autori

Siç paraqitet në Figurën 13, struktura e fermave karakterizohet nga dominimi i fermave të vogla, ku rreth 71% e fermerëve disponojnë sipërfaqe ≤ 2 hektarë, ndërsa vetëm 10% zotërojnë ferma mbi 5 hektarë. Kjo shpërndarje përputhet me karakteristikat strukturore të sektorit bujqësor shqiptar, ku fragmentarizimi i tokës dhe pronësia e parcelave të vogla është ende dominuese që nga procesi i privatizimit pas viteve '90 (Civici, Lerin, 1997; 2001). Sipas Armendáriz & Morduch (2010), një nga avantazhet kryesore të mikrofinancës është që mundëson akses në kredi për grupet që përjashtohen nga sistemi bankar formal për shkak të mungesës së kolateralit. Në rastin shqiptar, fermerët me ferma të vogla shpesh nuk kanë dokumentacion të plotë pronësie apo garanci të mjaftueshme, duke i bërë ata kandidatë tipikë për instrumentet mikrofinanciare.

Për më tepër, Bateman (2010) argumenton se mikrofinanca në Ballkan shpesh ka ruajtur një funksion social, duke mundësuar mbijetesën ekonomike të mikro-ndërmarrjeve dhe fermave të vogla, por pa arritur domosdoshmërisht të gjenerojë transformim strukturor apo rritje të qëndrueshme në shkallë të gjerë. Ky vëzhgim është i dukshëm edhe në këtë rast: përqendrimi i madh i përfituesve të fermat e vogla tregon se mikro-kredia shpesh përdoret për mbulimin e nevojave bazë të inpleteve


sezonale, dhe më rrallë për investime afatgjata që mund të modernizojnë fermën ose të rrisin produktivitetin në mënyrë të qëndrueshme.

Në anën tjetër, fakti që 19% e fermerëve me ferma mesatare dhe 10% me ferma më të mëdha gjithashtu marrin mikro-kredi, sugjeron një hapësirë të kufizuar të mikrofinancës për të ndikuar gradualisht edhe në fermat me potencial më të madh. Megjithatë, kjo mbetet e kufizuar në mungesë të skemave të integruara që kombinojnë mikrofinancën me trajnimin, qasjen në teknologji dhe lidhjen me zinxhirët e vlerës.

Qëllimi i përdorimit të mikrokredisë në sektorin bujqësor dhe blektoral

Rezultatet tregojnë se qëllimi kryesor i përdorimit të mikrokredisë është blerja e farave dhe fidanëve, 60%, gjë që konfirmon rolin themelor të mikrokredisë për mbulimin e nevojave sezonale të inputeve bazë. Një pjesë e konsiderueshme e fermerëve përdorin gjithashtu kreditë për blerje plehrash kimike, 43%, çka tregon fokusin në rritjen e prodhimit intensiv për sipërfaqet ekzistuese.

Figura 14. Shpërndarja e qëllimeve të përdorimit të mikrokredisë nga fermerët, përqindje



Burimi: Autori


Blerja e kafshëve, 29% dhe blerja e pajisjeve bujqësore, 19%, janë më pak të zakonshme, por janë tregues të një tendence drejt përmirësimit të kapaciteteve prodhuese ose diversifikimit të aktiviteteve (p.sh. lidhja e bujqësisë me blegtorinë). Megjithatë, përqindjet relativisht të ulëta për investimet në pajisje tregojnë se mikrokredia përdoret më shumë për shpenzime operative sesa për investime kapitale afatgjata.

Kjo mbështet argumentin e Armendáriz & Morduch (2010) se mikrofinanca në sektorin rural shpesh shërben për kapërcimin e hendekut të likuiditetit, por nuk adreson gjithmonë nevojat për modernizim dhe mekanizim. Për të maksimizuar ndikimin, disa autorë (Bateman, 2011) sugjerojnë që mikrokredia duhet të kombinohet me mbështetje teknike, akses në treg dhe subvencione për teknologji të reja.

Ndikimi i mikrokreditës në rritjen e prodhimit

Rezultatet e përgjithshme tregojnë një ndikim mbizotërues pozitiv të mikrokredisë në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, Figura 15. Rreth 62% e të anketuarve raportojnë një rritje të madhe të prodhimit pas marrjes së kredisë, ndërsa 26% vlerësojnë një rritje mesatare. Vetëm 12% e fermerëve deklarojnë se nuk kanë vërejtur ndonjë ndryshim, ndërkohë që asnjë prej tyre nuk raporton ulje të prodhimit. Kjo tregon se ndikimi nuk është uniform dhe varet nga faktorë si klima, menaxhimi, dhe lloji i kulturës/blegtorisë. Këto të dhëna përforcojnë tezën e Armendáriz & Morduch (2010) dhe Bateman (2011) se kredia përbën një instrument për stimulimin e zhvillimit rural dhe përmirësimin e performancës prodhuese.

Figura 15. Ndikimi i mikro-kredisë në prodhimin bujqësor/blegtori




Burimi: Autori

Ashtu siç shihet edhe në Figurën 16, në qarkun e Dibrës, nga 7 fermerë të pyetur, shumica, 57%, raportojnë një rritje të ndjeshme në prodhim, duke pasuar me 29% që përmendin një rritje mesatare, ndërsa vetëm një individ, 14% nuk vëren asnjë ndryshim. Kjo sugjeron se kredia ka shërbyer si një katalizator për rritje, edhe pse ndikimi nuk është uniform për të gjithë aktorët lokalë.

Sipas të anketuarve në qarkun e Korçës, 15 fermerë, tendenca pozitive është gjithashtu e qartë: 53% raportojnë një rritje të madhe, ndërsa një përqindje relativisht e lartë, 40%, përmend një rritje mesatare. Vetëm një fermer, 7%, nuk ka vërejtur ndryshim në rendimentin e prodhimit. Këto të dhëna sugjerojnë një ndikim të qëndrueshëm të kredisë në rajon, ku pjesa më e madhe e fermerëve përfitojnë ndjeshëm, edhe pse përfitimi është shpërndarë më barazisht ndërmjet kategorive të rritjes. Ndërsa qarku i Fierit, që përfaqëson edhe zonën me numrin më të madh të të anketuarve (20 fermerë), ndikimi i kredisë shfaqet më intensiv: 70% e fermerëve raportojnë një rritje të madhe të prodhimit, ndërsa 20% përmendin rritje mesatare. Vetëm 10% e të anketuarve nuk kanë vërejtur ndryshim, dhe nuk është raportuar asnjë rast me ulje të prodhimit. Kjo tregon për një klimë më të favorshme zhvillimi në këtë rajon, ndoshta si rezultat i kushteve më të mira infrastrukturore, aksesit në tregje ose mbështetjes institucionale.

Figura 16. Shpërndarja gjeografike për vlerësimin e ndikimit të mikrokredisë në prodhimin bujqësor dhe blegtoral për qarqet: Dibër, Korçë dhe Fier



Burimi: Autori

Implikimet shkencore dhe politike

Të dhënat empirike të këtij studimi evidentojnë se mikrokredia funksionon si një instrument me efikasitet të konsiderueshëm në sektorin primar, veçanërisht në zonat rurale ku mungesa e likuiditetit financiar shpesh përbën një pengesë serioze për investime dhe zhvillim. Rritja e të ardhurave dhe stabiliteti i flukseve monetare të familjeve bujqësore, të evidentuar në analizën statistike, sugjerojnë se mikrokredia ka arritur të krijojë një ndikim pozitiv dhe të qëndrueshëm në menaxhimin e aktiviteteve ekonomike të vogla.

Megjithatë, dallimet ndërmjet qarqeve dhe rajoneve nxjerrin në pah rëndësinë e kontekstit lokal në përcaktimin e efektivitetit të mikrokredisë. Faktorë ekonomikë, institucionalë dhe socialë – përfshirë qasjen në tregje, nivelin e edukimit financiar, praninë e institucioneve mbështetëse dhe normat kulturore të bashkëpunimit

komunitar, mund të ndikojnë ndjeshëm në mënyrën se si kredia shfrytëzohet dhe sjell përfitime. Kjo sugjeron se analizat mbi mikrokreditimin nuk mund të jenë homogjene; ato duhet të integrojnë studime krahasimore rajonale dhe vlerësime kontekstuale që adresojnë heterogjenitetin e nevojave dhe mundësive të komuniteteve rurale.

Nga një perspektivë shkencore, gjetjet e këtij studimi konfirmojnë teoritë bashkëkohore mbi mikrofinancën, të cilat argumentojnë se kredia e vogël, e shoqëruar me mbështetje institucionale dhe trajnime profesionale, mund të funksionojë si një katalizator për zhvillim ekonomik dhe social të qëndrueshëm (Armendáriz & Morduch, 2010; Kabeer, 2001). Rezultatet përforcojnë idenë se përfitimet e mikrokredisë nuk lidhen vetëm me dhënien e kapitalit, por edhe me krijimin e një ekosistemi financiar, social dhe institucional që mundëson përdorimin efektiv të burimeve. Nga këndvështrimi politik, implikacionet janë të dyfishta:

Zgjerimi i aksesit në mikrokredi: Politikat zhvillimore duhet të synojnë rritjen e pranisë së institucioneve mikrofinanciare në rajone ku ndikimi aktual është më i ulët, duke adresuar hendekun rajonal në qasjen në financim. Kjo përfshin krijimin e degëve të reja, stimulimin e partneriteteve publike-private dhe përdorimin e teknologjive digjitale për qasje më të shpejtë dhe më të lirë në kredi.

Mbështetje komplementare për përdoruesit: Përveç kapitalit financiar, ndërhyrjet duhet të përfshijnë trajnime mbi menaxhimin e biznesit, edukim financiar, këshillim teknik dhe asistencë në qasjen në tregje. Kjo qasje integruese rrit mundësinë që kredia të përdoret për investime produktive, të rrisë kapacitetin ekonomik të fermerëve dhe të zvogëlojë rrezikun e borxhit.

Një strategji e tillë ka potencial të kontribuojë në modernizimin e bujqësisë, përmes përdorimit të fondeve mikrofinanciare për blerje makinerish të vogla, inpute bujqësore cilësore dhe teknologji për menaxhimin e prodhimit. Gjithashtu, ajo mund të forcojë kohezionin ekonomik ndërmjet rajoneve, duke reduktuar pabarazitë në aksesin financiar dhe duke krijuar mundësi të barabarta zhvillimi për fermerët në zona urbane dhe rurale.


Në përmbledhje, implikimet shkencore dhe politike të këtij studimi tregojnë se mikrokredia nuk është thjesht një instrument financiar i izoluar, por një komponent i rëndësishëm i një arkitekture të qëndrueshme zhvillimore. Për të maksimizuar ndikimin e saj, politikat duhet të ndërthurin qasjen në financim me mbështetje teknike, edukim financiar dhe mekanizma institucionale që i japin fermerëve kapacitetin dhe fleksibilitetin për të përdorur kredinë si mjet për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Ndikimi i mikrokredisë në performancën financiare

Rezultatet në Figurën 17, sugjerojnë se mikrokredia ka ndikuar ndjeshëm pozitivisht në të ardhurat e fermerëve, ku 62% e tyre raportojnë një rritje të konsiderueshme të të ardhurave si rezultat i aksesit në financim. Një pjesë tjetër, që përfaqëson 29% të të anketuarve, evidenton një ndikim të moderuar, ndërsa vetëm 9% nuk kanë vërejtur asnjë ndryshim të rëndësishëm. Vlen të theksohet se asnjë fermer nuk ka raportuar një

ndikim negativ, çka përforcon perceptimin pozitiv mbi rolin e mikrokredisë në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të zonave rurale.

Figura 17. Ndikimi në % i mikrokredisë në të ardhurat e fermerëve



Burimi: Autori

Në qarkun e Dibrës, 57% e fermerëve (4 nga 7) raportojnë një ndikim të fortë pozitiv, ndërsa 29% një ndikim të moderuar. Vetëm një fermer nuk ka vënë re ndryshime të të ardhurave. Kjo shpërndarje tregon për një efekt të dukshëm të mikrokredisë në këtë zonë, ndonëse në një mostër relativisht të vogël. Në Korçë, rezultatet janë edhe më premtuese: 67% e fermerëve kanë përfituar dukshëm nga mikrokredia, ndërsa 27% kanë pasur një ndikim të moderuar. Vetëm 6% nuk kanë përjetuar ndryshim. Kjo tregon për një klimë më të strukturuar dhe ndoshta për mekanizma më të zhvilluar të menaxhimit të fondeve.


Ndërkohë, Fieri, që përfaqëson edhe grupin më të madh të fermerëve, 20, paraqet përqindjen më të lartë të ndikimit të fortë pozitiv, 70%, me vetëm 10% që nuk kanë vërejtur ndryshim. Kjo sugjeron që mikrokredia në Fier mund të ketë hasur në kushte më të favorshme të investimit, qoftë në infrastrukturë, tregje të aksesueshme apo praktika moderne bujqësore dhe blegtorale.

Në këtë kontekst, hartimi i programeve trajnuese të specializuara për menaxhimin e kredisë, planifikimin financiar dhe aftësitë sipërmarrëse shihet si një hap i domosdoshëm për të forcuar ndikimin pozitiv të instrumentit. Të tilla programe mund të përfshijnë:

Edukim financiar dhe trajnime mbi menaxhimin e borxhit, që ndihmojnë fermerët të kuptojnë detyrimet dhe të planifikojnë pagesat në përputhje me flukset e tyre sezonale të të ardhurave;

Konsulencë teknike mbi përdorimin produktiv të fondeve, duke përfshirë investime në teknologji bujqësore, përmirësimin e infrastrukturës së magazinimit dhe përpunimin e produkteve;

Figura 18. Shpërndarja gjeografike për vlerësimin e ndikimit të mikrokredisë në të ardhurat e fermerëve për qarqet: Dibrë, Korçë dhe Fier



Burimi: Autori

Monitorim i vazhdueshëm i përdorimit të kredive përmes sistemeve të raporteve periodike dhe vizitave në terren, që ofrojnë mundësi për ndërhyrje parandaluese në rastet e menaxhimit të dobët të fondeve.

Për më tepër, rezultatet tregojnë se mikrokredia mund të funksionojë si një katalizator për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor, kur përdoret si pjesë e një qasjeje integrale zhvillimore, e cila kombinon mbështetjen financiare me edukimin, qasjen në tregje dhe infrastrukturën logjistike. Integrimi i këtyre komponentëve mund të ndihmojë jo vetëm në rritjen e të ardhurave individuale, por edhe në stabilizimin e komuniteteve rurale, duke reduktuar vulnerabilitetin ndaj shokëve të jashtëm ekonomikë dhe klimatikë.

Në përfundim, studimi sugjeron se, për të maksimizuar potencialin e mikrokredisë në sektorin bujqësor, politikat dhe programet duhet të jenë të lokalizuara, fleksibile dhe të shoqëruara me mbështetje edukative dhe teknike. Vetëm një qasje e tillë mund të garantojë që mikrokredia të mos jetë thjesht një mjet financiar i përkohshëm, por një instrument transformues për zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm në zonat rurale shqiptare.

Perspektiva për përdorimin e mikrokredisë në të ardhmen

Analiza e të dhënave mbi pyetjen: “A do të merrnit përsëri një mikrokredi?” ofron një pasqyrë të thellë mbi perceptimet e fermerëve dhe mundësitë për zgjerimin e përdorimit të mikrokredisë në sektorin rural shqiptar. Rreth 67% e të anketuarve shprehën se do të merrnin patjetër një mikrokredi në të ardhmen, një tregues që konfirmon përfitimet perceptuese dhe ekonomike të këtij instrumenti financiar. Ky rezultat korrespondon me literaturën ndërkombëtare mbi mikrokreditimin, e cila sugjeron se përvojat pozitive, të kombinuara me mbështetje të përshtatshme, rrisin gatishmërinë për të rikthyer përdorimin e kredive të vogla.

Një pjesë tjetër e konsiderueshme, rreth 26%, shprehin një qëndrim të rezervuar, duke e kushtëzuar interesin e tyre me përmirësimin e kushteve të mikrokredisë, përfshirë normat e interesit, afatet e shlyerjes dhe cilësinë e shërbimit ndaj klientit. Ky fenomen është mjaft i rëndësishëm nga perspektiva e hartimit të politikave mikrofinanciare, pasi tregon se edhe kur mikrokredia ofron përfitime, barriera të vogla financiare dhe administrative mund të pengojnë përdorimin e saj të plotë. Për më tepër, kjo kategori e përdoruesve rezervuar pasqyron nevojën për inovacione produktesh mikrofinanciare dhe fleksibilizim të politikave që adresojnë flukset sezonale të të ardhurave dhe pasigurinë ekonomike të fermerëve.

Një grup më i vogël, 7% e të anketuarve, deklarojnë se nuk kanë më nevojë për mikrokredi. Kjo mund të interpretohet në dy mënyra: së pari, si rezultat i stabilizimit të situatës financiare të individëve dhe përparimit të aktiviteteve ekonomike; dhe së dyti, si një riorientim i strategjive të menaxhimit të burimeve, duke iu drejtuar instrumenteve alternative financiare ose granteve. Interesante është se nuk u raportua asnjë rast i përvojës negative që të kishte çuar në refuzimin e përdorimit të kredive në të ardhmen, çka përbën një tregues pozitiv për performancën e institucioneve mikrofinanciare dhe për besueshmërinë e këtij instrumenti financiar në komunitetet rurale.

Analiza krahasimore midis qarqeve ofron informacion shtesë mbi kontekstualizimin e perceptimeve. Dibra shfaq nivelin më të lartë të gatishmërisë për përdorim të mëtejshëm të mikrokredisë, 71%, një rezultat që mund të lidhet me nevojën më të madhe për mbështetje financiare në zonat më të izoluara ose me zhvillim të kufizuar. Korça dhe Fieri, krahasuar me qarqe të tjera, tregojnë gjithashtu përqindje të larta, 65–67% të gatishmërisë për të rikthyer përdorimin e mikrokredisë, duke sugjeruar që ky instrument është integruar gradualisht si pjesë e praktikave të zakonshme të menaxhimit financiar dhe planifikimit të aktiviteteve bujqësore.

Nga perspektiva teorike dhe praktike, këto rezultate përforcojnë tezën se mikrokredia nuk është thjesht një mjet financiar, por një instrument adaptiv që mund të fuqizojë kapacitetin e vendimmarrjes së fermerëve, të nxisë plane investimesh të qarta dhe të rrisë reziliencën ekonomike të komuniteteve rurale. Gjithashtu, kjo evidencë sugjeron që për të maksimizuar përdorimin e mikrokredisë në të ardhmen, është e nevojshme të ndërthuren politikat mikrofinanciare me:

- Fleksibilizim të produkteve dhe afateve të shlyerjes, duke i përshtatur ato me ciklet sezoniere të prodhimit;
- Përmirësim të ndërveprimit institucion-klient përmes shërbimit më të shpejtë dhe këshillimit profesional;
- Integrim të trajnimeve mbi menaxhimin financiar, planifikimin e investimeve dhe përdorimin efektiv të fondeve, në mënyrë që përdoruesit të përfitojnë maksimalisht nga kredia dhe të minimizojnë rrezikun e borxhit.

Në përfundim, perspektiva e përdorimit të mikrokredisë në të ardhmen tregon se, përveç përfitimeve ekonomike, ky instrument ka fituar besim dhe legjitimitet në komunitetet rurale shqiptare. Ky fakt e bën mikrokreditin jo vetëm një mekanizëm të qasshëm financiar, por edhe një komponent të rëndësishëm të strategjive zhvillimore të qëndrueshme, ku ndikimet socio-ekonomike dhe kulturore e fuqizojnë rolin e saj si instrument për zhvillim gjithëpërfshirës.


Rezultatet empirike të mbledhura tregojnë se mikrokredia ka fituar një nivel të konsiderueshëm besimi në komunitetet rurale, veçanërisht ndër fermerët që operojnë në ekonominë familjare dhe në sektorët bujqësorë me intensitet të lartë të punës. Një pjesë e madhe e të anketuarve e percepton mikrokreditimin jo thjesht si një instrument financiar, por si një mundësi strategjike për investime të ardhshme që mund të kontribuojnë në rritjen e prodhimit, diversifikimin e aktiviteteve ekonomike dhe përmirësimin e stabilitetit të të ardhurave.

Përceptimi i mikrokredisë nga komunitetet rurale dhe implikimet për zhvillimin bujqësor

Ky perceptim pozitiv konfirmon rëndësinë e mikrokredisë si një mekanizëm i aksesit financiar për aktorët që tradicionalisht janë të përjashtuar nga institucionet bankare tradicionale, duke harmonizuar rezultatet me literaturën ndërkombëtare mbi efektivitetin e mikrokredisë në vendet në zhvillim (Armendáriz & Morduch, 2010 ; FAO, 2021).

Analiza statistikore e të dhënave tregon se përqindja e lartë e përgjigjeve pozitive për rikthimin të mikrokredisë tregon ekzistencën e një hapësire të konsiderueshme për zgjerimin e portofolit të mikrokredisë në Shqipëri, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sektorit bujqësor. Ky gjetje sugjeron se institucionet mikrofinanciare mund të përdorin strategji të orientuara ndaj fermerëve për të rritur pjesëmarrjen dhe për të stimuluar një cikël investimesh të qëndrueshme. Për më tepër, ekzistojnë mundësi për zhvillimin e produkteve mikrofinanciare të specializuara, të përshtatura për nevojat sezonale, ciklin e korrjes, apo për projekte të specifikuara të përpunimit dhe tregimit të produkteve bujqësore.

Figura 19. Gatishmëria për të marrë përsëri mikrokredi në të ardhmen



Burimi: Autori

Megjithatë, një analizë më e detajuar e komenteve të hapura dhe përgjigjeve kushtëzuese nxjerr në pah disa sfida që lidhen me perceptimin dhe përdorimin e mikrokredisë nga një pjesë e komuniteteve rurale. Këto përfshijnë :

Përmirësim të kushteve të mikrokredisë : Pjesa e fermerëve që shpreh rezerva mbi përdorimin e kredive identifikon normat relativisht të larta të interesit dhe mungesën e fleksibilitetit në pagesa si pengesa kryesore. Për pasojë, përshtatja e strukturës së interesit dhe ofrimi i mundësive për shtyrje ose ristrukturim të kredive gjatë periudhave me të ardhura të ulëta sezonale mund të rrisë përfitueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e kredive.

Transparencë më e madhe në kontrata dhe procedura : Një pjesë e përfituesve vë në dukje nevojën për qartësi të plotë në lidhje me kushtet, obligimet dhe penalitetet e mundshme, duke theksuar rëndësinë e edukimit financiar dhe asistencës gjatë nënshkrimit të kontratave. Mbështetje teknike dhe edukative për përdorimin efektiv të kredive: Përveç qasjes në kapital, fermerët kërkojnë shërbime mbështetëse që përfshijnë trajnime mbi menaxhimin financiar, planifikimin e prodhimit dhe strategjitë e marketingut, si dhe asistencë në përdorimin e teknologjive të reja bujqësore. Ky gjetje është në përputhje me literaturën e FAO (2021), e cila argumenton se mikrokredia është veçanërisht efektive kur shoqërohet me ndërhyrje mbështetëse në zinxhirin e vlerës bujqësore, duke përfshirë asistencën teknike, qasjen në tregje dhe ndihmën në certifikimin e produkteve.

Analiza sugjeron se ndikimi i mikrokredisë në komunitetet rurale nuk është vetëm financiar, por gjithashtu socio-ekonomik dhe zhvillimor. Kur shoqërohet me politika mbështetëse, edukim dhe infrastrukturë të përshtatshme, mikrokredia ka potencialin të krijojë një cikël vetëndërtues zhvillimi, ku rritja e të ardhurave stimulohet nga përmirësimi i aftësive, diversifikimi i veprimtarive dhe fuqizimi i vendimmarrjes lokale. Për më tepër, ndërhyrjet e koordinuara mund të kontribuojnë në përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe reziliencës së komuniteteve ndaj shokëve të jashtëm ekonomikë dhe klimatikë.

Në përfundim, gjetjet nënvizojnë se mikrokredia në Shqipëri ka fituar një bazë të fortë besimi në komunitetet rurale dhe ofron një platformë premtuese për zgjerimin e mbështetjes financiare në bujqësi. Megjithatë, për të maksimizuar efektivitetin e saj,


institucionet mikrofinanciare duhet të adoptojnë një qasje holistike, ku krahas kapitalit financiar, ofrohen mbështetje teknike, edukative dhe fleksibilitet institucional, duke ndërtuar kështu një ekosistem zhvillimi që fuqizon fermerët dhe kontribuon në reduktimin e varfërisë rurale dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor.

4.3 Vlerësimet mbi mikrokreditin

4.3.1. Avantazhet kryesore

Nga analizimi i përgjigjeve të hapura, rezulton se rritja e qarkullimit të shitjeve është avantazhi më i rëndësishëm që ndërmarrësit e vegjël e lidhin me mikrokreditin (60 % e të intervistuarve). Përveç kësaj, 40 % përmendin përmirësimin e hapësirës së punës, që nënkupton investime në pajisje ose rinovim të dyqaneve. Ndërkohë, 30 % e të intervistuarve vlerësojnë ndikimin e mikrokredisë në stabilitetin e likuiditetit, duke theksuar rëndësinë e kapitalit qarkullues për të përballuar periudhat e vështira. Ky klasifikim tregon që mikrokredia nuk shërben vetëm për zgjerim fizik të biznesit, por luan një rol të drejtpërdrejtë në forcimin e kapacitetit financiar të përditshëm të ndërmarrjeve të vogla.

Figura 20. Avantazhet kryesore në % të identifikuar nga ndërmarrësit



Burimi: Autori

4.3.2. Vështirësitë dhe disavantazhet e perceptuara

Analiza e të dhënave të mbledhura nga intervistat dhe pyetësorët tregon se, megjithë përfitimet e konsiderueshme të mikrokredisë për sipërmarrësit e vegjël, ekzistojnë një sërë vështirësish dhe disavantazhesh që ndikojnë mbi përdorimin dhe efektivitetin e saj. Një nga shqetësimet më të përhapura, e identifikuar nga rreth 55 % e të intervistuarve, lidhet me normat e larta të interesit, të cilat shpesh ndikojnë në mënyrë direkte mbi rentabilitetin neto të biznesit. Kjo situatë sugjeron që, për shumë ndërmarrës të vegjël, kostoja totale e huasë mund të ngadalësojë ritmin e kthimit të investimit dhe të kufizojë mundësinë për zgjerim të aktivitetit ekonomik. Ky fenomen përputhet me literaturën ndërkombëtare që tregon se normat e interesit të larta mund të krijojnë një barrë financiare që, në rastin e mikrofinancës, shpesh perceptohet si një pengesë për zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit (Morduch, 1999; Armendáriz & Morduch, 2010).

Një tjetër shqetësim i rëndësishëm, i evidentuar nga 40 % e të intervistuarve, lidhet me vështirësitë e shlyerjes së kredive gjatë periudhave me shitje të dobëta. Këto periudha, shpesh sezonaliteti në tregje apo ndryshimet e paparashikuara ekonomike, rrisin presionin mbi likuiditetin e ndërmarrjeve të vogla dhe mund të ndikojnë negativisht në stabilitetin financiar të huamarrësve. Analiza tregon se mungesa e aftësisë për të menaxhuar flukset e parasë në mënyrë fleksibile çon në stres financiar dhe, në disa raste, mund të rezultojë në vonesa ose dështime në shlyerjen e kredive.

Gjithashtu, rreth 35 % e pjesëmarrësve përmendin afatet strikte të shlyerjes si një kufizim të rëndësishëm. Afatet e paracaktuara, shpesh të përcaktuara nga politikat standarde të institucioneve mikrofinanciare, nuk marrin parasysh ndryshimet individuale në ciklet e biznesit apo nevojat emergjente të huamarrësve. Kjo tregon nevojën për mekanizma më fleksibël që mund të përshtaten me ritmin ekonomik të sipërmarrjeve të vogla dhe të ulin barrën administrative dhe psikologjike mbi huamarrësit.


Një shqetësim i fundit, i evidentuar nga 20 % e të intervistuarve, lidhet me mungesën e fleksibilitetit në situata të jashtëzakonshme, si sëmundje, fatkeqësi natyrore, krizë ekonomike apo goditje të tjera të paparashikuara. Për këta huamarrës, pamundësia për të rinegociuar afatet apo për të përfituar nga masat e përkohshme të mbështetjes përbën një rrezik të qartë për stabilitetin financiar dhe mund të kufizojë besimin në sistemin mikrofinanciar.

Ky set shqetësimesh tregon se, edhe pse mikrokredia mbetet një instrument i rëndësishëm për zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla dhe për fuqizimin ekonomik të individëve, efektiviteti i saj mund të përmirësohet duke rishikuar disa aspekte strukturore. Konkretisht, rekomandohet:

- Rishikimi i normave të interesit, duke balancuar qëndrueshmërinë financiare të institucioneve mikrofinanciare me aftësinë paguese të huamarrësve.
- Fleksibiliteti në afatet e shlyerjes, duke mundësuar përshtatje me ciklet ekonomike dhe sezonalitetin e aktiviteteve mikroekonomike.
- Mekanizma emergjentë dhe mbështetje për situata të jashtëzakonshme, për të ruajtur besimin e huamarrësve dhe për të parandaluar dështimet e panevojshme financiare.
- Integrimi i shërbimeve mbështetëse, si trajnime në menaxhimin financiar, planifikim të flukseve të parasë dhe konsulencë për zhvillimin e biznesit, për të zvogëluar riskun e dështimeve dhe për të rritur ndikimin pozitiv të mikrokredisë.

Në përfundim, kjo analizë evidencon se mikrokredia është një instrument me potencial të lartë, por që kërkon adaptim dhe personalizim në nivel të politikave dhe dizajnit të produktit për të maksimizuar përfitimet ekonomike dhe për të minimizuar disavantazhet për përdoruesit. Kjo qasje nuk është vetëm e nevojshme për qëndrueshmërinë e sistemit, por edhe për realizimin e objektivave më të gjera socio-ekonomike që lidhen me fuqizimin e individëve dhe zhvillimin e komuniteteve.

Figura 21. Vështirësitë dhe disavantazhet e perceptuara



Burimi: Autori

4.3.3. Komentet e hapura dhe sugjerimet e përmirësimit nga ndërmarrësit

Analiza e të dhënave cilësore të mbledhura përmes intervistave me ndërmarrësit e vegjël nxjerr në pah disa drejtime të qarta dhe të përsëritura për përmirësimin e praktikave të mikrokredisë. Komentet e hapura ofrojnë një vështrim të thelluar mbi perceptimet e huamarrësve dhe nevojat reale të tyre, duke e pasuruar kuadrin kuantitativ të analizës statistikore.

Rreth 45 % e të intervistuarve identifikojnë normat e larta të interesit si barrën më të rëndë financiare që ata përballojnë. Sipas tyre, këto norma jo vetëm që reduktojnë fitimet neto të bizneseve të vogla, por gjithashtu kufizojnë mundësinë e reinvestimit në aktivitete zhvillimore. Ky shqetësim është në përputhje me literaturën ndërkombëtare mbi mikrokredisë, ku studime të ndryshme (Morduch, 1999; Armendáriz & Morduch, 2010) tregojnë se normat e larta të interesit mund të ndikojnë negativisht mbi qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve mikro dhe mbi aftësinë e tyre për të krijuar cikle të qëndrueshme ekonomike.

Një tjetër sugjerim i rëndësishëm, i evidentuar nga 30 % e të intervistuarve, lidhet me zgjatjen e afateve të shlyerjes. Për sipërmarrësit e vegjël, flukset e të ardhurave shpesh janë sezonale dhe nuk përputhen me afatet fikse të kredive. Prandaj, zgjatja e afateve ofron mundësinë për të menaxhuar më mirë luhatjet e të ardhurave dhe për të shmangur vonesat apo penalitetet që mund të rrisin barrën financiare dhe presionin psikologjik mbi huamarrësit. Kjo sugjeron se një dizajn më fleksibël i produkteve mikrofinanciare mund të rrisë performancën e bizneseve dhe të ulë riskun e dështimeve.


Rreth 20 % e të intervistuarve kanë theksuar nevojën për informacion dhe trajnim shtesë, veçanërisht në fushat e menaxhimit financiar, planifikimit të biznesit dhe zhvillimit të aftësive sipërmarrëse. Kjo vë në dukje një boshllëk kritik në shërbimet mbështetëse që zakonisht ofrohen nga institucionet mikrofinanciare. Integrimi i programeve të trajnimit dhe konsulencës së biznesit në paketat e mikrokredisë mund

të rrisë kapacitetin e huamarrësve për të përdorur kreditë në mënyrë më efikase dhe për të krijuar projekte ekonomike me potencial afatgjatë.

Një shqetësim më pak i përhapur, por po aq i rëndësishëm, lidhet me mungesën e fleksibilitetit në rastet e krizave të paparashikuara, siç është evidentuar nga 15 % e të intervistuarve. Këta huamarrës kërkojnë mekanizma që të mundësojnë shtyrjen e pagesave në situata emergjente, si sëmundje, katastrofa natyrore ose krizë ekonomike, pa penalitete të rëndësishme. Ky aspekt është i lidhur drejtpërdrejt me qëndrueshmërinë e sistemit mikrofinanciar, sepse fleksibiliteti institucional mund të ruajë besimin dhe të minimizojë rreziqet e falimentimeve të panevojshme.

Analiza e përbashkët e këtyre komenteve tregon një mesazh të qartë: huamarrësit nuk kërkojnë vetëm kapital, por edhe kushte më të favorshme dhe mbështetje shtesë. Kjo përfshin një kombinim të normave të interesit të arsyeshme, afateve fleksibël, shërbimeve mbështetëse dhe mekanizmave për situata emergjente. Përveç krijimit të kushteve më të përshtatshme për përfituesit, implementimi i këtyre masave ka potencialin të ndikojë pozitivisht në suksesin afatgjatë të mikrokredisë, duke e kthyer atë nga një mjet financiar i thjeshtë në një instrument të fuqishëm për zhvillim ekonomik dhe social.

Figura 22. Komentet dhe sugjerimet shtesë të ndërmarrësve



Burimi: Autori

Përfundimisht, këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e një qasjeje holistike dhe të integruar në menaxhimin e mikrokredisë, ku ndërveprojnë dimensionet financiare, edukative dhe institucionale. Një sistem i tillë mund të maksimizojë ndikimin socio-ekonomik të mikrokredisë dhe të ofrojë një model më të qëndrueshëm për zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla në Shqipëri.

Nga analizimi i pyetjeve të hapura, rezulton se mikrokredia shihet si një mjet i dobishëm për të zgjeruar aktivitetin ekonomik, por në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit shprehin nevojën për kushte më fleksibël dhe mbështetje të vazhdueshme për të maksimizuar ndikimin pozitiv.

4.4. Përmbledhje e kapitullit

Kapitulli paraqet gjetjet kryesore empirike mbi ndikimin e mikrokreditimit në zhvillimin ekonomik dhe financiar në Shqipëri gjatë periudhës 2013–2023, duke kombinuar analizën mikro dhe makroekonomike. Rezultatet tregojnë një zgjerim të konsiderueshëm të sektorit të mikrofinancës, i reflektuar në rritjen e numrit të huamarrësve dhe të vëllimit të kredive të disbursuara, çka sugjeron një përmirësim të aksesit në financim për bizneset e vogla dhe individët. Paralelisht, evidenca empirike tregon një përputhje kohore midis rritjes së mikrokredisë dhe rritjes së PBB-së reale, duke mbështetur hipotezën se zgjerimi i aksesit në financa kontribuon në stimulimin e aktivitetit ekonomik, megjithëse pa konkluduar drejtpërdrejt një marrëdhënie shkak-pasojë pa analiza ekonometrike të plota.

Në nivel mikroekonomik, gjetjet evidentojnë një ndikim pozitiv të mikrokredisë në performancën financiare të përfituesve, veçanërisht në sektorin rural, ku shumica e fermerëve raportojnë rritje të të ardhurave dhe përmirësim të kapaciteteve prodhuese si rezultat i aksesit në financim. Për më tepër, mikrokredia shfaq efekte të gjera socio-ekonomike, duke kontribuar në modernizimin e aktiviteteve bujqësore, reduktimin e pabarazive rajonale dhe forcimin e kohezionit ekonomik lokal. Megjithatë, kapitulli thekson se efektiviteti maksimal i mikrokredisë arrihet vetëm kur ajo shoqërohet me politika mbështetëse, edukim financiar dhe asistencë teknike, duke sugjeruar nevojën për një qasje holistike zhvillimore. Në përfundim, gjetjet e punimit argumentojnë se mikrokredia përbën një instrument të rëndësishëm për zhvillimin gjithëpërfshirës dhe reduktimin e varfërisë, por ndikimi i saj është i kushtëzuar nga konteksti institucional, strukturor dhe nga cilësia e ekosistemit mbështetës ekonomik.

KAPITULLI 5 - KONKLUZIONE TË PËRGJITHSHME

Analiza e kryer mbi ndikimin e mikrokreditimit në Shqipëri gjatë dekadës së fundit (2013-2023) konfirmon se ky instrument financiar ka dimensione të shumëfishta, të cilat shkojnë përtej rritjes ekonomike dhe përfshijnë edhe aspektet sociale, gjinore dhe institucionale të zhvillimit. Duke përdorur të dhëna empirike të kombinuara me rishikimin kritik të literaturës ndërkombëtare, ky kapitull përmbledh gjetjet kryesore të kerkimit, identifikon kufizimet strukturore dhe metodologjike dhe ofron një sere rekomandimesh strategjike për politikeberesit dhe institucionet e mikrofinancës.

5.1 Përfundime të përgjithshme mbi gjetjet e studimit

Rezultatet e studimit zbulojnë një marrëdhënie të fortë pozitive midis shpërndarjes së mikrokredisë dhe rritjes së PBB-së në Shqipëri. Analiza e regresionit dëshmon se mikrokredia është një mjet i fuqishëm për të stimuluar aktivitetin ekonomik. Kjo evidentohet nga rritja e ndjeshme e PBB-së, e lidhur ngushtësisht me rritjen e mikrokredisë.

Duke ofruar qasje financiare për popullatat e pashërbyera, mikrokredia promovon aktivitetin sipërmarrës dhe përfshirjen financiare. Korrelacioni i vëzhguar përputhet me teoritë që sugjerojnë se përfshirja financiare mund të rritë produktivitetin, të zvogëlojë papunësinë dhe në fund të fundit, të nxisë rritjen e PBB-së (Ledgerwood, 2013). Në Shqipëri, mikrokredia ka kontribuar në një pjesëmarrje më të madhe ekonomike të familjeve me të ardhura të ulëta, duke i fuqizuar dhe ndihmuar ato për të gjeneruar të ardhura dhe për të përmirësuar jetesën, cka reflektohet në rritjen e qëndrueshme të PBB-së, të vëzhguar së bashku me zgjerimin e mikrokredisë.

Mikrokredia ka pësuar një zgjerim të madh. Rritja e shpejtë e numrit të huamarrësve tregon se mikrokredia është bërë më e arritshme dhe më tërheqëse, për faktin që për popullatat rurale ose ekonomikisht të cënueshme, ajo shërben si një alternativë ndaj bankave konvencionale. Ndërsa përmes mikrokredise individët arrijnë të financojnë idetë e tyre për biznesin, ekonomia e gjerë përfiton nga krijimi i vendeve të reja të punës, rritja e të ardhurave familjare dhe ulja e varfërisë. Ndërsa analiza përqendrohet kryesisht në efektin që ka mikrokredia mbi PBB-në, ndikimi i saj është më i gjërë dhe përfshin edhe aspektet sociale, të tilla si shpërndarja e përmirësuar e të ardhurave dhe zbutja e varfërisë, të cilat mund të jenë një fushë për studime të ardhshme.

Edhe pse mikrokredia ka treguar përfitime të konsiderueshme ekonomike, ajo shoqërohet edhe me rreziqe kur behet fjale për rritjen e kreditimit për popullatat me të ardhura të ulëta. Mbingarkesa me borxhe, veçanërisht e huamarrësve me njohuri të kufizuara financiare, mund të çojë në paqëndrueshmëri financiare. Prandaj, politikat duhet të përfshijnë masa për të promovuar praktikën e përgjegjshme dhe etike të huadhënies, edukimin e huamarrësve dhe mbështetjen për menaxhimin e borxhit për të zbutur rreziqet dhe për të siguruar që mikrokredia të mbetet e qëndrueshme.

Pa integrim me politika publike, programe trajnimi dhe mekanizma sigurie sociale, mikrokredia mbetet një instrument pjesërisht efektiv. Ajo mund të lehtësojë pasojat e varfërisë, por nuk garanton një transformim socio-ekonomik të qëndrueshëm.

Nga perspektiva politibërëse këto rezultate nënvizojnë rëndësinë e mbështetjes dhe shkallëzimit të iniciativave të mikrokredisë, veçanërisht në ekonomitë në zhvillim ku shërbimet financiare tradicionale janë të kufizuara ose të paarrtshme. Rasti i Shqipërisë ilustron me se miri faktin se si zgjerimi i aksesit në kredi mund të fuqizojë pronarët e bizneseve të vogla, fermerët dhe individë të tjerë, që nuk kanë mundësi bankare konvencionale, duke i ndihmuar ata të marrin pjesë aktivisht në ekonomi.

Politikëbërësit mund të marrin në konsideratë krijimin e stimujve për institucionet e mikrofinancës, miratimin e kuadrove rregullatore mbështetëse ose integrimin e iniciativave të mikrokredisë në strategji më të gjera të zhvillimit ekonomik. Politika të tilla mund të rritin ndikimin e mikrokredisë, jo vetëm në rritjen e PBB-së, por edhe në uljen e varfërisë, përfshirjen financiare dhe lëvizshmërinë sociale.

Pavaresisht faktit që mikrokredia shfaqet si një mjet i vlefshëm për fuqizimin ekonomik, e aftë të nxisë rritjen dhe qëndrueshmërinë brenda ekonomive, kërkime të mëtejshme janë thelbësore për të eksploruar ndikimet afatgjata të saj në stabilitetin ekonomik, shpërndarjen e pasurisë dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla.

Studimet e ardhshme mund të përqendrohen në identifikimin e kushteve në të cilat mikrokredia ka ndikimin më të rëndësishëm dhe në eksplorimin e rreziqeve ose pasojave të padëshiruara

Në mënyrë më specifike sugjerojmë se kerkimet e ardhshme mund të eksplorojnë me tej:

- Efektet afatgjata të mikrokredisë në stabilitetin ekonomik dhe shpërndarjen e pasurisë.
- Parametrat optimalë për politikëbërje që maksimizojnë përfitimet ekonomike dhe sociale.
- Rreziqet e mundshme të mbingarkesës me borxhe dhe menaxhimin e qëndrueshëm të kredive në komunitetet me të ardhura të ulëta.

5.5.1.2 Kufizimet dhe sfidat e mikrokreditimit

Edhe pse mikrokredia ka sjellë përfitime të dukshme, studimi evidenton disa kufizime të rëndësishme që lidhen me përdorimin dhe efektivitetin e saj, të cilat duhet të merren parasysh për zhvillimin e politikave dhe praktikave të ardhshme:

- Adresimi i varfërisë strukturore: Mikrokredia shpesh nuk arrin të ndikojë në faktorët themelorë të varfërisë, përfshirë informalitetin e ekonomisë, pabarazitë sociale, mungesën e infrastrukturës dhe dobësitë institucionale. Kjo sugjeron se mikrokredia duhet të integrohet me strategji të gjerë zhvillimi ekonomik dhe sociale për të prodhuar rezultate të qëndrueshme.
- Rreziku i mbingarkesës financiare: Një pjesë e përfituesve, veçanërisht ata me aktivitet ekonomik të paqëndrueshëm, përballen me presion të lartë shlyerjeje

kredie, që mund të rrisë stresin financiar dhe të minojë qëndrueshmërinë ekonomike.

- Kufizimi afatshkurtër i përfitimeve: Përfitimet fillestare shpesh janë të përkohshme dhe nuk garantojnë transformim afatgjatë socio-ekonomik, duke i lejuar varfërisë të rikthehet pas përfundimit të ciklit të kreditimit.

Këto kufizime theksojnë nevojën për integrimin e mikrokredisë me politika publike të qëndrueshme, programe trajnimi, edukim financiar, dhe mekanizma sigurie sociale. Vetëm një qasje holistike mund të sigurojë që mikrokredia të funksionojë si një instrument transformues i qëndrueshëm, dhe jo thjesht si një masë emergjente për lehtësimin e varfërisë.

5.1.1 Ndikimet i mikrokreditimit në nivel mikro dhe makroekonomik

Analiza e rritjes së mikrokreditimit dhe tendences së huamarrësve në Shqipëri nga viti 2013 deri në vitin 2023 zbulon një korrelacion të qartë pozitiv midis zgjerimit të mikrokreditimit dhe rritjes ekonomike, në lidhje me PBB-në. Të dhënat tregojnë një rritje eksponenciale në numrin e huamarrësve, i cili kaloi nga vetëm 2,000 në vitin 2013, në 224,431 në vitin 2023, ndërkohë që vëllimi i mikrokredisë së shpërndarë u rrit 76-fish. Ky trend tregon jo vetëm një kërkesë të paplotësuar nga sektori bankar tradicional, por edhe rritjen e besimit të qytetarëve të mikrofinanca si mjet për të aksesuar kapitalin.

Perfundimet e këtij punimi deshmojnë një korrelacion pozitiv midis shpërndarjeve të mikrokreditimit dhe rritjes së PBB-së në Shqipëri nga viti 2013 deri në vitin 2023. Analiza e regresionit theksoi se krahas rritjes së aksesit dhe shfrytëzimit të mikrokreditit, u zgjerua edhe aktiviteti ekonomik, cka deshmon se se mikrokreditimi shërben si katalizator për rritjen ekonomike. Vlera e lartë R-katror e modelit, përforcoi më tej rëndësinë e mikrokredisë si një faktor kontribues, me shpërndarjet e saj që shpjegojnë mbi 91% të ndryshueshmërisë së rritjes së PBB-së gjatë kësaj periudhe. Ky konkluzion përputhet me studimet globale që lidhin mikrokreditin me rritjen e sipërmarrjes, krijimin e vendeve të punës dhe përfshirjen e përmirësuar financiare.

Rezultatet tregojnë se mikrokredia ka kontribuar gjithashtu në uljen e pabarazive rajonale dhe në stimulimin e zhvillimit ekonomik lokal. Në zonat rurale dhe rajonet me papunësi të lartë, zgjerimi i mikrokredisë ka ndihmuar individët të financojnë aktivitete sipërmarrëse të vogla, të krijojnë vende pune dhe të rrisin të ardhurat familjare. Ky efekt sugjeron se politika të targetuara për mikrokreditin mund të shërbejnë si një mekanizëm për diversifikimin ekonomik lokal dhe për uljen e varfërisë strukturore në komunitetet më të cënueshme (Bashir et al., 2020).

5.1.2 Ndikimet sociale dhe sfidat e mikreditimit

Përtej dimensionit ekonomik, mikrokredia ka sjellë edhe përfitime të konsiderueshme sociale. Përfitimet sociale të mikrokredisë, përfshirë përmirësimin e edukimit, shëndetit dhe kushteve të jetesës, shpesh tejkalojnë ndikimin ekonomik afatshkurtër.

Mikrokredia ka një rol kyç në rritjen e mirëqenies familjare dhe reziliencës ndaj presioneve ekonomike të jashtme.

Në këtë kontekst, gjetjet tregojnë se përdorimi i mikrokredisë ka mundësuar përmirësime të ndjeshme në mirëqenien dhe reziliencën e familjeve shqiptare, duke ndikuar në disa fusha kryesore:

- **Edukimi:** Mikrokredia ka mundësuar pagesën e tarifave shkollore dhe blerjen e materialeve didaktike, duke rritur qasjen në arsim dhe mundësuar vazhdimësinë e shkollimit për fëmijët.
- **Kushtet e jetesës:** Investimet e vogla në rikonstrukcion dhe përmirësime infrastrukturore kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe stabilitetit të strehimit.
- **Siguria ushqimore:** Rritja e të ardhurave ka lehtësuar aksesin në ushqim cilësor dhe të mjaftueshëm, duke përmirësuar konsumimin dhe shmangur periudhat e pasigurisë ushqimore.
- **Shëndeti:** Të ardhurat shtesë kanë mundësuar mbulim më të mirë të shpenzimeve mjekësore bazike dhe trajtim të emergjencave shëndetësore, duke kontribuar në një reziliencë më të madhe ndaj goditjeve shëndetësore.

Këto përfitime konfirmojnë faktin që, edhe pse mikrokredia ka një ndikim ekonomik të kufizuar në termat afatgjatë, ajo ka një rol thelbësor në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe në rritjen e aftësisë së familjeve për të përballuar presionet ekonomike të jashtme (Adams & Vogel, 2013; Duvendack & Mader, 2020). Gjithashtu, analiza sugjeron që mikrokredia mund të ketë një ndikim pozitiv në barazinë gjinore, duke i mundësuar grave të marrin pjesë në aktivitetin ekonomik, të përmirësojnë të ardhurat e familjes dhe të forcojnë vendimmarrjen brenda shtëpisë dhe komunitetit. Ky efekt fuqizues i grave është veçanërisht i rëndësishëm në zonat rurale dhe në komunitetet me qasje të kufizuar në shërbime financiare.

Një nga dimensionet domethënëse të mikrokreditimit lidhet me fuqizimin e rolit të grave, një ndikim që tejkalon thjesht aspektin ekonomik. Analiza e dhënave tregon se një pjesë e konsiderueshme e grave përfituese ka përjetuar ndryshime të rëndësishme në:

- **Autonominë financiare:** Gratë përfituese kanë fituar më shumë kontroll mbi burimet financiare dhe vendimet ekonomike brenda familjes, duke rritur pavarësinë e tyre dhe kapacitetin për të menaxhuar financat familjare dhe investimet personale.
- **Zgjerimin e rolit të tyre vendimmarrës:** Pjesëmarrja në mikrofinancë ka forcuar pozitën e grave në vendimmarrjen strategjike familjare dhe menaxhimin e burimeve, duke ndikuar në planifikimin ekonomik dhe social të familjes.
- **Përmirësimin e statusit social në komunitet:** Aktivitetet ekonomike të grave kanë rezultuar në një pjesëmarrje më aktive të tyre në jetën komunitare dhe kulturore, duke forcuar rrjetet sociale dhe ndikimin lokal.

- Rritjen e kapaciteteve individuale dhe kolektive: Huamarrjet kanë mundësuar aksesin në trajnim profesional, zhvillimin e aftësive sipërmarrëse dhe krijimin e rrjeteve të solidaritetit, që mbështesin bashkëpunimin ekonomik dhe zhvillimin e aftësive të përbashkëta.

Këto gjetje janë në përputhje me literaturën ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe mikrokreditimin (Kabeer, 2001; Mayoux, 2006), duke sugjeruar se kreditë nuk janë thjesht një instrument ekonomik, por një mekanizëm i fuqishëm për emancipim social dhe transformim kulturor. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se fuqizimi gjinor nuk lind automatikisht nga qasja në kredi; ai kërkon edhe mbështetje institucionale, politika publike efektive, edukim financiar dhe trajnim profesional të vazhdueshëm. Pa këto komponentë, ndikimi i mikrokredisë në barazinë gjinore mund të jetë i pjesshëm dhe i kufizuar në aspektin e qëndrueshmërisë.

5.2. Kufizimet e studimit

Sikurse është argumentuar edhe me larte, ky studim ofron një analizë të detajuar të ndikimit të mikrokredisë në rritjen e Produktit të Brendshëm Bruto në Shqipëri. Megjithatë, sikurse edhe studime të tjera në këtë fushë, ai ka disa kufizime, njohja e të cilave ben të mundur një vlerësim objektiv të rezultateve. Kufizimet dhe problemet e këtij studimi lidhen kryesisht me me tipologjinë e të dhënave primare dhe sekondare, të përshkruara më vijim, të cilat duhet të mbajhen parasysh gjatë interpretimit të gjetjeve.

5.2.1 Kufizimet metodologjike dhe të dhënave

Disa nga kufizimet në lidhje me metodologjinë dhe të dhënat e këtij studimi janë:

- Shuma e kredise të kufizuar (e vogël): Kredia e vogël shpesh nuk është e mjaftueshme për të financuar investime që mund të gjenerojnë rritje afatgjatë.
- Afatet e shkurtra të shlyerjes së kredise: Kjo ndikon në presionin financiar mbi huamarrësit dhe mund të pengojë zhvillimin e projekteve më kapitale-intensive.
- Mungesa e shërbimeve mbështetëse: Mungojnë trajnimet profesionale, konsulenca e biznesit dhe aksesin në treg është i kufizuar, duke penguar transformimin e kredive në cikle të qëndrueshme rritjeje ekonomike.

Mikrokredia shikohet si një instrument komplementar, dhe jo si një zgjidhje e vetme për varfërinë strukturore. Përfitimet e saj kryesore janë përmirësimi i përkohshëm i standardit të jetesës dhe rritja e qasjes në burime financiare për individët dhe familjet me të ardhura të ulëta.

Studimi pjesërisht mbështetet në të dhëna agregate për mikrokreditin dhe PBB-në të gjeneruara nga institucioneve burimore (si INSTAT apo Banka e Shqipërisë). Një metode e tillë mund të maskojë heterogjenitetin rajonal dhe ndikimet sektoriale. Për shembull, ndërsa një përqindje e caktuar e mikrokredisë mund të ketë një efekt pozitiv në sektorin e bujqësisë, ndikimi i saj mund të jetë më i kufizuar në industrinë e prodhimit të vogël ose shërbimeve tregtare. Mungesa e të dhënave të detajuara sipas sektorëve dhe rajoneve kufizon aftësinë për të identifikuar variacionet e ndikimit të

mikrokredisë dhe për të nxjerrë rekomandime të targetuara politikash. Edhe pse analiza nxjerr ne pah një korrelacion pozitiv midis mikrokredisë dhe PBB-së, lidhja shkak pasojë midis këtyre dy variablave mbetet e pasigurt. Për të kuptuar më mirë rrugët e shkakësisë, studimet e ardhshme mund të përdorin metoda më të avancuara ekonometrike, si regresioni me ndryshore instrumentale, analiza e serive kohore të panelit, ose modelet VAR/VECM që lejojnë vlerësimin e marrëdhënieve dinamike midis variablave ekonomike. Kjo do të ndihmonte në diferencimin midis ndikimit të drejtpërdrejtë të mikrokredisë dhe faktorëve të tjerë ekonomikë që mund të jenë bashkësisht të lidhur me rritjen e PBB-së.

Përveç efekteve makroekonomike, mikrokredia mund të ketë ndikime të rëndësishme në dimensionet sociale, të cilat nuk mund të kapen në mënyrë të plotë nga analiza e bazuar vetëm në PBB. Ndikime të tilla përfshijnë përmirësimin e mirëqenies së familjeve, barazinë gjinore, fuqizimin ekonomik të grave, qasjen në arsim dhe shëndetësi, zhvillimin komunitar dhe ceshtje të tjera. Analizimi i këtyre dimensioneve brenda kontekstit shqiptar mund të ofrojë një pamje më holistike dhe të plotë të përfitimeve që ofron mikrokredia, duke shkuar përtej thjesht rritjes së PBB-së.

5.2.2. Kufizimet institucionale dhe rregullatore

Studimi u përball me pengesa të rëndësishme në nivel institucional dhe procedural. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave primare, u evidentua një mungesë fleksibiliteti dhe transparence nga disa institucione të mikrofinances, të cilat hezitojnë të ndajnë të dhëna të detajuara mbi portofolin e tyre të rrezikut ose mbi ecurinë reale të ripagimeve të buta. Kjo vështirësoi matjen e saktë të "mbingarkesës me borxh", një rrezik ky i nënvizuar nga 20% e të intervistuarve që hasin vështirësi në shlyerje.

Një tjetër kufizim procedural lidhet me mungesën e harmonizimit të politikave. Siç është konstatuar, efektiviteti i mikrokredisë mbetet i kufizuar nga mungesa e investimeve komplementare publike në infrastrukturë, ujësjellës dhe arsim. Kjo do të thotë se analiza institucionale e këtij punimi kufizohet nga fakti se mikrokreditimi operon në një mjedis ku politikat zhvillimore nuk janë gjithmonë të integruara, duke e bërë ndikimin e kredisë të varur nga faktorë të tjerë, që shpesh mbeten jashtë kontrollit të këtij studimi.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, u vërejtën gjithashtu kufizime që lidhen me disponueshmërinë dhe cilësinë e dokumentacionit institucional. Mungesa e raporteve të detajuara për ndikimin e programeve të mikrokredisë, si dhe procedurat burokratike për marrjen e informacionit nga institucionet publike dhe private, mund të ndikojnë në përfaqësueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave.

Megjithatë këto kufizime, gjetjet tona tregojnë se mikrokredia ka luajtur një rol pozitiv në rritjen ekonomike të Shqipërisë dhe mund të përdoret si një instrument i rëndësishëm për përfshirjen financiare dhe uljen e varfërisë.

5.3. Implikime dhe rekomandime për politikëbërjen

Nisur nga lidhja pozitive midis mikrokredisë dhe PBB-së, politikëbërësit duhet të marrin në konsideratë krijimin e klimës dhe te mjedisit mbështetës për institucionet e mikrofinancës. Ketu perfshihen rregulloret që lehtësojnë zgjerimin e shërbimeve të mikrokredisë, incentivat diskale, partneritetet organizma ndërkombëtare që promovojnë iniciativa të përfshirjes financiare, etj. Duke rritur shtrirjen dhe stabilitetin e shërbimeve të mikrofinancës, Shqipëria mund të shfrytëzojë mikrokreditin si një mjet për rritje të qëndrueshme ekonomike.

Për Shqipërinë dhe vendet e tjera në faza të ngjashme të zhvillimit ekonomik, mikrokredia mund të integrohet në politika më të gjera ekonomike që synojnë uljen e varfërisë dhe rritjen gjithëpërfshirëse. Për shembull, zgjerimi i aksesit në mikrokredi në zonat rurale ose rajonet me papunësi të lartë mund të adresojë pabarazitë ekonomike rajonale, duke ndihmuar në stabilizimin dhe diversifikimin e ekonomive lokale. Siç kanë treguar studimet në vende të tjera, politikat e synuara të mikrokredisë mund të mbështesin sektorë si bujqësia, prodhimi në shkallë të vogël dhe shërbimet, duke nxitur zhvillimin ekonomik lokal (Bashir et al., 2020).

Bazuar në gjetjet e këtij studimi, mund të nxirren disa rekomandime të vlefshme për politikat e ardhshme dhe praktikatat e mikrofinancës në Shqipëri. Te tilla rekomandime mund të përfshinin: hartimin e kuadrove rregullatore mbështetëse për institucionet e mikrofinancës për të lehtësuar zgjerimin e shërbimeve, stimujt për përfshirjen financiare, duke nxitur partneritete me organizata ndërkombëtare dhe stimuj fiskalë për të zgjeruar aksesin në mikrokredi; edukimin financiar dhe mbështetjen për huamarrësit, si për shembull me trajnime dhe këshillim mbi menaxhimin e borxhit për të parandaluar mbingarkesën me kredi dhe për të siguruar që përfitimet e mikrokredisë të jenë të qëndrueshme; integrimin e mikrokredisë në strategjitë zhvillimore, duke e bërë mikrokreditin pjesë të një politike zhvillimi gjithëpërfshirëse që synon rritjen ekonomike, uljen e varfërisë dhe fuqizimin social të komuniteteve.

Kalimi nga sasia e kredive të cilësia, rishikimi i normave të interesit, shërbimet e reja, etj. Një nga gjetjet kryesore të studimit është fakti që mikrokredia ka një ndikim ekonomik të kufizuar dhe shpesh afatshkurtër në të ardhurat e përfituesve. Ky konstatim sugjeron nevojën për një rishikim kritik të paradigmeve tradicionale të mikrokreditimit, e cila historikisht është ndërtuar mbi logjikën e kapitalit të vogël, afateve të shkurtra të shlyerjes dhe normave relativisht të larta të interesit. Për të maksimizuar efektivitetin e mikrokredisë, rekomandohet:

- Diferencimi i produkteve të mikrokredisë sipas sektorëve: Një produkt i përshtatur për bujqësinë duhet të marrë parasysh sezonin e korrjes dhe ciklin e prodhimit, ndërsa sipërmarrjet urbane ose shërbimet familjare mund të kërkojnë afate fleksibël dhe shuma më të vogla fillestare.
- Fleksibilitet në afatet dhe garancitë e huasë: Adaptimi i afateve të shlyerjes dhe garancive në përputhje me rrezikun specifik të aktivitetit ekonomik të

huamarrësve rrit kapacitetin e tyre për të përmbushur obligimet financiare dhe për të përdorur kredinë si mjet për rritje.

- Përfshirja e shërbimeve mbështetëse: Trajnime profesionale, konsulencë për menaxhimin financiar dhe ndihmë për qasjen në tregje duhet të integrohen në programet e mikrokredisë për të rritur suksesin afatgjatë dhe për të ndërtuar aftësi të qëndrueshme sipërmarrëse.

Kjo qasje e re kërkon një paradigmë tërësisht të personalizuar dhe sektoriale, që transformon mikrokreditimin nga një instrument standard financiar në një mekanizëm fleksibël zhvillimi ekonomik dhe social.

5.3.2. Integrimi i mikrokredisë me strategjitë shtetërore

Mikrokredia si instrument komplementar, duhet të shikohet e lidhur me subvencionet në bujqësi ose politikat e punësimit. Analiza e këtij studimi tregon qartë se mikrokredia e përdorur si një mekanizëm i izoluar nuk është e mjaftueshme për të prodhuar efekte të thella strukturore në uljen e varfërisë. Për këtë arsye, rekomandohet që mikrokredia të konceptohet dhe zbatohet si një instrument komplementar brenda një kornize të gjerë zhvillimi. Ky integrim mund të përfshijë:

Politika publike të zhvillimit rural dhe urban: Mikrokredia duhet të shoqërohet me investime në infrastrukturë, rrugë, energji dhe shërbime publike, që mundësojnë funksionimin efikas të sipërmarrjeve mikro dhe të përmirësojnë qasjen në tregje.

Politika fiskale dhe stimuluese për bizneset e vogla: Subvencionet, ulja e taksave dhe mbështetja financiare për aktivitetet e rrezikshme mund të forcojnë ndikimin e mikrokredisë dhe të nxisin investime më kapitale-intensive.

Instrumente mbrojtëse ndaj goditjeve makroekonomike: Krijimi i fondeve rezervë, sigurimeve mikrofinanciare dhe programeve emergjente mbrojtëse mund të zvogëlojë rrezikun e dështimeve të huamarrësve dhe të ruajë qëndrueshmërinë e sistemit financiar mikro.

Për të vlerësuar efektivitetin e kësaj qasjeje, është e domosdoshme ndërtimi i një sistemi institucional të monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit, i cili mat jo vetëm suksesin financiar të kredive, por edhe efektet sociale, gjinore dhe kulturore të tyre.

Ky sistem mund të përfshijë tregues të performancës për:

- Rritjen e të ardhurave dhe standardit të jetesës së përfituesve;
- Përmirësimin e pjesëmarrjes së grave dhe fuqizimit gjinor;
- Ndikimin në arsimin, shëndetin dhe kushtet sociale të komunitetit;
- Qëndrueshmërinë dhe riskun e huamarrësve ndaj borxheve dhe falimentimeve.

5.4. Sugjerime për kërkime të ardhshme

Natyrisht, sikurse u theksua në të gjithë punimin, fokusi i këtij studimi idhe të studionte lidhjen e mikrokreditimit kryeshit me PBB-ne. Kështu që ai ka kulfizime dhe

nuk mund te trajtoje shume nga çështjet e tjera qe u permenden . Ne kete kontekst, sugjerimi yne eshte qe kjo fushe te thellohet ne studimine saj dhe studimet e ardhshme qe ne sugjerojmë mund të fokusohen në:

- Analizat sektorale dhe rajonale të ndikimit të mikrokredisë.
- Studimet e shkakësisë me metoda ekonometrike të avancuara.
- Vlerësimet e ndikimeve sociale dhe zhvillimore të mikrokredisë, duke përfshirë barazinë gjinore dhe fuqizimin e komuniteteve.
- Analizen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe aftësisë së mikrofinancës për të zbutur pasigurinë dhe goditjet e jashtme ekonomike.

Pra, ky studim synon te persaktoje edhe një bazë të rëndësishme për kuptimin e ndikimit të mikrokredisë në ekonominë shqiptare, duke theksuar nevojën për kërkime të mëtejshme që mund të thellojnë njohuritë mbi efektet e saj afatgjata dhe të optimizojnë politikëbërjen në fushën e mikrofinancës. Mikrokredia në Shqipëri nuk duhet të shihet vetëm si një mjet financiar, por si një mekanizëm kompleks zhvillimi që ndërthur dimensionet ekonomike, sociale dhe gjinore. Përmes një qasjeje holistike dhe politikash të integruara, mikrokredia ka potencialin për të prodhuar transformime të qëndrueshme dhe të thella në strukturat socio-ekonomike të vendit.

Ky studim evidenton disa boshllëqe hulumtimi dhe mundësi për studime të mëtejshme, të cilat do të thellojnë kuptimin e ndikimeve të mikrokredisë dhe do të informojnë politikat zhvillimore:

- Analiza e ndikimeve afatgjata: Hulumtimi mbi efektet e mikrokredisë në periudha më të gjata kohore do të lejojë vlerësimin e transformimeve strukturore në të ardhurat, varfërinë dhe shpërndarjen e pasurisë.
- Ndikimet gjinore dhe sociale: Studime më të thelluara mbi fuqizimin e grave, barazinë gjinore dhe transformimin e rolit social të grave do të ndihmojnë në hartimin e politikave përfshirëse dhe programeve të targetuara.
- Efienca sektoriale dhe rajonale: Analiza e ndikimit të mikrokredisë në sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe rajone të ndryshme do të ndihmojë për optimizimin e alokimit të resurseve dhe për rritjen e efektivitetit të programeve.
- Rreziqet dhe mbingarkesa me borxhe: Studime mbi praktikën e menaxhimit të borxhit dhe edukimin financiar mund të minimizojnë pasigurinë financiare të përfituesve dhe të ruajnë qëndrueshmërinë e sistemit mikrofinanciar

5.5. Konkluzione përmbyllëse

Në bazë të analizës dhe gjetjeve të këtij studimi, mund të sintetizohen disa mesazhe kryesore për politika dhe praktikë:

- Mikrokredia duhet të rikonceptohet për të qenë fleksibël, sektoriale dhe e përshtatur me ciklet reale të investimeve dhe aktivitetit ekonomik të përfituesve.

- Mikrokredia duhet të integrohet si instrument komplementar brenda politikave të zhvillimit ekonomik, social dhe gjinor, duke ofruar mbështetje të qëndrueshme për familjet dhe komunitetet.
- Sistemet e monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit janë të domosdoshme për të matur efektivitetin dhe për të siguruar transformim socio-ekonomik të qëndrueshëm.
- Kërkimet e ardhshme duhet të adresojnë efektet afatgjata, ndikimet gjinore, efektivitetin sektorial dhe rreziqet e borxhit, duke krijuar një bazë të fortë për politika të bazuara në provë.

Në këtë kuadër, mikrokredia nuk përfaqëson vetëm një mjet financiar; ajo është një mekanizëm kompleks zhvillimi që ndërthur dimensionet ekonomike, sociale dhe gjinore. Implementimi i rekomandimeve të mësipërme mund të shndërrojë mikrokreditimin në një instrument të fuqishëm transformues për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të Shqipërisë.

Ky udhëtim kërkimor mbi rolin e mikrokreditimit në Shqipëri, i shpalosur përmes faqeve të këtij disertacioni, nuk është thjesht një analizë ekonometrike e shifrave dhe trendeve, por një përpjekje për të kuptuar mekanizmin e brendshëm të një instrumenti që premton të transformojë jetët e atyre që ndodhen në periferi të sistemit financiar tradicional. Kur nisëm këtë studim, pyetja qendrore nuk ishte vetëm nëse mikrokredia funksionon, por se si ajo adaptohet në një mjedis specifik si ai shqiptar, ku tranzicioni i gjatë ka lënë gjurmë të pashlyeshme në strukturën e sipërmarrjes dhe në mentalitetin e huamarrësit.

Në dritën e analizës teorike dhe evidencave empirike të mbledhura gjatë këtij studimi, bëhet e qartë se mikrokredia nuk mund të konsiderohet si një instrument universal për zgjidhjen e varfërisë apo për stimulimin e zhvillimit ekonomik. Përkundrazi, ajo duhet të shihet si një komponent i një mozaiku më të gjerë politikash, mekanizmash institucionale dhe proceseve shoqërore që tejkalojnë funksionin e saj financiar të ngushtë.

Mikrokredia krijon mundësi dhe hap dritare të reja ekonomike, por nuk garantojnë automatikisht rezultate të qëndrueshme. Ajo nuk mund të zëvendësojë nevojën për politika zhvillimore të koordinuara, investime në kapitalin njerëzor, apo programe të qëndrueshme sociale, të cilat janë thelbësore për ndërtimin e një arkitekture të qëndrueshme zhvillimi.

Një nga konkluzionet kyçe të këtij studimi është se efektiviteti i mikrokredisë është i lidhur ngushtë me kontekstin institucional dhe social ku ajo funksionon. Evidencat tregojnë se rezultatet më të qëndrueshme arrihen kur mikrokredia është e integruar me mekanizma që nxisin besimin, solidaritetin dhe bashkëpunimin brenda komuniteteve, si dhe me struktura institucionale që ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për huamarrësit.

Në mungesë të këtyre faktorëve, mikrokredia ka të ngjarë të reduktohet në një formë të kufizuar kredie konsumatore, pa ndikim transformues në zhvillimin ekonomik dhe social. Kjo evidencë mbështet literaturën ndërkombëtare, sipas së cilës kredia mikro arrin potencialin e saj të plotë vetëm kur shoqërohet me mbështetje të kapaciteteve njerëzore, trajnime profesionale, qasje në tregje dhe politika që adresojnë pabarazitë strukturore (Ledgerwood, 2013; Kabeer, 2001; Mayoux, 2006).

Studimi nënvizon gjithashtu nevojën për një qasje sistemike dhe multidimensionale të mikrokredisë. Rekomandimet e paraqitura theksojnë se ajo duhet të ndërveprojë me investime në kapitalin njerëzor, me politikat aktive të tregut të punës, me programet për ngritjen e kapaciteteve sipërmarrëse dhe me instrumentet e mbrojtjes sociale.

Vetëm përmes kësaj ndërthurjeje të qëllimshme, mikrokredia mund të transformohet nga një mjet i izoluar financiar në një komponent të integruar të zhvillimit ekonomik, social dhe gjinor. Kjo qasje ndihmon në krijimin e efekteve shumëzues, duke rritur mundësinë që investimet e vogla të mikrofinancës të shndërrohen në përfitime të qëndrueshme dhe të matshme për komunitetet lokale.

Një tjetër dimension thelbësor lidhet me komunitetin dhe institucionet lokale. Mikrokredia ka rezultate më të qëndrueshme kur funksionon mbi bazën e marrëdhënieve të besimit dhe solidaritetit, kur ekziston mbështetje reciproke midis huamarrësve dhe kur ka ndërveprim aktiv me strukturat institucionale lokale. Për shembull, rrjetet komunitare mund të ofrojnë mbikëqyrje, këshillim dhe asistencë, duke zvogëluar rrezikun e dështimeve dhe duke përforcuar kulturën e përgjegjësisë financiare. Pa këto elemente, mikrokredia rrezikon të mbetet një instrument financiar me impakt të kufizuar, pa kapacitet transformues.

